

RAPORTI VJETOR



ProCredit Bank

**31
DHJETOR
2024**

Kontenti

RAPORTI STRATEGJIK

Njohuri mbi lidershipin dhe struktura e grupit

Viti ynë në një vështrim

Misioni dhe vizioni

Deklarata e bordit mbikëqyrës

Letër nga kryeshefi ekzekutiv

Bordi menaxhues

Struktura e aksionarëve

Grupi ProCredit në një vështrim

Performanca e Bankës ProCredit në Kosovë

Arritjet ndër vite

Tregu dhe konteksti ekonomik

Këndvështrimi ekonomik në Kosovë

Pasqyra e sektorit bankar

Klientët dhe performanca e biznesit

Qasja jonë ndaj klientëve të biznesit

Qasja jonë ndaj klientëve privatë

Qasja jonë digjitale

Punonjësit dhe kultura në vendin e punës

Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia sociale

Qasja jonë ndaj mjedisit

Angazhimi në komunitet dhe ndikimi social

MENAXHIMI I RISKUT

PASQYRAT FINANCIARE

1

2

3

4

6

9

12

14

16

21

25

27

28

29

31

32

34

35

36

39

40

42

44

60

Raporti strategjik



**RAPORTI
VJETOR
2024**

Njohuri mbi lidershipin & struktura e grupit

Viti ynë në një vështrim

Lansuam



për klientët tanë

Çmimi
për Ndikim të
Qëndrueshëm

nga
CSR Kosova



Mbi

30 projekte

të mbështetura përmes
sponsorizimeve dhe
donacioneve

130 orë

trajnimi për
punonjës

Portfolio
e kredive

+18%

Rritje e qëndrueshme

2023

EUR 748 mln.

2024

EUR 881 mln.

Kreditë e gjelbra
EUR 126 mln.

+EUR 9.1 mln. rritje

Portfolio më e madhe e
kredive të gjelbra në
Kosovë

123%

Raporti i depozitave
ndaj kredisë

Tejkalojmë mesataren
e sektorit bankar

Kualiteti
i lartë
i aseteve

NPL **1.2%**

Asetet

EUR 1.3 mld.

2024

+EUR 165 mln.

2023

EUR 1.1 mld.

2024, ridefinoj
suksesin për
ProCredit Bank

Depozitat
e klientëve

2023

EUR 936 mln.

2024

EUR 1.1 mld.

15%

Viti ynë në një vështrim

55%

e pozitive të
menaxhmentit të
mesëm në bankë janë të
udhëhequra nga gratë

Lansuam

kartelat organike

Fituam çmimin

“Mik i fëmijëve”

nga

Shoqata për Mbrotjtjen e Fëmijëve në Kosovë

Kthim i lartë nga asetet

2.5%

+0.4 pp rritje

reflekton aftësinë tonë të
krijojmë më shumë vlerë

Kthim nga kapitali

2023

20.8%

2024

23.2%

2024


16.4%

16.8% - 2023

Raporti i kapitalit total

thekson angazhimin tonë
për zhvillim, siguri dhe
bankim të përgjegjshëm

Nën mbikëqyrjen e



BaFin

Ne punojmë në përputhje
me **praktikat më të mira bankare**
dhe me **standardet rregullative**
në Gjermani

FitchRatings

BB+

Misioni dhe vizioni



Misioni dhe vizioni

ProCredit është një bankë gjermane me orientim zhvillimor në Evropën Lindore dhe Juglindore, e përkushtuar në mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve) dhe klientëve privatë, e cila nxit rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ne jemi të përkushtuar të ofrojmë shërbime të jashtëzakonshme për klientët, që shkojnë përtej ofrimit të produkteve financiare. Synimi ynë është krijimi i partneriteteve të fuqishme dhe afatgjata me klientët tanë duke iu ofruar këshilla të personalizuar dhe mbështetje të vazhdueshme në çdo fazë të rrugëtimit të tyre financiar.

Parimet tona themelore udhëheqin çdo veprim që ndërmarrim:

- Ne e shfrytëzojmë kohën e duhur për të kuptuar plotësisht rrethanat unike të klientëve tanë, duke realizuar analiza të qëndrueshme financiare për të mbështetur stabilitetin e tyre financiar afatgjatë.
- Ne i japim prioritet transparencës në të gjitha ndërveprimet me klientët, duke siguruar qartësi dhe besueshmëri në shërbimet dhe produktet tona financiare.
- Ne mbështesim praktika të përgjegjshme të kredidhënies që nxisin përfshirjen financiare, duke mbrojtur klientët nga mbingarkimi me borxhe.

- Ne fokusohemi në arritjen e një ndikimi të gjerë social, ekonomik dhe mjedisor, duke bashkëpunuar me klientët tanë për të promovuar praktika të qëndrueshme dhe për të mbështetur përshtatjen e tyre drejt operacioneve mjedisore të përgjegjshme.

Ne besojmë se NMVM-të janë shtytësit jetik të përparimit ekonomik dhe social. Duke i mbështetur ato përgjatë ciklit të tyre ekonomik, ne synojmë të nxisim zhvillim të qëndrueshëm dhe të shtyjme përpara transformimin e gjelbër në vendet ku operojmë. Duke ofruar produkte të qasshme depozitimi, shërbime bankare digjitale dhe një gamë gjithëpërfshirëse të produkteve financiare, ne synojmë të kultivojmë një kulturë kursimi dhe përgjegjësie financiare te të gjithë klientët tanë, duke përfshirë edhe klientët privatë.

Aksionarët tanë kërkojnë kthim të qëndrueshëm, afatgjatë, në përputhje me përkushtimin tonë të palëkundur ndaj praktikave etike bankare dhe ndikimit social pozitiv.

Ne investojmë intensivisht në trajnimin dhe zhvillimin e stafit tonë për të kultivuar një ambient pune të hapur, profesional dhe efikas. Kjo na mundëson të ofrojmë shërbime miqësore,

kompetente dhe efektive për klientët tanë.



Deklarata e bordit mbikëqyrës



Deklarata e bordit mbikëqyrës

Si anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të bankës ProCredit në Kosovë, kemi kënaqësinë të paraqesim pikëpamjet tona për performancën e bankës gjatë vitit të kaluar dhe të ndajmë me ju perspektivën tonë për drejtimin në të cilin jemi duke lëvizur. Gjatë këtij viti, ne kemi punuar ngushtë me Bordin Menaxhues për t'u siguruar që banka vazhdon të veprojë në mënyrë të përgjegjshme, të ketë rritje të qëndrueshme dhe të mbetet e përkushtuar ndaj vlerave të saj themelore. Kjo deklaratë përmbledh zhvillimet kryesore, fushat strategjike të fokusit dhe përpjekjet e përbashkëta që e kanë formësuar zhvillimin e bankës në vitin 2024.

Pas një viti jashtëzakonisht të suksesshëm në 2023, i cili solli rezultate rekorde dhe performancë të fuqishme afariste, ne, në fillim të vitit financiar të kaluar, kemi hartuar një vizion të ri ambicioz për grupin tonë. Qëllimi ynë ishte të rrisnim edhe më tej praninë e grupit ProCredit në tregjet e veta, duke e rritur dukshmërinë, shtrirjen dhe qëndrueshmërinë, si dhe duke e zgjeruar ndikimin pozitiv të veprimtarisë sonë bankare përmes një pranie më të fuqishme. Në këtë kontekst, viti 2024 shënoi fillimin e strategjisë ambicioze të rritjes së grupit tonë, me synim zgjerimin tutje të operacioneve tona brenda segmenteve kryesore, duke përfshirë NMVM-të dhe klientët privatë. Synimi ynë është të forcojmë pozicionin tonë si lider i shërbimeve bankare me ndikim në mbarë

Evropën Lindore dhe falë punës së palodhshme të ekipit tonë dhe vendimeve strategjike të ndërmarra, kemi pasur një performancë solide financiare që na jep besim në drejtimin që e kemi zgjedhur. Edhe pse vazhdojmë të përballemi me pasiguri ekonomike, menaxhimi ynë i fuqishëm i rrezikut dhe përkushtimi ndaj shërbimit të klientëve na kanë mbajtur të qëndrueshëm.

Në thelb të çdo veprimi që ndërmarrim janë punonjësit që e përbëjnë bankën ProCredit. Ekipi ynë drejtues është i përkushtuar të sigurojë që banka funksionon në mënyrë etike dhe transparente dhe jemi mirënjohës për përpjekjet e palodhshme si të Bordit Menaxhues, ashtu edhe të stafit tonë. Bordi Mbikëqyrës mbetet i përkushtuar në kultivimin e një kulture besimi dhe llogaridhënieje, duke vepruar gjithmonë në interes të klientëve, punonjësve dhe aksionarëve tanë.

Bordi Mbikëqyrës ka miratuar disa nisma kyçe që besojmë se do të na ndihmojnë të rritemi në drejtimin e duhur. Po investojmë në teknologji digjitale që jo vetëm do të racionalizojnë operacionet tona, por edhe do të përmirësojnë përvojën e klientit. Këto përpjekje janë pjesë e një strategjie më të gjerë për të forcuar praninë tonë në treg dhe për të prezantuar produkte e shërbime të reja që i përgjigjen nevojave në zhvillim të klientëve tanë të biznesit dhe privatë. Ne gjithashtu jemi të përkushtuar ta integrojmë

qëndrueshmërinë në çdo aspekt të operacioneve tona. Nga financimi i nismave të gjelbra deri te miratimi i praktikave më miqësore ndaj mjedisit, ne e shohim këtë si një hap të rëndësishëm për të ardhmen, jo vetëm për biznesin tonë por edhe për komunitetin më të gjerë. Derisa vështrojmë nga e ardhmja, mbetemi optimistë dhe të fokusuar në krijimin e vlerës afatgjatë për të gjitha palët tona të interesit. E dimë se na presin sfida, por me përkushtimin e njerëzve tanë dhe me mbështetjen e partnerëve, jemi të bindur se Banka ProCredit në Kosovë do të vazhdojë të lulëzojë.

Në emër të
Bordit
Mbikëqyrës,


Eriola Bibolli
Kryesuese e
Bordit të
Drejtorëve të
Bankës ProCredit
në Kosovë



Raporti strategjik

Menaxhimi i riskut

Pasqyrat financiare



Letër nga
**Kryeshefi
Ekzekutiv**



Letër nga Kryeshefi Ekzekutiv

Të nderuara palë të interesit,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush pasqyrën e progresit dhe performancës së Bankës ProCredit për vitin e kaluar. Viti 2024 ishte një vit transformues për ne – i karakterizuar me një rritje domethënëse, zhvillim strategjik dhe vazhdim të përkushtimit ndaj vlerave tona.

Përgjatë gjithë vitit 2024, ne kemi investuar në mënyrë të qëllimshme në shtyllat që e përcaktojnë strategjinë tonë afatgjatë: punonjësit tanë, teknologjia dhe zgjerimi e modernizimi i rrjetit të degëve tona.

Rezultatet financiare për vitin 2024 pasqyrojnë këtë përkushtim. Ne arritëm rritje prej 18% në portfolion e kredive si dhe një rritje prej 15% në depozita, të dyja këto tregues të rëndësishëm të besimit që kanë klientët tanë si dhe të fuqisë së shërbimeve tona. Gjithashtu, kemi vazhduar të rrisim nismat tona të financimit të gjelbër, me një rritje shtesë prej 9.1 milionë euro në kreditë e gjelbra, duke e çuar totalin e portfolios tonë të kredive të gjelbra në 126 milionë euro. Këto arritje janë rezultat i një strategjie të qartë, i ekzekutimit të fuqishëm si dhe i një ekipi që mbetet thellësisht i përkushtuar ndaj ofrimit të shërbimeve bankare të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Në përpjekjet tona për përmirësim të vazhdueshëm të përvojës së klientëve,

kemi bërë përparime të rëndësishme në transformimin digjital. Kemi përmirësuar procesin e hapjes së llogarisë në mënyrë digjitale, duke e rritur qasshmërinë dhe lehtësinë për klientët e rinj, gjë që ka kontribuar në rritjen e bazës së klientëve privatë. Po ashtu kemi prezantuar “Google Pay” dhe i kemi lansuar kartelat për pagesa të prodhuara nga materiale organike dhe ekologjike, duke e integruar kështu edhe më tej inovacionin me përkushtimin tonë ndaj qëndrueshmërisë.

Qëndrueshmëria mbetet në zemër të misionit tonë. Përgjatë vitit 2024, ne kemi mbështetur projekte për mjedisin dhe komunitetin, të cilat sollën vlerë të çmuar në shoqërinë që na rrethon. Ishim të nderuar të pranohim “Çmimin për Ndikim të Qëndrueshëm” nga CSR Kosova në shenjë mirënjohjeje për përpjekjet tona të vazhdueshme në këtë fushë. Gjithashtu, çmimi “Mik i fëmijëve”, i ndarë nga **Shoqata për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë** dhe **SOS Fshati**, ishte një vlerësim thellësisht prekës për nismat tona që mbështesin fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror ose që janë në rrezik për ta humbur atë.



Duke e njohur rëndësinë e qëndrueshmërisë në një mjedis që është gjithmonë në ndryshim, ne e kemi forcuar edhe më tej kornizën tonë të menaxhimit të rrezikut. Këto përditësim na ndihmojnë të parashikojmë edhe më mirë sfidat si dhe të përballemi me pasiguritë me vetëbesim, duke siguruar vazhdimësinë e qëndrueshmërisë së operacioneve tona.

Në thelb të të gjitha përpjekjeve tona qëndron përkushtimi i singertë ndaj klientëve tanë. Këtë vit ne kemi qenë të përkushtuar që t'i dëgjojmë më nga afër ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe klientët individualë. Kjo qasje e vëmendshme jo vetëm që ka përmirësuar kënaqësinë e përgjithshme të klientëve, por gjithashtu i ka forcuar marrëdhëniet tona afatgjata të cilat i kemi kultivuar brenda komuniteteve të cilave iu shërbejmë.

Derisa vështrojmë përpara, prioritetet tona mbeten të rrënjësura në përvojën dhe kënaqësinë e klientëve tanë. Ne jemi të përkushtuar ta zgjerojmë praninë tonë në tregjet kyçe, ta avancojmë inovacionin digjital dhe ta mishërojmë edhe më shumë qëndrueshmërinë në praktikën tona të biznesit.

Çdo hap që ndërmarrim do të udhëhiqet nga qëllimi për të ofruar vlerë të jashtëzakonshme dhe shërbime domethënëse, duke siguruar që nevojat gjithnjë në zhvillim të klientëve tanë të mbeten gjithmonë në qendër të çdo sygjërimi - hapi që bëjmë.

Në emër të Bordit Menaxhues, dëshiroj të falënderoj klientët, punonjësit dhe partnerët tanë për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme. Së bashku, ne presim të ndërtojmë një të ardhme edhe më të fuqishme dhe me ndikim edhe më të madh.

Në emër të Bordit
Menaxhues,

Visar Paçarada
Kryeshef Ekzekutiv



Bordi menaxhues



Bordi menaxhues



Visar Paçarada
Kryeshef Ekzekutiv

Bejtë Cakaj
Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv

Struktura e aksionarëve




Struktura e aksionarëve

Banka ProCredit në Kosovë është në pronësi të ProCredit Holding AG, kompania mëmë e grupit ProCredit e cila në fokus të veçantë ka zhvillimin ekonomik, ekologjik dhe social në Evropën Juglindore e Lindore.

Sipas njoftimeve të disponueshme për të drejtat e votës ose deklarimeve vullnetare, në fund të vitit¹ 2024 aksionarët më të mëdhenj të ProCredit Holding AG janë: Zeitinger Invest GmbH, Kreditanstalt für Wieder aufbau (KfW), DOEN Participaties BV, European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) dhe Teachers Insurance and Annuity Association of America (TIAA).

Si kompania mbikëqyrëse e grupit në përputhje me Aktin Gjerman të Bankave dhe si kompani mbajtëse financiare nën grupin mbajtës financiar ProCredit, ProCredit Holding AG mbikëqyret në nivel të konsoliduar nga Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (Bundesanstalt für Finanzdienstleistungsaufsicht, BaFin) dhe nga Bundesbanku i Gjermanisë. Për informacion shtesë, vizitoni: <https://www.procredit-holding.com/>



(1) Sipas deklarimeve vullnetare të Zeitinger Invest më 13 prill 2023 (shih "Informacione tjera" në seksionin "Marrëdhëniet me investitorë" të faqes së internetit të ProCredit Holding); (2) Sipas deklarimeve vullnetare të KfW më 17 prill 2023 (shih "Informacione tjera" në seksionin "Marrëdhëniet me investitorë" të faqes së internetit të ProCredit Holding); (3) Sipas deklarimeve vullnetare të DOEN Participaties më 14 prill 2023 (shih "Informacione tjera" në seksionin "Marrëdhëniet me investitorë" të faqes së internetit të ProCredit Holding); (4) Sipas njoftimeve për të drejtat e votës deri më 23 maj 2023; (5) Sipas njoftimeve për të drejtat e votës deri më 29 dhjetor 2016. Struktura e aksionarëve e paraqitur më sipër bazohet në njoftimet publike për të drejtat e votës nga BERZH-i (EBRD) dhe TIAA dhe, në rastin e Zeitinger Invest GmbH, KfW dhe DOEN Participaties B.V., në deklarimet vullnetare për të drejtat e votës (shih "Njoftimet për të drejtat e votës" dhe "Informacione tjera" në seksionin "Marrëdhëniet me investitorë"). Ky zëbërthim është llogaritur duke krahasuar numrin e të drejtave të votës të raportuara nga aksionarët në datat e sipërpërmendura me numrin total të të drejtave të votës (aktualisht 58,898,492). ProCredit Holding AG ka bërë përpjekje të arsyeshme për të ofruar një pasqyrë reale të strukturës së aksionarëve. Megjithatë, për shkak të kufizimeve në disponueshmërinë dhe verifikueshmërinë e të dhënave, ProCredit Holding AG nuk merr përgjegjësi për saktësinë, plotësinë dhe përditësimin e informacionit të paraqitur këtu.

¹Burimi: Raporti Vjetor për vitin 2024 dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të PCH


Grupi ProCredit në një vështrim




Grupi ProCredit në një vështrim

Banka ProCredit në Kosovë është pjesë e një grupi ndërkombëtar të bankave komerciale me orientim zhvillimor që operojnë në Evropën Juglindore, Evropën Lindore, në Amerikën Jugore, si dhe në Gjermani. Me seli në Frankfurt të Gjermanisë, kompania ëmë e grupit, ProCredit Holding, është përgjegjëse për menaxhimin strategjik, mjaftueshmërinë e kapitalit, raportimin, menaxhimin e riskut, si dhe për organizimin e duhur afarist të grupit dhe vepron si një kompani mbizotëruese në aspektin rregullativ.

Si grup, ne mbikëqyremi në nivel të përbashkët nga Autoriteti Federal Gjerman i Mbikëqyrjes Financiare dhe veprojmë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat për rrezik në vendet ku operojmë, të përkushtuar për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) si dhe individëve privatë, duke nxitur rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



● Portfolio e kredive



● Depozitat e klientëve

12.6%

Rritja nga kreditë

19.3%

Kreditë e gjelbra

2.3%

Kreditë jo performuese

14.3%

Rritja e depozitave

118.3%

Raporti i depozitave ndaj kredive

3.5%

Marzhi neto i interesit

EUR 10.8 mld.

Bilanci i gjendjes

10.2%

Kthimi në ekuitet

13.1%

CET1

Aktivitetet e grupit ProCredit përfshijnë financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve) dhe shërbimet bankare direkte për klientët privatë. Ne operojmë në Evropën Juglindore, Evropën Lindore, Amerikën Jugore dhe Gjermani. Kompania mbizotëruese e grupit është ProCredit Holding, me seli në Frankfurt am Main.

Përmes aktiviteteve tona të biznesit, ne synojmë të ofrojmë në mënyrë të qëndrueshme kthim nga investimi për aksionarët tanë, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin ekonomik, social dhe ekologjik. Strategjia jonë e biznesit bazohet në marrëdhënie afatgjata me klientët tanë si dhe në një qasje konservative ndaj riskut. Grupi nuk angazhohet në aktivitete spekulative.

Ne synojmë të jemi “Hausbank” për klientët tanë, pra pika e tyre e parë e kontaktit për çështje financiare. Klientët tanë NMVM zakonisht kanë nevoja financimi që variojnë nga 50,000 EUR deri në disa milionë. Si specialistë në financimin e NMVM-ve, ne i kuptojmë sfidat e veçanta me të cilat përballen këta klientë si dhe nevojat specifike që kanë, shpesh përtej thjesht kredive.

Ne ofrojmë shërbime bankare për financim, operime me llogari, pagesa dhe depozita të biznesit, si dhe i mbështesim klientët tanë edhe në projektet e tyre afatgjata të investimit. Për më tepër, ofrojmë zgjidhje efikase për

financimin e biznesit dokumentar dhe pagesat ndërkombëtare përmes rrjetit tonë të bankave. Përveç shërbimeve për NMVM-të, ne gjithashtu zbatojmë një strategji bankare të drejtpërdrejtë për klientët privatë. Si rregull i përgjithshëm, ndërveprimi me klientët privatë bëhet përmes kanaleve digjitale, duke u ofruar atyre një gamë të plotë shërbimesh online të kombinuara me këshillime personale ndaj klientit. Me shërbimet tona të drejtpërdrejta, ne synojmë të dallohemi nga ofruesit e tjerë në tregjet tona për sa i përket komoditetit, sigurisë dhe transparencës. Llogaridhënia është pjesë e kulturës sonë. Një komponent i pandarë i strategjisë sonë të biznesit është synimi ynë për të pasur ndikimin sa më të vogël të mundshëm në mjedis dhe për të nxitur në mënyrë proaktive ndryshim në mendësi, me fokus më të madh në qëndrueshmëri. Vetëdija mjedisore, marrja parasysh e ndikimit të veprimeve tona në mjedis dhe kuptimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike kanë qenë gjithmonë shumë të rëndësishme për grupin ProCredit dhe klientët e tij. Ne i koordinojmë veprimet tona duke përdorur një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit mjedisor dhe synojmë të promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha format. Sistemi ynë i menaxhimit mjedisor përfshin si dimensionet e brendshme edhe ato të jashtme, duke na mundësuar të menaxhojmë ndikimin e vetë aktiviteteve tona afariste, si dhe të klientëve

tanë, në mjedis. Masat e brendshme përfshijnë kontrollimin dhe zvogëlimin e gjurmës mjedisore të çdo institucioni të veçantë ProCredit. Aspektet kryesore të jashtme të menaxhimit mjedisor janë zbatimi i rreptë i Listës sonë të Përgjashtimit në aktivitetin e kredidhënies dhe, si pjesë e vlerësimit të riskut kreditor, rishikimi vjetor i faktorëve të qëndrueshmërisë që lidhen me ndikimin e operacioneve të klientëve tanë në mjedis dhe shoqëri. Ne besojmë se bankat tona mund të japin kontribut të rëndësishëm përmes këtyre masave duke promovuar zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në vendet tona të operimit përmes projekteve investive të gjelbra, veçanërisht në fushat e eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtrishme, si dhe përmes investimeve të gjelbra në menaxhimin e mbeturinave ose bujqësinë organike. Grupi ynë i synuar për kredidhënie përfshin kryesisht kompanitë inovative që tregojnë rritje dinamike dhe që kanë strukturë të qëndrueshme dhe të formalizuar. Përmes punës sonë, ne duam të ofrojmë vlerë të shtuar për klientët tanë dhe të japim një kontribut në krijimin e vendeve të punës, rritjen e kapacitetit për inovacion dhe nxitjen e investimeve në projekte ekologjike. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë lëshimit të kredive të gjelbra dhe promovimit të prodhimit vendor, sidomos në bujqësi. Qasja jonë bazohet në një përzgjedhje të kujdesshme dhe kritike të klientëve, duke konsideruar


aftësinë paguese, transparencën dhe përgjegjësinë sociale në zemër të procesit të kredidhënies. Në këtë mënyrë, ne duam të sigurojmë që klientët tanë të jenë në gjendje të përdorin në mënyrë të duhur kreditë e tyre dhe gjithashtu të krijojnë rezerva për kohë potencialisht më të vështira. Ne i kushtojmë rëndësi të madhe marrëdhënieve të hapura dhe transparente të biznesit dhe mbajmë kontakte të rregullta me klientët tanë. Ne besojmë se klientët tanë japin gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në sektorin formal, dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin social dhe ekonomik në tregjet e tyre, jo vetëm përmes veprimeve të tyre, por edhe duke paguar taksa dhe duke ofruar kushte të drejta të punës. Në të njëjtën kohë, ne kemi kërkesa të qarta për klientët tanë sa i përket praktikave etike të biznesit dhe trajtimit të përgjegjshëm të mjedisit të tyre. Si anëtar i “Net-Zero Banking Alliance”, ne jemi zotuar të arrijmë emetime neto-zero për portfolion tonë të kredive dhe investimeve deri në vitin 2050 ose edhe më herët. Në këtë kontekst, ne i mbështesim klientët tanë biznesorë, veçanërisht ata me emetime të larta, në përmirësimin e matjes së emetimeve të tyre të gazrave serrë, në vendosjen e caceve të emetimeve në përputhje me “Science Based Targets Initiative” (SBTi) dhe në uljen e këtyre emetimeve përmes investimeve të gjelbra. Marrja parasysh e risqeve sociale dhe mjedisore të klientëve tanë është

e integruar fuqimisht në proceset tona të vendimmarrjes për kredi. Gjithashtu i kushtojmë rëndësi të madhe parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme.

Ne mbajmë marrëdhënie afatgjata me klientët tanë dhe e shohim këtë si të dobishme për të dyja palët: klientët tanë kanë një partner të besueshëm që qëndron pranë tyre, edhe kur kushtet ekonomike bëhen të vështira. Në të njëjtën kohë, ne krijojmë një portfolio të kredive me klientë të besueshëm, i cili rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe është me cilësi shumë të mirë në kontekstin e tregjeve tona. Në vitet në vijim, ne duam gjithashtu të pozicionohemi më fuqishëm si një bankë tërheqëse për klientët privatë në tregjet tona. Për këtë qëllim, ne dëshirojmë t’u ofrojmë klientëve privatë një gamë gjithëpërfshirëse të shërbimeve bankare dhe të dallohemi nga bankat e tjera për sa i përket cilësisë, funksionalitetit dhe shërbimit ndaj klientit. Ne kemi një qasje të përgjegjshme ndaj kredidhënies për individë privatë dhe vendimet tona për kreditë bazohen në kapacitetin e klientit për kthimin e kredisë brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në vendet ku marketingu i kredive konsumatore rregullohet në mënyrë të pamjaftueshme, ne duam që, si një bankë e përgjegjshme, të promovojmë një kulturë kursimi, të vendosim çmime për financim në mënyrë transparente dhe të

parandalojmë mbingarkimin e klientëve tanë me borxhe. Cilësia dhe motivimi i stafit është një faktor kyç për arritjen e objektivave tona të biznesit. Ne e zgjedhim stafin me kujdes dhe ofrojmë perspektiva afatgjata të karrierës, bazuar në një strukturë transparente dhe të standardizuar në nivel grupi sa i përket pagave dhe gradimeve. Me qëllim të ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin dhe nxitjes së shkëmbimit të vazhdueshëm brenda grupit, ne organizojmë një program trajnimi në nivel grupi në qendrat tona të trajnimit. Përveçse është pjesë e identitetit tonë, angazhimi ynë ndaj respektit të ndërsjellë dhe sjelljes së përgjegjshme në jetën e përditshme theksohet edhe në Kodin tonë të mirësjelljes në nivel grupi, të cilin i gjithë stafi ynë e diskuton dhe e zhvillon më tej në punëtori vjetore të posaçme. Në të gjithë grupin, kemi një gamë të larmishme të punonjesve nga fusha të ndryshme akademike dhe një shpërndarje të balancuar gjinore në të gjitha nivelet e biznesit. Ne besojmë se kjo larmi e nxit inovacionin dhe jep kontribut të rëndësishëm në suksesin afatgjatë të biznesit tonë.

Organizimi i grupit ProCredit




ProCredit Holding është kompania mëmë dhe gjithashtu subjekti mbikëqyrës i grupit. ProCredit Holding zotëron 100% të aksioneve të të gjitha filialeve dhe është përgjegjës për drejtimin strategjik të grupit, për ruajtjen e një niveli të duhur të kapitalit për grupin dhe për sigurimin që të gjitha detyrimet për raportim, menaxhim të riskut, parandalim të pastrimit të parave dhe pajtueshmëri të kërkuara sipas rregulloreve bankare gjermane dhe evropiane, veçanërisht kërkesat e përcaktuara në nenin 25a të Ligjit Gjerman për Bankat ("KWG"), të përmbushen. Në nivel të konsoliduar, mbikëqyrja e grupit kryhet nga autoritetet gjermane të mbikëqyrjes financiare (BaFin dhe Bundesbank).

Bordi Menaxhues dhe anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, si dhe stafi në pozita të caktuara menaxheriale të grupit ProCredit, janë anëtarë të bordeve mbikëqyrëse të bankave ProCredit, krahas anëtarëve të pavarur të bordeve. ProCredit Holding përcakton udhëzimet e politikave dhe standardeve për menaxhimin e riskut dhe fusha të tjera të rëndësishme të operacioneve bankare, me qëllim që të sigurojë ekzistencën e strukturave dhe proceseve organizative të përshtatshme dhe uniforme në bankat ProCredit. Këto udhëzime plotësohen nga shkëmbimi i rregullt i praktikave më të mira brenda grupit ProCredit. Për më tepër, ProCredit Holding ofron mbështetje në formësimin e politikave të burimeve njerëzore dhe në zhvillimin dhe ofrimin e kurrikulave në akademitë tona ProCredit. Prioritetet tona për zhvillimin e TI-së dhe softuerit përcaktohen në Strategjinë e Grupit për TI. Zgjidhjet optimale të TI-së janë pjesë qendrore e zbatimit të strategjive tona të biznesit dhe të riskut. Quipu GmbH, filial 100% në pronësi të ProCredit Holding, zhvillon aplikacione softuerike të përshtatura për grupin ProCredit. Në bashkëpunim të ngushtë, sistemet e përdorura në lidhje me operacionet bankare për klientët, funksionet e ndryshme të thesarit, si aplikacionet për kontabilitet dhe raportim, zhvillohen dhe zbatohen nga Quipu. Grupi ProCredit i ndan operacionet e tij afariste në segmente rajonale:

- Evropa Juglindore, që përbëhet nga shtatë banka në këto vende: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari (duke përfshirë një degë në Greqi), Kosovë, Maqedoni e Veriut, Rumani dhe Serbi
- Evropa Lindore, me tri banka në këto vende: Gjeorgji, Moldavi dhe Ukrainë
- Amerika Jugore, që përbëhet nga një bankë në Ekuador
- Gjermani, që përbëhet nga Banka ProCredit në Gjermani, ProCredit Holding, Quipu dhe Akademia ProCredit në FÜRth

Performanca financiare e Bankës ProCredit në Kosovë




Performanca financiare e ProCredit Bank Kosova

Gjatë vitit 2024, Banka ProCredit ka demonstruar qëndrueshmëri dhe rritje të fuqishme financiare, duke arritur performancë solide në të gjithë treguesit kryesorë. Qasja jonë e disiplinuar ndaj menaxhimit të riskut, investimet strategjike dhe zgjidhjet e fokusuara në klient kanë kontribuar në fitim të qëndrueshëm, duke forcuar më tej pozitën në treg. Banka ka mbajtur një bilanc të gjendjes të qëndrueshëm, likuiditet të fortë dhe mjaftueshmëri të qëndrueshme të kapitalit, duke e forcuar pozitën si një institucion financiar i besueshëm.

2024 ishte një vit historik për ne, +165 milionë € është rritja më e lartë ndonjëherë në asete. Struktura e aseteve vazhdoi të dominohej nga kreditë dhe paradhëniet për klientë në 69%, e pasuar nga paratë e gatshme dhe bilancet me bankat qendrore në 13% dhe investimet në letra me vlerë në 11%.


Një pjesë e konsiderueshme e aseteve të bankës është alokuar në investime në letra me vlerë, duke arritur nivelin e një portfolio prej 141 milionë € (13% rritje nga viti 2023). Këto investime sigurojnë një burim të qëndrueshëm të të ardhurave, ndihmojnë në menaxhimin e riskut dhe sigurojnë likuiditetin. Investimet në letra me vlerë shërbejnë si një opsion i besueshëm investimi, duke ofruar kthime të parashikueshme dhe njëherazi duke e diversifikuar portfolion e aseteve të bankës.



Përveç kësaj, ato luajnë një rol kyç në përmbushjen e kërkesave rregullative dhe në ruajtjen e stabilitetit financiar. ProCredit Bank ka investuar në letra me vlerë që janë shumë të sigurta, me një vlerësim minimal krediti AA-, që tregon cilësi të fortë krediti dhe stabilitet të fortë financiar.

Për më tepër, banka regjistroi rritjen më të lartë të portfolios së kredive ndonjëherë, prej 18% ose 133 milionë €, e nxitur nga një përkushtim i madh për mbështetjen e individëve privatë, bizneseve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Kreditë për biznese përbëjnë përafërsisht 78.4% të vëllimit të portfolios sonë të kredive të pashlyera. Në përputhje me misionin tonë për të mbështetur NMVM-të, si sektori që ndihmon ekonominë të rritet duke krijuar vende pune, ne jemi zgjedhja e parë për klientët e biznesit dhe,

si rezultat, mbajmë portfolion më të madhe të kredive për biznese prej 691 milionë €, ose 20% e pjesës së tregut në sektorin bankar në Kosovë. Planifikojmë ta forcojmë ekspertizën dhe fokusin tonë në financimin e investimeve në efikasitet energjetike, energji të ripërtërishme dhe iniciativa të gjelbra, si për klientët tanë të biznesit ashtu edhe për klientët privatë. Me një rritje vjetore prej 9.1 milionë €, ne kemi arritur 126 milionë € kredi të gjelbra në fund të vitit 2024. Ne po angazhohemi me partnerë, si BERZH-i, për krijimin e produkteve dhe mbështetjeve të reja. Krah për krah me klientët tanë, partnerët dhe stafin, ne po krijojmë vlera duke mbrojtur njëkohësisht natyrën për gjeneratat e ardhshme.




Ne kemi raportuar gjithashtu cilësinë më të mirë të aseteve në treg përmes raportit më të ulët të kredive joperformuese, duke demonstruar menaxhim të fuqishëm të riskut dhe cilësi të aseteve.

Detyrimet tona totale përbëjnë 89% të vlerës totale të aktiveve, duke pasqyruar nivelin e leverazhit dhe strukturën e financimit. Kjo ofron një pasqyrë për stabilitetin financiar të bankës, ekspozimin ndaj riskut dhe varësinë nga fondet e huazuara në raport me bazën e aseteve.

Duke pasur parasysh pozitën tonë të likuiditetit dhe menaxhimin e riskut, niveli i depozitave të klientëve të bankës na mundëson t'i përdorim ato si burimin kryesor të financimit për operacionet e kredidhënies. Prandaj, përdorimi i "financimit nga jo-klientët" është i kufizuar.

Duke marrë parasysh dominimin e depozitave shumë të qëndrueshme dhe të larmishme të klientëve në financimin e biznesit të bankës, konsiderojmë se risku i financimit është i ulët. Krahas kësaj, banka ka përjetuar një rritje të dukshme në borxhin e varur, i cili është rritur për 4 milionë €, duke theksuar një zhvillim kyç në strukturën e kapitalit të bankës gjatë vitit 2024.



Në anën e detyrimeve, komponenti mbizotërues janë depozitat e klientëve; në vitin 2024 ne arritëm vlerën prej 1.080 milionë € depozita. Rritja prej 144 milionë € jo vetëm që është rritja më e madhe që kemi pasur ndonjëherë, por




gjithashtu është rritja më e lartë në sektorin bankar në Kosovë. Fushatat tona kreative, produktet e thjeshta dhe marrëdhënia e afërt me klientët jo vetëm që na kanë ndihmuar të arrijmë objektivat strategjike dhe të tejkalojmë planin tonë të biznesit, por gjithashtu kanë ndihmuar klientët tanë të përfitojnë nga fushatat tona dhe të mbajnë të sigurt depozitat e tyre.

Ne synojmë të promovojmë ndërmjetësimin financiar lokal, d.m.th. t'i mobilizojmë kursimet lokale për të mbështetur kredidhënien për bizneset e vogla vendore si dhe kredidhënien për klientët privatë. Ne i kushtojmë rëndësi llogarive rrjedhëse dhe kursimeve fleksibile me qëllim të menaxhimit të kostos së fondeve dhe i inkurajojmë klientët që shërbimet bankare t'i realizojnë me ne.

Depozitat e klientëve sipas produkteve



Totali përfshin llogaritë e tjera të klientëve.




Gjatë vitit 2024, Banka ProCredit ka demonstruar qëndrueshmëri dhe rritje të fuqishme financiare, duke arritur performancë solide në të gjithë treguesit kryesorë. Qasja jonë e disiplinuar ndaj menaxhimit të riskut, investimet strategjike dhe zgjidhjet e fokusuara në klient kanë kontribuar në fitim të qëndrueshëm, duke forcuar më tej pozitën në treg. Banka ka mbajtur një bilanc të gjendjes të qëndrueshëm, likuiditet të fortë dhe mjaftueshmëri të qëndrueshme të kapitalit, duke e forcuar pozitën si një institucion financiar i besueshëm.

Të ardhurat neto nga interesi u rritën për 21%, duke arritur në 45.0 milionë €

Të ardhurat nga interesi i kredive u rritën për 21%, duke arritur në 46 milionë €, të nxitura nga zgjerimi i portfolios së kredive që gjeneroi 8.0 milionë € shtesë krahasuar me vitin 2023.

Ndërkohë, rritja dhe diversifikimi i portfolios sonë të investimeve në letra me vlerë, e mbështetur nga investimet e vazhdueshme në asete shumë të sigurta me vlerësim të lartë AA-, solli një rritje prej 46% të të ardhurave nga letrat me vlerë. Në të njëjtën kohë, rritja jonë më e madhe nga viti në vit në depozita — e rritur për 144 milionë €, duke e çuar totalin e portfolios së depozitave në 1.080 milionë € — rezultoi në një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për interesin e depozitave. Ne kemi regjistruar 5.8 milionë € në interes për klientët, krahasuar me 3.8 milionë € në vitin 2023.



Të ardhurat neto nga interesi dhe të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat e tjera jo-nga-interesi u rritën për 431 mijë €, duke arritur 7.3 milionë €

Gjatë vitit 2024, ne lansuam disa fushata duke u ofruar klientëve një gamë të gjerë të produkteve

dhe shërbimeve. Promocionet si “0 € tarifë e mirëmbajtjes për 12 ose 24 muaj” kontribuan në një rënie të lehtë prej 5% në të ardhurat nga tarifa e mirëmbajtjes së llogarive, që arritën në një total prej 3.9 milionë €.

Shpenzimet e personelit u rritën për 0.8 milion €, duke arritur në 7.6 milionë € në vitin 2024

Ne e kemi zgjeruar ekipin tonë për 15%, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 400 profesionistë të shkathtë, të vlerësuar si ndër më të trajnuarit dhe më të paguarit në sektorin bankar. Përmes investimeve të vazhdueshme në programet e trajnimit dhe në akademitë e brendshme, ne sigurohemi që ekipi ynë të mbetet në krye të përsosmërisë në industri.


Ne i kemi rritur në mënyrë strategjike shpenzimet administrative në TI për 29% për të përmirësuar infrastrukturën tonë digjitale, me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve bankare inovative, të sigurta dhe efikase. Në vitin 2024 kemi lansuar “Hapjen e llogarisë në mënyrë digjitale”, duke u ofruar klientëve tanë mundësinë për të hapur llogarinë online brenda vetëm 10 minutash nga kudo.

Gjithashtu i kemi rritur shpenzimet për sponsorizime dhe marketing duke i mbështetur më shumë se 20 ngjarje kulturore dhe sportive, si festivali më i madh muzikor në Kosovë – “Sunny Hill Festival”, Superliga e Basketbollit, DokuFest, KosICT etj. Të qenit të pranishëm në momentet e argëtimit dhe fitores së klientëve tanë do të ndihmojë në rritjen e markës sonë dhe në forcimin e lidhjes sonë.

Arritjet përgjatë viteve



Arritjet përgjatë viteve



Tregu dhe konteksti ekonomik



Tregu dhe konteksti ekonomik

Peizazhi ekonomik në Kosovë

Kosova, e vendosur në Ballkanin Perëndimor, vazhdon të evoluoi ekonomikisht pavarësisht kompleksiteteve historike. Vendi ka dëshmuar rritje të qëndrueshme gjatë dekadës së fundit, duke u pozicionuar si një treg në zhvillim me mundësi të prekshme për zhvillim të qëndrueshëm dhe investime. Me një popullsi të vlerësuar prej rreth 1.6 milionë, Kosova ka një nga demografitë më të reja në Evropë, fakt ky që ndikon si në tregun e punës ashtu edhe në perspektivën më të gjerë ekonomike të vendit.

PBB i Kosovës zakonisht ka shënuar rritje pozitive gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, me norma reale vjetore të rritjes që zakonisht variojnë ndërmjet 3% – 4%. E njëjta pritjet të vazhdojë edhe në vitet në vijim. Normat e inflacionit, ndonëse tradicionalisht modeste, kanë pësuar presion rritës vitet e fundit për shkak të çmimeve më të larta të energjisë dhe sfidave në zinxhirin e furnizimit. Norma mesatare e inflacionit rezultoi nga 4.9% në 2023 në 3.8% në 2024. Parashikimet e FMN-së tregojnë se inflacioni pritjet të jetë në këto nivele edhe në periudhat e ardhshme.


Pavarësisht përparimit të dukshëm, Kosova vazhdon të ballafaqohet me norma relativisht të larta papunësie, ku të dhënat më të fundit (2023) tregojnë se norma e papunësisë është

10%, që megjithatë paraqet një përmirësim të madh krahasuar me vitet e mëparshme.

Ekonomia e Kosovës mbështetet nga shërbimet (50-60% e PBB-së), industria (20-25%) dhe bujqësia (8-15%). Banka ProCredit në Kosovë luan një rol vendimtar në mbështetjen e këtyre sektorëve. Duke mbajtur 20% të pjesës së tregut të kredive totale për biznese, banka kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e sektorit privat, i cili është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në vitin 2024, Banka ProCredit alokoi 78% të portfolios së saj të kredive për kreditë e biznesit, shumë mbi mesataren e sektorit prej 58%, duke theksuar përkushtimin e saj ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe


të mesme (NVM), që janë nxitësit kyç të ekonomisë. Në sektorin e shërbimeve, financimi i Bankës ProCredit u mundëson bizneseve të zgjerohen dhe të jenë inovative.

Historikisht, Kosova ka pasur deficit të konsiderueshëm tregtar në mallra, pasi importet vazhdimisht i kanë tejkaluar eksportet. Në vitin 2024, importet u rritën nga viti në vit për 7.1% (+420 milionë €), ndërsa eksportet për 9.3% (+80 milionë €). Përpjekjet për të nxitur prodhimin vendas, për të diversifikuar gamën e produkteve dhe për të rritur konkurrueshmërinë e eksporteve janë të vazhdueshme, por ende nuk e kanë ngushtuar plotësisht hendekun ndërmjet importeve dhe eksporteve.



Burimi: Perspektiva ekonomike botërore e FMN-së

Milionë EUR



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Nga ana tjetër, tregtia e shërbimeve e Kosovës zakonisht prodhon suficit, duke fituar më shumë nga eksportet sesa shpenzon për importet. Rritja në vitin 2024 e Eksporteve të Shërbimeve ishte 13.5% (+397 milionë €). Ky suficit nxitet nga sektorë si nënkontraktimi në TI, turizmi dhe transporti/logjistika, të lidhur me rrugët tregtare rajonale. Tregtia e jashtme, së bashku me remitencat dhe IHD-të, mbështesin të ardhurat e ekonomive familjare dhe stabilitetin e bizneseve. Banka ProCredit në Kosovë luan një rol kyç në lehtësimin e këtyre rrjedhave financiare.

Në vitin 2024, banka regjistroi 858 milionë € në transfertat hyrëse ndërkombëtare, një rritje prej 30% (+200 milionë €) nga viti paraprak. Transfertat dalëse nga klientët privatë dhe ata të biznesit arritën në 2.6 miliardë €, duke u rritur për 17% (+380 milionë €) nga viti 2023. Shërbimet e Bankës ProCredit në Kosovë, të cilat përfshijnë zgjidhje efikase për transferin e parave, ndihmojnë në forcimin e ekonomisë së Kosovës duke i mbështetur bizneset dhe familjet, si dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë ekonomike të vendit.

Pasqyra e sektorit bankar

Banka ProCredit në Kosovë është pozicionuar si një institucion financiar me orientim zhvillimor, i cili jo vetëm që shërben si “Hausbank” për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), por gjithashtu mbështetë nevojat digjitale në rritje të klientëve privatë. Banka ka përmirësuar vazhdimisht performancën e saj financiare, menaxhimin e riskut dhe nismat me ndikim social. Modeli i saj i biznesit thekson marrëdhëniet afatgjata me klientët, menaxhimin e matur të kredive dhe përkushtimin e madh ndaj qëndrueshmërisë, ku të gjitha këto kanë kontribuar në rritjen e fuqishme ekonomike dhe përfshirjen financiare në Kosovë. Banka ProCredit në Kosovë operon brenda një sektori financiar të qëndrueshëm dhe në zgjerim në Kosovë. Në dhjetor 2024, totali i asetëve të sektorit bankar arriti në afërsisht 8.5 miliardë €, duke pasqyruar një normë vjetore të rritjes prej rreth 13.5%. Depozitat në sektor arritën në rreth 6.9 miliardë €, me një rritje vjetore prej 13%, ndërsa portfolio e kredive ishte afërsisht 5.8 miliardë €, duke treguar një rritje vjetore prej 18.2%.

	2021	2022	2023	2024E
FDI (% reale e PBB)	5.6%	8.2%	9.2%	8.5%
Rrjedha hyrëse e remitencave (% reale e PBB)	14.5%	13.7%	13.8%	13.1%
Remitenat	EUR 1.15 mld.	EUR 1.22 mld.	EUR 1.36 mld.	EUR 1.35 mld.

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Qendrore e Kosovës

‘000

	Asetet	Portofoli i Kredisë	Investime në letra me vlerë	Depozitat e klientit	Ekuiteti
ProCredit	1,258,046	866,514	140,767	1,075,722	132,776
Pjesëmarrja e ProCreditit	15.0%	15.3%	14.2%	15.5%	13.4%
Sektori Bankar	8,396,922	5,664,984	993,156	6,922,246	990,260

	Fitimi i vitit	Kthimi në pasuri (KP)	Kthimi në ekuitet (KE)	Kreditë joperformuese	Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit
ProCredit	29.099	2.5%	23.2%	1.2%	16.4%
Pjesëmarrja e ProCreditit	16.0%	0.2pp	3.4pp	0.7pp	0.2pp
Sektori Bankar	182,137	2.3%	19.7%	1.9%	16.2%

Burimi: Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës

Banka ProCredit në Kosovë ka ofruar vazhdimisht rezultate financiare pozitive. Në dhjetor 2024, totali i depozitave qëndronte në 1,073 milionë € duke përfaqësuar një rritje prej 16% nga viti në vit. I njëjti model u vu re edhe te kreditë ku pati një rritje prej 18% krahasuar me vitin e kaluar, duke e çuar portfolion e kredive në 822 milionë €. Për më tepër, megjithëse ka pasur një rritje të shpejtë të portfolios së kredive, banka ka ruajtur një nivel të ulët të kredive joperformuese prej 1.2% në vitin 2024, që është ndër më të mirët në rajon, duke pasqyruar standarde të rrepta të vlerësimit dhe monitorim efektiv të portfolios. Kapitalizimi solid, një raport i lartë depozita/kredi (122%) si dhe avancimet digjitale i kanë mundësuar Bankës ProCredit në Kosovë të zgjerojë gamën e produkteve, duke mbajtur nën kontroll riskun.

ProCredit ka treguar performancë të mirë financiare gjatë dy viteve të fundit, ku Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është mbajtur vazhdimisht në rreth 16.0%, në përputhje me mesataren e tregut. Kjo thekson pozitën e fuqishme të kapitalit të bankës dhe menaxhimin efektiv të riskut. Për sa i përket fitimit, Kthimi në pasuri (KP) i Bankës ProCredit për dhjetor 2024 ishte 2.5%, pak mbi mesataren e tregut prej 2.4%, duke dëshmuar përdorimin efektiv të aseteve për të gjeneruar kthim nga asetet. Përveç kësaj, Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit i bankës ishte 23.2%, duke tejkaluar mesataren e tregut prej 20.4%, që pasqyron krijim të fuqishëm të vlerës për aksionarët. Duke i dhënë përparësi rritjes së qëndrueshme, efikasitetit operacional dhe praktikave të përgjegjshme të kredidhënies, ProCredit vendos

një pikë referimi të fuqishme për inovacionin dhe disiplinën financiare. Qasja e saj jo vetëm që nxit suksesin e vet, por gjithashtu kontribuon në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së përgjithshme të sektorit financiar.

Klientët dhe performanca e biznesit



Qasja jonë ndaj klientëve të biznesit

Banka ProCredit është e përkushtuar ndaj ruajtjes së konceptit “Hausbank”, i cili është i përshtatur për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), duke njohur rolin e tyre jetik në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Strategjia jonë përfshin bashkëpunim të ngushtë me NMVM-të përmes Këshilltarëve tanë të specializuar për Klientët e Biznesit, që na mundëson të kuptojmë plotësisht nevojat e tyre dhe të ofrojmë zgjidhje financiare të përshtatura, në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. Banka arriti me sukses të ruajë dhe të zgjerojë marrëdhënie afatgjata, me përfitime të ndërsjella, me klientët NMVM, duke forcuar edhe më shumë avantazhin e saj konkurrues në treg.

Në përputhje me strategjinë e grupit tonë, Banka ProCredit e ka zgjeruar modelin e biznesit “Hausbank” për të përfshirë jo vetëm financimin e kredive, por edhe një gamë të gjerë shërbimesh financiare moderne esenciale për NMVM-të. Këto shërbime përfshijnë një platformë të avancuar e-banking për transaksione kombëtare dhe ndërkombëtare pa penge, pagesa të pagave dhe pagesa masive, pagesa të faturave, shërbime të biznesit dokumentar, si dhe qasje në shërbime bankare digjitale 24/7. Shërbimet tona bankare fuqizojnë NMVM-të që të rriten dhe të funksionojnë më me efikasitet, duke nxitur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e tyre afatgjatë.

Ne synojmë të ndërtojmë partneritete të qëndrueshme me këto biznese, duke ofruar ekspertizë të specializuar nga Këshilltarët tanë për Klientët e Biznesit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse përbën themelin e modelit tonë të suksesshëm të biznesit, duke nxitur prosperitetin e NMVM-ve dhe të ekonomisë në tërësi.

Vëllimi total i ekspozimit kreditor për bizneset u arrit

EUR 690 milionë

deri në fund të vitit.

Përgjatë gjithë vitit, Banka ProCredit qëndroi e përkushtuar ndaj financimit të bizneseve dhe ofrimit të këshillave të vlefshme për t'i tejkaluar sfidat në mënyrë efikase. Ne i kemi dhënë rëndësi të veçantë ofrimit të zgjidhjeve të përshtatura financiare, veçanërisht për NMVM-të në sektorin e prodhimit dhe të TIK-ut, gjë që rezultoi në një depërtim të rëndësishëm në treg dhe në një rritje të dukshme të portfolios së kredive për biznese. Vëllimi total i ekspozimeve kreditore për bizneset arriti në 690 milionë € në fund të vitit.

Si pjesë e përkushtimit tonë ndaj shërbimeve bankare të përgjegjshme, Banka ProCredit i ka dhënë përparësi pajtueshmërisë me standardet mjedisore. Kjo përfshin nismat e prezantuara gjatë viteve të fundit që lidhen me “kreditë e

Pjesa e kredive të gjelbra për klientët e biznesit tani përbën më shumë se

15%

të portofolit total të kredive të biznesit.



gjelbra”, të cilat mbulojnë shërbimet financiare për projekte të efikasitetit të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe masa të tjera ekologjike. Në vitin 2024, ne i kemi inkurajuar në mënyrë aktive bizneset që të investojnë në zgjidhje për kursimin e energjisë, siç janë panelet solare dhe teknologjitë që zvogëlojnë ndotjen. Pjesa e kredive të gjelbra për klientët e biznesit tani përbën më shumë se 15% të portfolios totale të kredive për biznese.



Këshilltarët tanë të biznesit luajnë një rol vendimtar duke ofruar shërbime këshillimi të personalizuar, të cilat përfshijnë shërbime bankare gjithëpërfshirëse dhe udhëzime profesionale. Investimi i vazhdueshëm në trajnimin dhe zhvillimin afatgjatë të këshilltarëve tanë thekson përkushtimin tonë për të ofruar shërbime cilësore për NVM-të. Prezantimi i aplikimit online për NVM-të për hapjen e llogarive dhe aplikim për shërbime të ndryshme, i projektuar ekskluzivisht për klientët NVM, e ka thjeshtësuar procesin e hapjes së llogarisë përmes një faqeje të përshtatshme online dhe shumica e klientëve të rinj iu kanë bashkuar bankës përmes aplikimit online për NVM. Kjo zgjidhje inovative u mundëson NVM-ve që në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë të krijojnë marrëdhënie bankare me bankën tonë, duke i hapur rrugë mundësive të rritjes dhe nxitjes së suksesit në epokën digjitale.

Në vitin 2025, fokusi ynë mbetet në mbështetjen e investimeve afatgjata, veçanërisht iniciativave miqësore ndaj mjedisit, të orientuara drejt kursimit të energjisë, krahas vazhdimin të mbështetjes për bizneset prodhuese. Për më tepër, ne vazhdojmë t'i ndihmojmë bizneset në optimizimin e shitjeve përmes pikave të shitjes POS dhe mPOS, si dhe kanaleve digjitale. Synimi i përgjithshëm i Bankës ProCredit mbetet të shërbejë si një “Hausbank” e besueshme për bizneset e vogla dhe të mesme, duke nxitur partneritet afatgjatë dhe duke ofruar zgjidhje financiare të përshtatura për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e tyre.



Qasja jonë ndaj klientëve privatë

Për më shumë se 25 vjet, ne kemi qëndruar vazhdimisht pranë individëve dhe familjeve në përpjekjet e tyre për siguri financiare dhe përmirësim të cilësisë së jetës, qoftë përmes kursimit apo investimit. Ky përkushtim afatgjatë bazohet në përkushtimin tonë të fuqishëm ndaj shërbimit cilësor, praktikave të kujdesshme të financimit dhe teknologjisë bankare të fjalës së fundit – e disponueshme në çdo kohë për klientët tanë.

Gjatë vitit 2024, ne e kemi avancuar dhe diversifikuar edhe më tej gamën tonë të shërbimeve bankare të përshtatura për klientët privatë, ndërkohë që e kemi forcuar edhe praninë tonë fizike duke hapur pika shtesë të shërbimit në mbarë vendin. Secila nismë strategjike është ndërmarrë me kujdes, me qëllim të përmirësimit të përvojës së klientëve, ofrimit të zgjidhjeve financiare të personalizuar dhe ekspertizës përmes ekipit tonë të përkushtuar të këshilltarëve për klientë privatë. Në këtë kontekst, ne kemi inauguruar me sukses pesë pika të reja të shërbimit gjatë vitit, duke theksuar përpjekjet tona të vazhdueshme për të siguruar mbulim dhe qasje gjithëpërfshirëse në tërë territorin kombëtar.

Përkushtimi ynë ndaj inovacionit mbetet ngushtë i lidhur me nevojat në evoluim të klientëve tanë dhe me trendet më të gjera brenda industrisë bankare. Në vitin 2024, ne e kemi përmirësuar edhe më tej procesin tonë të hapjes së llogarisë në mënyrë digjitale, një nga

ofertat tona më të avancuara digjitale deri më sot – një zgjidhje inovative e hapjes së llogarisë në mënyrë digjitale që u mundëson klientëve të hapin llogari bankare në distancë, duke përdorur nënshkrimin digjital dhe duke eliminuar kështu nevojën për prani fizike në degët tona.

Për më tepër, zgjerimi strategjik i infrastrukturës sonë fizike vazhdon të luajë një rol vendimtar në ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, efikase dhe të përgjegjshme ndaj të gjitha segmenteve të klientelës sonë.

Ne i kushtojmë rëndësi maksimale reagimeve të klientëve, të cilat shërbejnë si gur themeli në formësimin dhe përmirësimin e shërbimeve tona. Si rrjedhojë, i gjithë ekipi ynë i shërbimit ndaj klientëve privatë ndan një objektiv të përbashkët: të ofrojë një përvojë bankare të nivelit më të lartë, duke i trajtuar me kujdes të gjitha nevojat e klientëve dhe duke synuar vazhdimisht t'i tejkalojë pritshmëritë e tyre.



Qasja jonë digjitale


Banka ProCredit i ka dhënë vazhdimisht përparësi zgjerimit të pranisë së saj digjitale për të përmirësuar angazhimin e klientëve dhe efikasitetin operacional. Strategjia digjitale e bankës përqendrohet në ofrimin e zgjidhjeve bankare pa pengesa dhe inovative për klientët. Si banka e parë në treg që ka digjitalizuar pothuajse të gjitha transaksionet jofinanciare, viti 2024 e vazhdoi këtë trend me prezantimin e mundësisë së hapjes së llogarisë në mënyrë digjitale për klientët privatë. Kjo zgjidhje përfshin aplikacionet për identifikim me video, njohje të fytyrës dhe nënshkrim elektronik, duke i mundësuar klientit të realizoi procesin e hapjes së llogarisë plotësisht online, pa pasur nevojë të vizitojë bankën. Ky produkt ofron një përvojë tërësisht digjitale të hapjes së llogarisë për klientët privatë përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë Aplikacionin Mobil për Shërbime Bankare dhe faqen e internetit të Bankës ProCredit.

Nga ana tjetër, duke zbatuar “Google Wallet” si një nga bankat e para në treg, Banka ProCredit thekson përkushtimin e saj për të përdorur dhe aplikuar teknologjitë e fjalës së fundit në mënyrë që klientët të kenë mjetet optimale për transaksione. Kjo zgjidhje u mundëson klientëve të kryejnë transaksione duke përdorur kartela të tokenizuara brenda telefonave të tyre Android, pa pasur nevojë të mbajnë me vete kartelat fizike.

Për më tepër, gjatë vitit 2024, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) filloi operimet për menaxhimin e tregjeve të energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës në Shqipëri dhe Kosovë. Banka ProCredit është caktuar si e vetmja Bankë e Shlyerjes (“Settlement Bank”), përgjegjëse për ekzekutimin e të gjitha transaksioneve financiare brenda këtij tregu të ri, duke siguruar saktësi dhe pajtueshmëri me standardet rregullative. Gjithashtu, banka shërben si anëtar i përgjithshëm i kliringut, duke garantuar pagesa me kohë dhe të sakta për transaksionet e energjisë në emër të pjesëmarrësve në treg. Banka ProCredit ka prezantuar gjithashtu një shërbim inovativ i cili u mundëson klientëve të paguajnë faturat doganore përmes SMS-it, duke eliminuar nevojën për procesimin tradicional. Kjo zgjidhje efikase u jep mundësi si klientëve privatë ashtu edhe atyre të biznesit që të kryejnë pagesat doganore në çdo kohë dhe nga kudo thjesht duke dërguar një SMS, duke siguruar që mallrat të mos vonohen në dogana. Përfundimisht, Banka ProCredit synon të ofrojë një përvojë bankare gjithëpërfshirëse duke ofruar si shërbime financiare, ashtu edhe jofinanciare përmes kanaleve të ndryshme digjitale. Njëkohësisht, mbetet e përkushtuar për të ofruar ekspertizë financiare të personalizuar përmes Këshilltarëve tanë për Klientë, duke garantuar mbështetje të përshtatur për nevojat e klientëve tanë për financim.



Punonjësit dhe kultura në vendin e punës



Punonjësit dhe kultura në vendin e punës

Në Bankën ProCredit në Kosovë, ne e kemi të qartë se punonjësit tanë janë themeli i suksesit tonë. Duke kultivuar një kulturë të rritjes, gjithëpërfshirjes dhe respektit, ne krijojmë një mjedis pune ku punonjësit mund të zhvillohen, ndërsa qasja jonë e bazuar në ndikim vihet në jetë në çdo nivel. Në vitin 2024, ne e vazhduam përkushtimin tonë ndaj zhvillimit të punonjësve, diversitetit gjinor dhe angazhimit në vendin e punës, elemente këto që janë thelbësore për strategjinë dhe vizionin tonë afatgjatë.

Zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve

Zhvillimi i punonjësve mbetet një ndër prioritetet kryesore për Bankën ProCredit në Kosovë dhe në vitin 2024 ne e kemi zgjeruar edhe më tej gamën e programeve tona të zhvillimit. Kemi ofruar mbi 130 orë trajnime për punonjës, duke pasqyruar kështu përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të avancuar shkathtësitë në të gjitha nivelet.

EUR 760,000

Të dedikuara
për trajnim dhe
zhvillim të stafit



Përmes Akademisë ProCredit dhe programeve të tjera të përshtatura të trajnimit, punonjësit kanë qasje si në zhvillimin teknik, ashtu edhe në zhvillimin për lidërsip, duke u mundësuar atyre të përparojnë brenda bankës dhe të realizojnë qëllimet tona afatgjata për qëndrueshmëri dhe ndikim. Si pjesë e përkushtimit tonë ndaj zhvillimit të punonjësve, ne jemi fokusuar në nxitjen e

potencialit drejtues të menaxhmentit tonë të nivelit të mesëm. Në vitin 2024, ne filluam një kurs menaxhimi njëjavor lidhur me diversitetin dhe gjithëpërfshirjen, me qëllim të pajisjes së liderëve tanë të ardhshëm me shkathtësitë për të krijuar vende pune gjithëpërfshirëse dhe për të promovuar barazinë gjinore. **Ky kurs shërben si një komponent i rëndësishëm në ngushtimin e hendekut gjinor dhe siguron që liderët tanë të kenë mjetet për të krijuar vende pune të balancuara dhe të drejta.**

Diversiteti dhe gjithëpërfshirja

Diversiteti gjinor është një aspekt kyç i kulturës sonë në vendin e punës. Në përputhje me strategjinë tonë globale, Banka ProCredit në Kosovë synon të krijojë një mjedis ku çdo individ, pavarësisht gjinisë, ka qasje të barabartë në mundësi. Deri në fund të vitit 2024, gratë përfaqësonin 61% të fuqisë sonë punëtore, një arritje domethënëse që jep një shembull të fuqishëm për organizatat e tjera në Kosovë, ku 77% e grave mbeten joaktive në tregun e punës. Ne jemi krenarë për rolin tonë në avancimin e barazisë gjinore në rajon dhe vazhdojmë të ndërmarrim hapa proaktivë për të mbyllur hendekun gjinor.

Plani i Veprimit Gjinator i Bankës ProCredit në Kosovë përfshin nisma të dizajnuara për të rritur qasjen në financa për bizneset që udhëhiqen nga gratë. Linja kreditore “Gratë në Biznes”, e prezantuar në vitin 2024, ofron produkte financiare të përshtatura me skema garancie të veçanta, që synojnë mbështetjen e ndërmarrëseve femra. Kjo nismë është vetëm një shembull se si ne i fuqizojmë gratë si brenda ashtu edhe jashtë bankës. Për më tepër, Banka ProCredit është e përkushtuar të sigurojë që gratë të kenë qasje të barabartë në rolet drejtuese dhe mundësitë për zhvillim në karrierë. Ne besojmë se duke nxitur një kulturë me diversitet dhe gjithëpërfshirje, përfitojmë jo vetëm ne si punëdhënëse, por edhe klientët dhe komunitetet. Në vitin 2024, 55% e pozitive menaxheriale të nivelit të mesëm në bankë udhëheqëshin nga gratë, duke nënvizuar kështu përkushtimin tonë ndaj barazisë gjinore në lidhje me liderhip.

Angazhimi dhe kultura në vendin e punës

Një kulturë pozitive në vendin e punës është thelbësore për kënaqësinë, qëndrueshmërinë dhe performancën e punonjësve. Në Bankën ProCredit në Kosovë, ne theksojmë komunikimin e hapur, respektin e ndërsjellë dhe përgjegjësinë e përbashkët. Kjo qasje i inkurajon punonjësit të ndihen të vlerësuar dhe të motivuar, duke kontribuar në angazhimin e tyre afatgjatë. Përpjekjet tona për të krijuar një mjedis pune gjithëpërfshirës shkojnë përtej diversitetit gjinor.

Në vitin 2024, ne e kemi zgjeruar gamën e programeve tona për angazhimin e punonjësve, duke u përqendruar në krijimin e një ndjenje përkatësie dhe respekti. Duke i trajtuar paragjykimet e pavetëdijshme përmes trajnimeve të rregullta për diversitetin dhe duke promovuar një kulturë pune të hapur e gjithëpërfshirëse, ne vazhdojmë të ndërtojmë një ekip që pasqyron vlerat tona thelbësore. **Përveç kësaj, ne e njohim rëndësinë që ka qëndrueshmëria mjedisore në angazhimin në vendin e punës. Në vitin 2024, ne e kemi zgjeruar nismën tonë të parkut solar “ProEnergy”, duke e rritur kapacitetin e tij për të prodhuar 5,000 MWh në vit, duke u dhënë punonjësve tanë mundësinë të kontribuojnë në qëllimet tona mjedisore dhe të ndihen krenarë për përpjekjet e bankës në lidhje me qëndrueshmërinë.**

Fuqizimi financiar i grave

Banka ProCredit në Kosovë është thellësisht e përkushtuar ndaj promovimit të fuqizimit financiar të grave. Në vitin 2024, ne i intensifikuam përpjekjet tona për të mbyllur hendekun gjinor duke e zgjeruar qasjen në shërbime financiare për gratë. Ne e kuptojmë se fuqizimi financiar i grave jo vetëm që e përmirëson jetën e tyre, por gjithashtu ka një ndikim të gjerë në zhvillimin ekonomik. Plani i Veprimit Gjinator i Bankës ProCredit në Kosovë përfshin masa për zvogëlimin e pengesave gjinore në biznes dhe për përmirësimin e qasjes në kapital për gratë ndërmarrëse. Këtë vit, ne jemi anëtarësuar në Aleancën Financiare për Gratë me qëllim të

forcimit të përkushtimit tonë ndaj përfshirjes financiare dhe fuqizimit ekonomik të grave. Gjithashtu, partneriteti ynë me 2X Global, një organizatë ndërkombëtare që promovon fuqizimin ekonomik të grave, na mundëson të veprojmë në përputhje me praktikën më të mira dhe të përshpejtojmë nismat e zhvillimit të kapaciteteve.

Gjatë vitit 2024, ne vazhduam gjithashtu të mbështesim nisma që kanë për synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe fuqizimin e grave përmes trajnimeve dhe edukimit. Programet e trajnimit të Akademisë ProCredit, përfshirë kursin e specializuar për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen të dedikuar për menaxherët e nivelit të mesëm, janë dizajnuar për t'i pajisur punonjësit me mjetet për të sfiduar normat shoqërore dhe për të kontribuar në një mjedis pune më të barabartë.

Përkushtimi i Bankës ProCredit në Kosovë ndaj zhvillimit të punonjësve, diversitetit gjinor dhe angazhimit në vendin e punës është në qendër të vizionit tonë për krijimin e një mjedisi pune të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe pozitiv. Angazhimi ynë ndaj fuqizimit financiar të grave, diversitetit në vendin e punës dhe mundësive të barabarta na mundëson të ndërtojmë një ekip që pasqyron vlerat tona dhe që mbështet komunitetet të cilave u shërbejmë. Përmes këtyre përpjekjeve, ne vazhdojmë të kontribuojmë për një botë më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, ku të gjithë individët kanë mundësi të përparojnë.



**Qëndrueshmëria
dhe përgjegjësia
sociale**

Qasja jonë ndaj mjedisit

Minimizimi i gjurmës sonë mjedisore mbetet një nga objektivat kryesore të Bankës ProCredit. Gjatë vitit 2024, ne vazhduam të analizojmë dhe monitorojmë në mënyrë sistematike ndikimet mjedisore që rrjedhin nga aktivitetet tona të përditshme, duke vendosur caqe të matshme për uljen e konsumit të energjisë, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë.

Kriteret e efikasitetit të energjisë dhe qëndrueshmërisë janë integruar gjithashtu në rinovimin e hapësirave ekzistuese, si edhe në projektimin dhe ndërtimin e degëve të reja bankare gjatë vitit 2024, duke pasqyruar përkushtimin tonë për zbatimin e standardeve më të larta mjedisore në të gjitha asetet tona fizike. Përveç zbatimit të standardeve të ndërtesave të gjelbra dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve, ne kemi qenë të përkushtuar në publikimin e arritjeve tona mjedisore si brenda institucionit, ashtu edhe në publik të gjerë, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të punonjësve, klientëve dhe komunitetit të biznesit në Kosovë.

Një nga projektet më të rëndësishme të Bankës ProCredit në fushën e qëndrueshmërisë është parku solar “ProEnergy” me kapacitet prej 3 MWp, i cili filloi operimin në korrik 2023. Gjatë vitit 2024, ky park solar ka vazhduar të prodhojë energji të pastër, me një prodhim prej rreth 4,100 MWh në vit.

Ky investim kontribuon drejtpërdrejt në zvogëlimin e varësisë së Kosovës nga burimet e energjisë me bazë karboni dhe në uljen e emetimeve të gazrave serrë me afërsisht 3,484 tCO₂eq çdo vit.

Vlerësimi i riskut mjedisor dhe social në Bankën ProCredit mbetet komponent thelbësor i qasjes sonë të përgjithshme ndaj menaxhimit të riskut. Përveç masave të brendshme për të minimizuar ndikimin mjedisor të aktiviteteve tona, ne kemi zhvilluar dhe zbatuar mekanizma të strukturuar për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të klientëve që i financojmë. Në vitin 2024, ne kemi përditësuar Standardin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social, duke pasqyruar praktikën më të avancuar ndërkombëtare dhe përkushtimin tonë ndaj financimit të përgjegjshëm. Ky përditësim përfshin zgjerimin e listës së përjashtimit të aktiviteteve që nuk financohen, duke prezantuar për herë të parë ndalimin e financimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me thëngjillin, sipas përkufizimeve të detajuara në Shënimet Plotësuese të Listës së Përjashtimit.

Ne e kemi miratuar gjithashtu një Strategji të re për Mirëqenien e Kafshëve, me fokus të veçantë në sektorin e bujqësisë, posaçërisht në financimin e klientëve që merren me blegtori dhe rritjen e bagëtive, duke siguruar pajtueshmëri me standardet për trajtim njerëzor dhe etik të tyre.



Një tjetër përmirësim i rëndësishëm ka qenë përditësimi i qasjes sonë ndaj financimit të aktiviteteve në zonat e mbrojtura natyrore, bazuar në udhëzimet e Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Kjo na mundëson të vlerësojmë me kujdes aktivitetet që mund të kenë ndikim në biodiversitetin dhe ekosistemet, duke siguruar që financimi ynë të jetë në përputhje me standardet mjedisore ndërkombëtare.

Në dekadën e fundit, Portfolio e Kredive të Gjelbra të Bankës ProCredit ka shënuar rritje domethënëse duke arritur në 14.3% të portfolios totale të kredive. Kjo paraqet një përkushtim të fuqishëm ndaj financimit të qëndrueshëm dhe mbështetjes për zhvillimin e projekteve që kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit dhe eficiencës së energjisë në Kosovë.

Kosova ka një miks energjetik që mbështetet kryesisht në burime jo të ripërtërishme, kryesisht linjit, i cili është ndotës dhe shkakton varësi të lartë nga importet e energjisë. Në këtë situatë, Banka ProCredit ka marrë një rol të rëndësishëm në financimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme, sidomos të sistemeve fotovoltaike. Gjatë vitit 2024, banka ka financuar sisteme fotovoltaike për qëllime komerciale dhe vetëkonsum me një total prej 14.3 MW, duke mundësuar qëndrueshmëri më të madhe për klientët dhe uljen e kostove të tyre të energjisë.



Që nga viti 2019, Banka ProCredit ka financuar rreth 44 MW të kapacitetit të instaluar të energjisë solare në Kosovë, duke kontribuar drejtpërdrejt në uljen e varësisë nga energjia e bazuar në thëngjill dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë ekonomike të klientëve tanë. Portfolio e Kredive të Gjelbra u rrit për 11 milionë € gjatë vitit 2024, duke arritur një total prej 125.5 milionë €, përfshirë një rritje prej 9 milionë € në investimet nga bizneset dhe një rritje prej 2 milionë € në portfolion nga individët privatë. Ky financim ka pasur një ndikim të prekshëm në mjedis, duke evituar një ekuivalent prej 19,430 ton CO₂ përmes kredive të gjelbra të disbursuara gjatë vitit 2024.

Angazhimi në komunitet dhe ndikimi social

Në ProCredit, sukcesi i vërtetë matet përmes ndikimit pozitiv që kemi në komunitetin tonë. Ne jemi të përkushtuar të sjellin ndryshim afatgjatë dhe të prekshëm në jetën e klientëve tanë dhe të shoqërisë.

Gjatë vitit 2024, ne kemi kontribuar me krenari në:



Ja ndryshimi që kemi bërë:

Mbështetja në kulturë dhe edukim

Ne mbështesim në mënyrë aktive nismat kulturore dhe edukative që i shërbejnë komunitetit dhe promovojnë shkëmbimin e dijes. Duke festuar kreativitetin, trashëgiminë kulturore si dhe artin e të mësuarit, ne synojmë të vëmë në pah atë që e bën Kosovën unike.

Kontributet tona përfshijnë:

- Sponsorizimin e ngjarjeve të mëdha kulturore si “Sunny Hill Festival”, “Dokufest”, koncerti i Yll Limanit, Edicioni i 2-të i “Festivali i Këngës”, “Prishtina Music Week” dhe “Jazz Concert Elina Duni & Band”, duke festuar skenën e gjallë artistike të Kosovës.
- Mbështetjen financiare të konferencave edukative, duke përfshirë “KosICT 2024”, “Kongressi i Farmacistëve”, Konferencën “Gjenerata e Gjelbër” dhe Konferencën “DevCon”, duke nxitur në këtë mënyrë rritjen teknologjike dhe profesionale.
- Mbështetjen për 25-vjetorin e “Play International” (Fushata “PLAY25”) për të inkurajuar edukimin kulturor dhe sportiv.



Angazhimi në komunitet dhe zhvillimi i sportit

Ne besojmë në fuqinë e sportit dhe projekteve për komunitetin, dhe këtë e dëshmojmë me nisma të tilla si:

- Duke qenë sponsor gjeneral i Superligës së Basketbollit të Kosovës 2024-2025, dhe në këtë mënyrë duke e përforcuar përkushtimin tonë për angazhimin e të rinjve dhe zhvillimin e sportit.
- Mbështetja për rinovimin e “Fit Arena” në Mitrovicën e Veriut, duke siguruar kushte më të mira sportive për komunitetin lokal.

Biznesi dhe rritja ekonomike

Ne kontribuojmë në forcimin e mjedisit biznesor në Kosovë duke sponsorizuar forume dhe ngjarje rrjetëzimi, si:

- Forumi Ekonomik Zvicër-Kosovë 2024, duke promovuar bashkëpunimin ekonomik.
- Konventa e Industrisë së Drurit, Edicioni i 7-të, duke mbështetur zhvillimin e industrisë.
- Forumi Ekonomik Gjermano-Kosovar, duke nxitur partneritete biznesore ndërkombëtare.
- Mbështetja e ngjarjeve si Festivali Global i Gastronomisë Shqiptare, duke festuar trashëgiminë kulturore dhe gastronominë e qëndrueshme.

Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia sociale

Si pionierë në financimin e gjelbër për 25 vjet, investimi ynë shtrihet edhe në nisma që theksojnë qëndrueshmërinë dhe kauzat sociale:

- Sponsorizimi i Lidhjes së Krijuesve Kosovarë, një nismë që promovon inovacionin dhe edukimin STEM tek të rinjtë.
- Donacione për Shoqatën “Down Syndrome Kosova”, Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, OJQ “HAVE HOPE” që avokon për pacientët me kancer të gjirit, fushatën “S’ka si n’shpi” nga SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës si dhe donacione për Qendrën Sociale-Edukative – të menaxhuar nga SOS Kopshti.

Duke e forcuar rolin tonë si një qytetar korporativ i përgjegjshëm, Banka ProCredit vazhdon të dëshmohej si një forcë për ndryshim pozitiv në peizazhin social dhe ekonomik të Kosovës. Përmes këtyre përpjekjeve, ne mbetemi të përkushtuar për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe pasurim kulturor për gjeneratat e ardhshme.

Së bashku, ne ndërtojmë komunitete më të fuqishme, më të bashkuara dhe më të lumtura.



Menaxhimi i riskut



Menaxhimi i riskut

Në qendër të modelit tonë të biznesit të përgjegjshëm në aspektin social qëndron një qasje e fuqishme dhe transparente ndaj menaxhimit të riskut. Ky përkushtim është i rrënjosur thellë në kulturën dhe në nivelin tonë të pranueshëm për risk, duke siguruar që çdo vendim që marrim të jetë i balancuar me kujdes dhe i bazuar në informacion. Duke i dhënë përparësi transparencës dhe vendimmarrjes së bazuar në informacion, ne kultivojmë një mjedis të vetëdijshëm për riskun, i cili jo vetëm që mbron palët tona të interesit, por edhe nxit rritjen dhe inovacionin e qëndrueshëm. Parimet e menaxhimit të riskut dhe strategjia e riskut e Bankës ProCredit nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme krahasuar me vitin e kaluar.

Në përgjithësi, vitet e fundit janë karakterizuar nga ngjarje makroekonomike dhe gjeopolitike të pafavorshme. Kjo prirje pritet të vazhdojë, duke e mbajtur shkallën e pasigurisë të lartë si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Deri më tani, këto zhvillime nuk kanë pasur ndonjë ndikim domethënës në bankën tonë. Megjithatë, këta faktorë do të jenë gjithashtu në fokus të aktiviteteve tona të menaxhimit të riskut në vitin 2025.

Ne do të vazhdojmë të monitorojmë me kujdes zhvillimet në tregjet lokale dhe ndërkombëtare për të vlerësuar ndikimin e tyre dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura me kohë, sipas nevojës.

Përveç kësaj, kërkesat rregullative për bankat janë në evolucion të vazhdueshëm. Në përgjithësi vërehet një shtëngim i kërkesave rregullative.

Banka gjithmonë ka vepruar në përputhje me limitet e brendshëm si dhe me të gjitha kërkesat rregullative të zbatueshme gjatë vitit financiar 2024. Edhe duke marrë parasysh pasiguritë e përmendura më lart, profili i përgjithshëm i riskut i bankës mbetet i përshtatshëm. Ky vlerësim bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të risqeve individuale, të cilat paraqiten në detaje në këtë raport për riskun.

Parimet kryesore të kulturës së riskut

Në ProCredit, kultivimi i një kulture të fuqishme të riskut është pjesë përbërëse e suksesit dhe stabilitetit tonë afatgjatë. Ne jemi të përkushtuar për integrimin e menaxhimit të riskut në çdo aspekt të operacioneve tona, duke siguruar që të gjithë anëtarët e stafit, nga drejtuesit e lartë deri te ekipet operacionale, të kenë përgjegjësi të përbashkëta në identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e risqeve. Kultura jonë e riskut është e ndërtuar mbi një themel transparence, përgjegjësie dhe komunikimi të hapur, ku të gjithë anëtarët e stafit inkurajohen të paraqesin shqetësimet e tyre dhe të angazhohen në

menaxhimin proaktiv të riskut. Duke e lidhur ndërgjegjësimin për riskun me objektivat tona strategjike, ne krijojmë një mjedis ku vendimmarrja e shëndoshë mbështetet nga një kuptim i thellë i risqeve të mundshme, duke na mundësuar të marrim vendime të bazuara në informata që e nxisin rritjen e qëndrueshme dhe njëkohësisht i minimizojnë kërcënimet e mundshme. Menaxhimi ynë i riskut bazohet në tri parime që i udhëheqin aktivitetet tona të biznesit. Përmes zbatimit të tyre të vazhdueshëm, ne kontribuojmë në mënyrë aktive në zbutjen e risqeve ndaj të cilave banka jonë ekspozohet. **Këto parime janë:**

Fokusimi në biznesin kryesor: Modeli ynë i biznesit është i fokusuar: Ne jemi të specializuar në ofrimin e shërbimeve financiare për NMVM-të dhe klientët privatë. Ne zbatojmë kriteret strikte të përzgjedhjes dhe kryejmë një analizë gjithëpërfshirëse të klientëve tanë. Kjo përfshin edhe vlerësimin individual të aspekteve Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (MSQ) për të gjithë klientët e biznesit. Të ardhurat gjenerohen kryesisht në formën e të ardhurave nga interesi i kredive dhe nga tarifat për operimet me llogari si dhe nga pagesat. Të gjitha operacionet e tjera të bankës kryhen kryesisht në mbështetje të biznesit kryesor. Në kuadër të veprimtarive tona, banka jonë merr përsipër kryesisht riskun kreditor të klientëve,

riskun e normës së interesit, riskun operacional dhe riskun e likuiditetit.

Diversifikimi dhe shërbimet transparente:

Fokusi strategjik i ProCredit si një “Hausbank” për NMVM-të dhe klientët privatë nënkupton një shkallë të lartë diversifikimi si në aktivitetet e kredithënies ashtu edhe në atë të depozitave. Ky diversifikim shtrihet në rajone të ndryshme (urbane dhe rurale), në grupe të ndryshme të klientëve (NMVM, klientë privatë) dhe në një numër të madh të sektorëve ekonomikë. Për më tepër, një karakteristikë qendrore e modelit tonë të biznesit është përkushtimi ynë për t’u ofruar klientëve shërbime financiare të qarta dhe transparente. Këto qasje japin një kontribut të rëndësishëm në zbutjen e riskut në grup.

Përzgjedhja e kujdesshme e stafit dhe trajnimi:

Shërbimet bankare të qëndrueshme dhe të përgjegjshme kërkojnë punonjës të përkushtuar, të cilët identifikohen me vlerat tona dhe i zbatojnë ato në mënyrë aktive në punën e tyre të përditshme. Prandaj, ne i kushtojmë rëndësi të madhe përzgjedhjes së kujdesshme të stafit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Standardet tona në këtë fushë bazohen në respekt të ndërsjellë, një shkallë të lartë të përgjegjësisë personale, angazhim dhe besnikëri afatgjatë ndaj grupit ProCredit, si dhe një kulturë të hapur dhe transparente të komunikimit.

Nga perspektiva e riskut, punonjësit e trajnuar mirë, të cilët mendojnë në mënyrë kritike dhe i shprehin hapur mendimet e tyre, luajnë një rol kyç në identifikimin, menaxhimin dhe zvogëlimin e risqeve.

Qeverisja dhe organizimi i riskut

Një qeverisje e fuqishme e riskut është me rëndësi themelore për objektivat tona strategjike dhe suksesin operacional. Korniza jonë e qeverisjes së riskut është e dizajnuar për të identifikuar, vlerësuar, menaxhuar dhe zbutur risqet në mënyrë efektive, duke siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e operacioneve tona. Korniza e përgjithshme e qeverisjes së riskut përbëhet nga Bordi i Drejtorëve, Komiteti i Menaxhimit të Riskut, Komiteti i Auditimit, Bordi Menaxhues, modeli i tri linjave të mbrojtjes dhe komitetet e ndryshme për menaxhimin e riskut të themeluara në nivel bankë.

Korniza e Menaxhimit të Riskut të Bankës ProCredit përfshin politika dhe standarde të ndryshme për menaxhimin e riskut që i përcaktojnë standardet në nivel grupi për identifikimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe komunikimin e risqeve. Ajo përcakton kërkesa detyruese për menaxhimin e të gjitha risqeve materiale ndaj të cilave ekspozohet banka. Përveç kërkesave të grupit, politikat dhe standardet e bankës për riskun përfshijnë të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative vendore. Politikat e bankës miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe përditësohen të paktën një herë në vit ose ad hoc, sipas nevojës.



Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe modeli i tri linjave të mbrojtjes

Koncepti i tri linjave të mbrojtjes ka rëndësi qendrore për menaxhimin e riskut dhe kulturën tonë të riskut, pasi përcakton që menaxhimi i duhur i riskut dhe mbrojtja kundër risqeve të padëshiruara nuk kufizohet vetëm në funksionet e riskut.

Modeli i tri linjave të mbrojtjes

Linja e 1-rë e mbrojtjes - Pronësia e riskut

Banka ProCredit ka njësi biznesi që gjenerojnë të ardhura e të cilat e përbëjnë linjën e parë të mbrojtjes në sistemin e kontrollit të brendshëm të bankës.

Funksionet e linjës së parë vendosin kontrollet dhe menaxhojnë risqet për të gjitha aktivitetet që ato i menaxhojnë.

Detyrat e kontrollit në linjën e parë të mbrojtjes theksojnë gjithashtu përgjegjësinë e dyfishtë të këtyre departamenteve, të cilat njëkohësisht krijojnë biznes për Bankën ProCredit dhe i mbikëqyrin risqet dhe kontrollet përkatëse, si dhe standardet minimale në nivel grupi.

Linja e 2-të e mbrojtjes - Mbikëqyrja e riskut

Linja e dytë e mbrojtjes përfshin funksionet e menaxhimit të riskut, pajtueshmërisë dhe PPP-së.

Detyrat e tyre kryesore përfshijnë ofrimin e udhëzimeve, mbikëqyrjen e riskut, monitorimin dhe raportimin e incidenteve dhe informacionit relevant për riskun si dhe monitorimin e të gjitha llojeve të risqeve financiare dhe jofinanciare. Duke i përcaktuar standardet minimale në nivel grupi dhe kërkesat e kontrollit për parandalim dhe zbulim, Banka ProCredit e ka forcuar linjën e dytë të mbrojtjes në përputhje me standardet vendore, gjermane dhe të BE-së. Në këtë mënyrë, ProCredit Holding sigurohet që kërkesat të përfshihen në politikat dhe procedurat e grupit dhe që të njëjtat të përshtaten në nivel lokal nga banka.

Linja e 3-të e mbrojtjes - Sigurimi i pavarur

Linja e tretë e mbrojtjes përbëhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm, i cili mbështetet nga Auditimi i Grupit në ProCredit Holding që ofron udhëzime teknike dhe sigurim të cilësisë.

Funksioni i auditimit të brendshëm kryen vlerësimin e risqeve të institucionit përkatës të paktën një herë në vit me qëllim të hartimit të një plani vjetor të auditimit të bazuar në risk. Duke u bazuar në këtë, ai auditon dhe vlerëson në mënyrë të pavarur përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të sistemit të menaxhimit të riskut. Auditimi i Brendshëm i raporton Komitetit të Auditimit në baza tremujore.

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe nivele shtesë të kontrollit të jashtëm të cilat i plotësojnë tri linjat ekzistuese të brendshme të mbrojtjes në grupin ProCredit. Këto nivele përfshijnë auditorët e jashtëm dhe autoritetet mbikëqyrëse bankare.

Elementet kyçe të menaxhimit të riskut

Niveli i pranueshëm i riskut përcakton kornizën për menaxhimin e riskut në Bankën ProCredit. Ky është një vendim i ndërgjegjshëm lidhur me nivelin deri në të cilin ne jemi të gatshëm të marrim risqe për të arritur objektivat strategjike. Niveli i pranueshëm i riskut përcaktohet për të gjitha risqet materiale dhe është i përfshirë në strategjinë e riskut. Ndërgjegjësimi ynë i fuqishëm për aspektet e qëndrueshmërisë (risqet MSQ) gjithashtu siguron informacion për këtë proces.

Në menaxhimin e risqeve, Banka ProCredit merr parasysh kërkesat rregullative vendore si dhe “Kërkesat Minimale për Menaxhimin e Riskut” (MaRisk), publikimet përkatëse nga autoritetet rregullative kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe njohuritë tona për tregun përkatës. Elementet kyçe të menaxhimit të riskut në Bankën ProCredit janë paraqitur më poshtë:

- Strategjia e riskut adreson të gjitha risqet materiale që burojnë nga zbatimi i strategjisë së biznesit dhe përcakton objektivat dhe masat për menaxhimin e riskut. Këto strategji miratohen çdo vit nga Bordi i Drejtorëve të bankës.

- Inventarizimi vjetor i risqeve siguron që të gjitha risqet materiale dhe jomateriale të identifikohen dhe, nëse është e nevojshme, të merren në konsideratë në strategjitë dhe proceset e menaxhimit të riskut.

- Të gjitha risqet e marra përsipër menaxhohen në mënyrë që të sigurohet një nivel i përshtatshëm i kapitalit, si në perspektivën normative edhe në atë ekonomike, si dhe nivelet e duhura të likuiditetit.

- Banka ProCredit respekton kornizën e përbashkët të menaxhimit të riskut të grupit, e cila përcakton standardet minimale në nivel grupi. Politikat dhe standardet e menaxhimit të riskut miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe përditësohen të paktën një herë në vit.

- Monitorimi dhe kontrolli i risqeve materiale dhe i koncentrimit të mundshëm të riskut realizohet përmes përdorimit të mjeteve gjithëpërfshirëse të analizës. Për të gjitha risqet materiale, përcaktohen treguesit e paralajmërimit të hershëm (pragjet e raportimit) dhe limitet, ndërsa përdorimi përkatës i tyre monitorohet. Efektiviteti i masave, limiteve dhe metodave të zgjedhura kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme.

- Testet e stresit kryhen rregullisht për risqet materiale; testet e stresit kryhen për çdo kategori të veçantë të riskut si dhe për të gjitha kategoritë e riskut.

- Raportimi i rregullt dhe ad hoc bëhet për profilin e riskut, duke përfshirë përshkrime dhe komente të detajuara.

- Janë krijuar procese dhe procedura të përshtatshme për një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Ky sistem bazohet në parimet e ndarjes së detyrave, kontrollit të dyfishtë dhe, për të gjitha operacionet relevante për riskun, të ndarjes së detyrave midis Zyrës për Shërbim të Klientëve dhe Zyrës Mbështetëse deri në nivelin menaxhues.

- Të gjitha produktet/shërbimet e reja ose ato që kanë pësuar ndryshime të ndjeshme, proceset e biznesit, instrumentet, sistemet e TI-së ose strukturat organizative i nënshtrohen një analize të hollësishme (procesi i miratimit të riskut të ri) përpara se të zbatohen ose të përdoren për herë të parë, në mënyrë që të identifikohen me kohë risqet e mundshme.

Menaxhimi i risqeve të veçanta

Llojet e riskut material për grupin ProCredit janë:

Lloji i riskut	Përkufizimi
Risku kreditor	Risku që pala në një transaksion nuk mund të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale, jo plotësisht ose jo me kohë. Brenda riskut të përgjithshëm të kredisë, ne bëjme dallim-in midis tri kategorive: risku kreditor i klientëve, risku ndaj palës tjetër (përfshirë riskun e emetuesit) dhe risku i vendit. Risku kreditor është risku më domethënës brenda kornizës sonë të menaxhimit të riskut, ku pjesën më të madhe e përbën risku kreditor i klientëve. Ne e kufizojmë riskun ndaj palës tjetër përmes strategjisë sonë të investimeve dhe politikave tona të menaxhimit të riskut, të cilat përcaktojnë procese të përzgjedhjes së kujdesshme, limitet e ekspozimit dhe transaksionet e lejuara.

Risku kreditor i klientëve

Menaxhimi i riskut kreditor synon të ruajë një cilësi të lartë të kredive dhe të parandalojë koncentrimin e tepruar të riskut. Ai siguron që risqet e mundshme të mospagesës të mbulohen nga rezervat për humbjet. Banka ProCredit shënjestron ndërmarrjet mikro, NVM-të dhe klientët privatë të shtresës së mesme. Parimet kyçe përfshijnë:

- Analizimin e borxhit dhe aftësisë paguese të kredimarrësve, duke përfshirë rrjedhat e ardhshme të parasë dhe aspektet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes;
- Dokumentimin e vlerësimit të riskut dhe procese të kredidhënies për transparencë;
- Shmangien e mbingarkimit me borxhe për klientët;
- Ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata përmes kontaktit dhe monitorimit të rregullt;
- Përcjelljen e pagesave të kredive dhe menaxhimin e kujdesshëm të tyre në rast të vështirësive potenciale në kthim
- Ekzekutimin e kolateralit në rast falimentimi.

Korniza e menaxhimit të riskut kreditor të grupit përcaktohet në politikat dhe standardet të cilat i përcaktojnë në hollësi përgjegjësitë, parimet e kredidhënies, monitorimin e kredive dhe vlerësimin e kolateralit. Proceset e ndryshme të vlerësimit të riskut kreditor zbatohen në varësi të kategorisë së klientit. Funksionet e Zyrës për Shërbim të Klientëve dhe Zyrës Mbështetëse janë të ndara për sa i përket operacioneve të rëndësishme për riskun. Vendimet për kredi bazohen kryesisht në analizën gjithëpërfshirëse të situatës financiare dhe aftësisë paguese të klientit. Kontakti i rregullt me klientët e biznesit, përfshirë vizitat në terren, adreson profilet e tyre specifike të riskut. Për klientët privatë, vlerësimet përqendrohen në të ardhurat dhe borxhin e përgjithshëm.

Vlerësimi i risqeve MSQ si pjesë e riskut kreditor

Ne i marrim parasysh risqet **MSQ**, të cilat janë ngjarje mjedisore, sociale ose të qeverisjes që mund të ndikojnë negativisht në pozicionin financiar, performancën ose reputacionin.

Risqet MSQ ndikojnë në mënyrë domethënëse edhe në llojet e tjera të riskut dhe në rëndësinë e tyre. Këto risqe ndikojnë kryesisht në riskun kreditor që lidhet me biznesin dhe riskun operacional të klientit.

Të gjithë klientët e biznesit kategorizohen në bazë të ndikimeve dhe risqeve mjedisore të aktiviteteve të tyre. Në varësi të këtyre faktorëve dhe vëllimit të kredisë, klientët i nënshtrohen një vlerësimi gjithëpërfshirës mjedisor dhe social, duke përfshirë qeverisjen dhe risqet e ndryshimeve klimatike.

Treguesit kyç të riskut (TKRR-të) matin dhe monitorojnë ndikimin e risqeve MSQ në riskun kreditor të klientëve në portfolion e kredive. Portfolio analizohet në lidhje me ndikimin e mundshëm të risqeve të tranzicionit dhe risqeve klimatike fizike, ku risku i tranzicionit vlerësohet përmes skenarëve makroekonomikë të disponueshëm, mekanizmave të çmimi të karbonit dhe aftësinë paguese të kredimarrësve. Këto rishikohen çdo tremujor me qëllim të identifikimit të hershëm të koncentrimit të riskut të rritur MSQ në portfolio.

Procesi i miratimit të ekspozimeve kreditor

Të gjitha vendimet për kredi merren nga një komitet për kredi, anëtarët e të cilit kanë limite të miratimit bazuar në ekspertizën e tyre. Ekspozimet kreditorë të mesme jepen ekskluzivisht nga komitetet në zyrat qendrore të Bankës. Ekspozimet kreditorë sigurohen kryesisht përmes hipotekave, ku vlerësimi i kolateralit bazohet në vlerësimet e ekspertëve të jashtëm. Treguesit e amortizimit kontrollohen çdo vit dhe vlerësimet e jashtme përditësohen në mënyrë rregullt, me kontrole të shtuara që kryhen nga stafi i specializuar i Bankës ProCredit. Sigurimi i kredive me hipoteka është me rëndësi thelbësore për kufizimin e riskut kreditor, ku sigurimi i kolateralit kryesisht është i përqendruar në pasuri të paluajtshme, por i diversifikuar nëpër rajone, vende dhe sektorë të ndryshëm.

Zbulimi i hershëm i riskut dhe monitorimi

Identifikimi i hershëm i rritjes së riskut kreditor është pjesë përbërëse në të gjitha proceset që lidhen me kredinë, duke mundësuar vlerësimin e menjëhershëm të vështirësive financiare të mundshme për klientët. Analizat e riskut si në nivel individual ashtu edhe në nivel të portfolios bazohen në të dhëna të përditësuara

financiare të klientëve dhe në zhvillimet e tregut. Treguesit e paralajmërimit të hershëm, që marrin parasysh veçoritë sasiore dhe cilësore të riskut, regjistrohen dhe monitorohen në nivel të portfolios. Këta tregues ndihmojnë në kufizimin e ekspozimeve ndaj grupeve të caktuara të klientëve dhe mbështesin menaxhimin e portfolios së kredive, identifikimin e hershëm të mospagesave të mundshme dhe vendosjen e kundërmasave. Raportet për portfoliot e prekura i ofrohen rregullisht menaxhmentit të degëve, zyrës qendrore dhe PCH-së në Frankfurt.

Ngjarje të rëndësishme për riskun kreditor

Ne e kemi monitoruar me kujdes portfolion tonë të kredive lidhur me risqet domethënëse gjatë gjithë vitit 2024. Menaxhimi i riskut kreditor këtë vit është udhëhequr nga zhvillimet makroekonomike. Strategjitë kryesore kanë përfshirë zgjerimin e njohurive rreth tregut, përzgjedhjen e klientëve, analizën e politikave dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë. Pavarësisht rritjes së çmimeve në treg dhe inflacionit, Banka ProCredit ka ruajtur një portfolio të qëndrueshme dhe ka arritur të ketë rritje, duke e mbështetur zhvillimin e klientëve dhe ekonominë e gjerë. Komunikimi i vazhdueshëm me klientët na ka lejuar që të adresojmë vështirësitë financiare dhe të ofrojmë zgjidhje.

Zhvillimet kryesore të riskut kreditor gjatë vitit 2024:

Zhvillimet kryesore	Detajet
Cilësia e portfolios së kredive	Është përmirësuar, kreditë joperformuese në nivelin 1.2%
Rezervat për humbje nga kreditë	Mbulimi i portfolios së kredive joperformuese në nivelin 144%
Komitetet	Kanë diskutuar zhvillimet e riskut kreditor, respektimin e limiteve dhe aktivitetet
Monitorimi	Monitorim i afërt i faktorëve të risku si normat e interesit, furnizimi me energji, çmimet e pasurive të paluajtshme
Provizionimi për humbjet nga kreditë	Është përditësuar duke u bazuar në të dhënat makroekonomike dhe trendet historike
Kapacitetet e stafit	Janë forcuar përmes trajnimeve dhe punëtorive për riskun kreditor

Risku kreditor do të vazhdojë të mbetet prioritet edhe në vitin 2025, si në nivel të portfolios ashtu edhe në nivel individual. Banka do të vazhdojë të mbështesë kërkesat për financim gjatë zhvillimit të aktiviteteve biznesore të klientëve tanë, madje edhe gjatë sfidave të mundshme në të ardhmen.

Lloji i riskut	Përkufizimi dhe masat zbutëse
Risqet e tregut	Risqet e tregut përfshijnë riskun e humbjeve të mundshme nga lëvizjet e çmimeve në treg, si kursi i këmbimit valutor, normat e interesit të tregut ose parametra të tjerë që mund të ndikojnë negativisht në të ardhurat dhe vlerën e Bankës. Masat kryesore të zbutjes së riskut: • Sigurimi që ricaktimi i çmimit për zërat e ndjeshëm ndaj normave të interesit në bilancin e gjendjes të jetë i baraspeshuar në të gjitha maturitetet. Për këtë qëllim, lloji i normës së interesit të kredive të disbursuara përputhet me atë të fondeve të kontraktuara. Për më tepër, pjesa kryesore dhe e qëndrueshme e depozitave pa maturitet përdoret për të zvogëluar këto hendeqe. • Këmbimet e normës së interesit mund të përdoren për të mbrojtur riskun e normës së interesit që buron kryesisht nga kreditë afatgjata investuese me norma fikse të interesit (p.sh. projektet e energjisë së ripërtërishme). • Vlerësimi i ndikimit të transaksioneve të reja/të mëdha në riskun e normës së interesit përpara se ato të finalizohen dhe shmangia e koncentrimi materiale. • Monitorimi i strukturës së normës së interesit dhe pajtueshmërisë si në nivel individual, ashtu edhe në nivel grupi, si dhe realizimi i testeve të stresit në mënyrë të rregullt duke simuluar skenarë të ndryshëm të normave të interesit. • Raportimi i rregullt për zhvillimin e riskut të tregut dhe limitet e riskut në komitetet e brendshme të caktuara dhe në komitetet në nivel bordi. • Rishikim i rregullt i politikave dhe procedurave dhe trajnimi dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm për stafin e specializuar. • Rishikimi dhe validimi i rregullt i modeleve të përdorura për matjen e riskut të normës së interesit.
Risku i likuiditetit dhe financimit	Risku i likuiditetit dhe financimit adreson aftësinë afatshkurtër dhe afatgjatë të bankës për të përmbushur detyrimet financiare të saj në mënyrë të plotë dhe me kohë, madje edhe në situata stresi.

Lloji i riskut	Përkufizimi dhe masat zbutëse
Risku i likuiditetit dhe financiar	Masat kryesore të zbutjes së riskut: • Fokusimi në depozitat nga klientët privatë dhe NVM-të, duke krijuar marrëdhënie të forta me klientë dhe duke rritur llogaritë pa afatizim për financim stabil; • Disbursimi i kredive për biznese të vogla dhe të mesme në formën e kredive me këste për të pasur rrjedhë të rregullt mujore të parasë dhe investimi në asete me likuiditet të lartë në instrumente të besueshme të disponueshme për likuidim të menjëhershëm. • Zbatimi i praktikave të kujdesshme për menaxhimin e riskut të likuiditetit, mbajtja e nivelit të mjaftueshëm të aseteve likuide, monitorimi dhe raportimi i rregullt i treguesve kyç të riskut të likuiditetit. • Shfrytëzimi i raporteve të riskut të likuiditetit për analizën e hendekut nën supozimet kontraktuale dhe të stresit, monitorimi i ndryshimeve rregullative, analiza e zhvillimeve të biznesit dhe optimizimi i aktiviteteve të financimit duke i respektuar politikat. • Monitorimi i rregullt i treguesve të riskut të likuiditetit dhe raportimi në komitetet përkatëse të brendshme dhe në nivel të bordit. • Testet gjithëpërfshirëse të stresit kryhen në mënyrë të rregullt, duke simuluar skenarë të ndryshëm të zhvillimit të likuiditetit dhe ndikimin e tyre në treguesit e riskut. • Rishikimi i rregullt dhe përditësimi i politikave dhe procedurave për menaxhimin e riskut të likuiditetit dhe financimit, si dhe trajnimi dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm për stafin e specializuar.
Risku operacional	Ne e përkufizojmë riskun operacional si riskun e humbjes që vjen nga proceset e brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, nga njerëzit ose nga sistemet (p.sh. dështimi i sistemeve të përpunimit të të dhënave, përvetësimi, gabimi njerëzor, proceset e gabuara, dobësitë strukturore, monitorimi i pamjaftueshëm) ose nga ngjarjet e jashtme (p.sh. aktivitete kriminale, fatkeqësitë natyrore). Ky përkufizim merr parasysh gjithashtu riskun e mashtrimit, riskun e TI-së, riskun ligjor, riskun e reputacionit dhe riskun e nën-kontraktimit. Menaxhimi i riskut operacional synon të identifikojë, analizojë dhe vlerësojë të gjitha risqet materiale në fazë të hershme dhe të shmangë përsëritjen e tyre.

Lloji i riskut	Përkufizimi dhe masat zbutëse
	Masat e zbutjes së riskut: • Baza e të dhënave të ngjarjeve të riskut përdoret për të regjistruar, analizuar dhe komunikuar ngjarjet e riskut operacionale, duke siguruar zbatimin e masave korrigjuese dhe parandaluese. • Kryerja e vlerësimeve vjetore të riskut për të identifikuar dhe vlerësuar në mënyrë sistematike risqet kryesore, për të vlerësuar përshtatshmërinë e proceseve të kontrollit dhe për të përcaktuar masat zbutëse. • Analiza e rregullt e treguesve të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar në mënyrë proaktive fushat me risk të rritur të mashtrimit, dhe zbatimi i masave parandaluese me kohë për të zbutur kërcënimet e mundshme. • Kryerja e vlerësimeve të hollësishme të riskut për të gjitha produktet, aktivitetet dhe nismat e reja të nën-kontraktimit, për të identifikuar dhe menaxhuar risqet e mundshme operationale përpara zbatimit. • Programet e trajnimeve të rregullta të stafit, në të gjithë organizatën, për ndërgjegjësimin lidhur me riskun. • Mbikëqyrja e rreptë dhe vlerësimi i shërbimeve të palëve të treta sigurojnë kontrolle të fuqishme dhe zbutje të menjëhershme të riskut. • Përpjekjet për të nxitur një kulturë të fuqishme të ndërgjegjësimit për riskun, duke inkurajuar praktika proaktive të menaxhimit të riskut në të gjitha nivelet
Risqet kibernetike	Risqet kibernetike paraqesin potencialin për dëmtim të sistemeve, të dhënave dhe reputacionit të Bankës nga kërcënimet digjitale të sofistikuara, duke përfshirë sulmet kibernetike, rrjedhjet e të dhënave dhe aktivitetet e tjera dashakeqe. Masat kryesore të zbutjes së riskut: • Vlerësimet e vazhdueshme të riskut, skanimet e cënueshmërisë dhe testet e depërtimit për të identifikuar dhe adresuar dobësitë e mundshme në sistemet tona. • Zbatimi i teknologjive të avancuara për zbulimin e kërcënimeve për të identifikuar dhe zbutur risqet kibernetike në kohë reale.

Lloji i riskut	Përkufizimi dhe masat zbutëse
Risqet kibernetike	• Forcimi i protokolleve tona të reagimit ndaj incidenteve, duke siguruar reagim të shpejtë ndaj incidenteve të sigurisë dhe duke minimizuar dëmet e mundshme. • Rritja e shpeshtësisë dhe thellësisë së trajnimeve të punonjësve për sigurinë kibernetike, për të siguruar që i gjithë stafi të jetë në gjendje të identifikojë dhe të reagojë në mënyrë efektive ndaj kërcënimeve kibernetike. • Të gjithë ofruesit e shërbimeve kritike i nënshtrohen vlerësimeve të hollësishme të sigurisë përpara se të angazhohen, për të siguruar se i përmbushin standardet e larta të sigurisë së bankës. • Rishikimi dhe përditësimi i rregullt i politikave dhe procedurave të sigurisë kibernetike, për t'u siguruar që ato mbeten në përputhje me kërcënimet evoluese të sigurisë dhe me kërkesat rregullative.
Risqet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe veprat tjera të dënueshme me ligj.	Këto risqe i referohen mundësisë që institucionet financiare të shfrytëzohen për aktivitete të paligjshme, si dhe riskut të sanksioneve ligjore dhe rregullative, humbjeve financiare ose dëmtimit të reputacionit. Masat kryesore të zbutjes së riskut: • Zbatimi dhe forcimi i politikave gjithëpërfshirëse për parandalimin e pastrimit të parave, duke siguruar trajnim të gjerë të punonjësve në të gjithë organizatën. • Përdorimi i sistemeve të avancuara për të zbuluar dhe raportuar transaksionet e dyshimta në kohë reale. • Përditësimi i rregullt me rregulloret për PPP dhe siguri i pajtueshmërisë me kërkesat ligjore. • Verifikimi i identitetit të klientëve dhe monitorimi i aktiviteteve të tyre financiare. • Kryerja sistematike e vlerësimit të riskut për identifikimin dhe vlerësimin e dobësive të mundshme lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe pajtueshmërinë me sanksionet.

Lloji i riskut	Përkufizimi dhe masat zbutëse
Risku i biznesit	Risku i biznesit është risku i uljes së fitimit si pasojë e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Këta faktorë përfshijnë përkeqësimin e kushteve ekonomike, ndërhyrjet rregullative të papritura dhe vendimet e pafavorshme biznesore. Masa kryesore e zbutjes së riskut: Grupi ProCredit ka një proces të strukturuar për planifikimin, zbatimin, vlerësimin dhe përshtatjen e strategjisë së biznesit dhe strategjisë së riskut. Përveç kësaj, ekziston një bashkëveprim i ngushtë dhe i rregullt ndërmjet Bordit Menaxhues të ProCredit Holding dhe ekipit menaxhues në banka. Një faktor tjetër që e zbut riskun është ofruesi i brendshëm i shërbimeve të TI-së së grupit, QUIPU, i cili ofron zgjidhje softuerike të standardizuara për grupin. Gjithashtu, programet tona të trajnimit të brendshëm ndihmojnë në sigurimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të nivelit të lartë të ekspertizës së menaxherëve dhe punonjësve tanë.
Risku i modelit	Risku i modelit i referohet riskut që baza e gabuar për vendimmarrje të mund të përdoret për shkak të gabimeve në modelim ose përdorimit jo të duhur të modeleve, gjë që mund të rezultojë në marrje të padëshiruar të risqeve më të mëdha. Masat kryesore të zbutjes së riskut: Parimet bazë të menaxhimit të riskut të modelit janë identifikimi dhe shmangia e risqeve të modelit dhe marrja në konsideratë e risqeve të njohura të modelit. Risqet e modelit që nuk janë të njohura dhe që, rrjedhimisht, nuk mund të zbuten, pranohen si risk i brendshëm i modelit të biznesit.

Menaxhimi i kapitalit

Menaxhimi i kapitalit udhëhiqet nga parimi se Banka ProCredit nuk merr përsipër risqe më të mëdha nga sa është në gjendje t'i përballojë. Në këtë kontekst, objektivat tona janë të sigurojmë pajtueshmëri me kërkesat rregullative dhe ato të përcaktuara brenda bankës për kapitalin, nga një perspektivë normative dhe ekonomike, duke ruajtur kapitalizimin e duhur për të krijuar një mbrojtje të mjaftueshme të kapitalit. Kjo qasje jo vetëm që garanton aftësinë e Bankës për të vepruar, por gjithashtu mbështet planet tona për rritje të qëndrueshme.

Parimi i mjaftueshmërisë së kapitalit monitorohet duke përdorur tregues të ndryshëm, për të cilët janë vendosur treguesit e paralajmërimit të hershëm dhe limitet. Ne i monitorojmë rregullisht, kryejmë teste stresi dhe analiza të skenarëve për të siguruar që banka është gjithmonë e kapitalizuar mirë. Gjatë vitit 2024, ne gjithmonë kemi qëndruar brenda limiteve të përcaktuar të kërkesave të brendshme dhe rregullative për kapitalin. Lidhur me kapitalizimin në perspektivën ekonomike, sigurimi i kapitalit të mjaftueshëm në këtë aspekt është element kyç i menaxhimit të riskut dhe proceseve të menaxhimit të kapitalit në ProCredit.

Menaxhimi i riskut të pajtueshmërisë dhe mbrojtja e të dhënave

Ne në Bankën ProCredit jemi të përkushtuar për të nxitur një kulturë të fuqishme të pajtueshmërisë dhe menaxhimit efektiv të riskut të pajtueshmërisë, në mënyrë që të mbrojmë aksionarët, klientët, biznesin dhe punonjësit tanë. Fokus kryesor i strategjisë sonë të biznesit është rruga e digjitalizimit, të cilën e zbatojmë me theks të madh në menaxhimin e riskut. Korniza jonë e menaxhimit të riskut e mbështet këtë qasje duke nxitur monitorim të vazhdueshëm të riskut të pajtueshmërisë, rritjen e ndërgjegjësimit për riskun e pajtueshmërisë dhe promovimin e një vendimmarrjeje të qëndrueshme operacionale dhe strategjike. Kjo mundëson një metodologji të qëndrueshme për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe raportimin e risqeve të pajtueshmërisë që ne marrim në aktivitetet tona, duke siguruar llogaridhënie të qartë. Të gjithë punonjësit janë përgjegjës për identifikimin dhe menaxhimin e riskut të pajtueshmërisë brenda detyrave të tyre, ndërsa përgjegjësia përfundimtare i takon Bordit të Drejtorëve. Përmes këtij përkushtimi, ne synojmë të ruajmë standardet më të larta të pajtueshmërisë, transparencës dhe qeverisjes korporative. Risku i pajtueshmërisë rregullative është risku i sanksioneve ligjore dhe rregullative, humbjeve financiare ose dëmtimit të

reputacionit që rezulton nga mospajtueshmëria me ligjet e zbatueshme, rregulloret, standardet e industrisë dhe rregullat e brendshme. Ne jemi të përkushtuar të qëndrojmë përpara peizazhit evolues të pajtueshmërisë rregullative, i cili aktualisht përfshin por nuk kufizohet vetëm në: çështjet MSQ, qëndrueshmërinë operacionale, përparimet digjitale dhe teknologjike, menaxhimin e ankesave të klientëve dhe raportimet rregullative. Korniza jonë e pajtueshmërisë udhëhiqet nga parime kyçe që sigurojnë: 1. respektimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të normave etike; 2. një mjedis të fortë dhe efektiv të kontrollit të brendshëm për të zbutur risqet e pajtueshmërisë, në bazë të informacionit nga vlerësimet e riskut të kontrollit të pajtueshmërisë, harmonizimit me strategjinë, vlerat dhe nevojat e klientëve tanë; dhe 3. disponueshmërinë e stafit të kualifikuar me ekspertizën e nevojshme për të menaxhuar me efektivitet risqet e pajtueshmërisë. Për të ruajtur pajtueshmërinë rregullative dhe për të mbështetur praktikën më të mira në industri, ne:

- I monitorojmë dhe zbatojmë zhvillimet rregullative me kohë dhe në mënyrë efektive;
- Angazhohemi në mënyrë aktive për komunikim me rregullatorët dhe politikëbërësit, duke rezultuar në korniza rregullative pragmatike;
- Përdorim një proces për risqet primare dhe ato në zhvillim e sipër me një qasje që sheh drejt së ardhmes, me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të kërcënimeve të mundshme që mund të ndikojnë në objektivat tona strategjike në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Qeverisja dhe struktura

Departamenti i Pajtueshmërisë është përgjegjës për kornizën e menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë. Si pjesë e linjës së dytë të mbrojtjes, ai operon i pavarur nga funksionet e biznesit dhe ato operationale, duke ofruar mbikëqyrje objektive. Kjo strukturë qeverisëse siguron llogaridhënie, transparencë dhe një qasje proaktive në menaxhimin e risqeve të pajtueshmërisë në të gjithë organizatën. Zytari Kryesor i Pajtueshmërisë (ZKP) i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve dhe siguron informata të rregullta për Bordin Menaxhues dhe Zytarin e Pajtueshmërisë në nivel Grupi. ZKP merr pjesë në mënyrë aktive në mbledhjet kryesore të komiteteve, për të siguruar mbikëqyrje strategjike për çështjet e pajtueshmërisë. Për më tepër, Departamenti i Pajtueshmërisë bashkëpunon ngushtë me funksionet e tjera të kontrollit dhe palët kyçe të interesit, për të nxitur një kulturë të sjelljes etike, për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe për të mbështetur organizatën në menaxhimin e risqeve të pajtueshmërisë rregullative. të cilat janë në vlerësim të vazhdueshëm përfshijnë mbrojtjen e klientit, mbrojtjen e të dhënave, riskun kreditor, riskun financiar dhe operacional si dhe risqet e TI-së. Një fushë e rëndësishme e fokusit brenda strategjisë sonë të pajtueshmërisë është risku MSQ. Ne i integrojmë konsideratat për MSQ brenda kornizës sonë të përgjithshme të menaxhimit

Risku	Buron nga	Menaxhimi i risqeve kryesore
Risku i pajtueshmërisë rregullative është risku i sanksioneve ligjore dhe rregullative, humbjeve financiare apo dëmtimit të reputacionit.	Risku i pajtueshmërisë rregullative buron nga mospajtueshmëria me ligjet në fuqi, rregulloret, standardet e industrisë dhe rregullat e brendshme, gjë që mund të çojë në gjoba, ndëshkime dhe dëmtim të reputacionit për integritetin e biznesit tonë.	Matet kundrejt nivelit të pranueshëm për risk, matësve kryesore, komenteve të rregullatorit dhe gjykimit të ekspertëve nga ekipi i pajtueshmërisë. Monitorohet përmes vlerësimeve të riskut nga linja e parë, testimi dhe sigurimi nga linja e dytë, auditimeve të brendshme dhe të jashtme, dhe inspektimeve rregullative. Menaxhohet përmes politikave, procedurave, trajnimit të punonjësve dhe monitorimit të vazhdueshëm, me kontrole proaktive të riskut dhe masa korrigjuese.

të riskut të pajtueshmërisë rregullative, për të siguruar kontrole të fuqishme dhe përputhje me pritjet rregullative që janë në zhvillim.

Mbrojtja e të dhënave

Ne jemi të përkushtuar për mbrojtjen e dhënave që i përpunojmë, duke vepruar në pajtueshmëri të plotë me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe ligjet dhe rregulloret e tjera të zbatueshme. Qasja jonë ndaj mbrojtjes së të dhënave bazohet në qeverisje të fuqishme, teknologji të avancuar, kontrole të fuqishme dhe politika gjithëpërfshirëse për të menaxhuar në mënyrë efektive risqet lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Politika jonë për mbrojtjen e të dhënave dhe njoftimi për privatësinë ofrojnë një kornizë të qëndrueshme që zbatohet në të gjitha njësitë dhe funksionet e biznesit. Ne jemi të përkushtuar për transparencë në mënyrën si i mbledhim, i përdorim dhe i menaxhojmë të dhënat personale, duke siguruar që klientët të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre. Njoftimi i privatësisë gjendet në këtë link. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMDH) i raporton rregullisht menaxhmentit të lartë dhe Bordit të Drejtorëve, duke siguruar një mbikëqyrje të fortë ekzekutive. Meqë mjedisi i mbrojtjes së të dhënave vazhdon të evoluojë në nivel global, ne monitorojmë në mënyrë proaktive: peizazhin rregullativ për të përshtatur politikën dhe praktikën tona; kryejmë rishikime dhe vlerësime të risqeve në mënyrë të rregullt dhe i japim prioritet trajnimit dhe

ndërgjegjësimin, për t'u siguruar që punonjësit tanë t'i kuptojnë dhe zbatojnë standardet e mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave. Ne i mbrojmë të dhënat e klientëve përmes kornizës sonë të mbrojtjes së të dhënave, e cila i përcakton praktikën, parimet e dizajnit dhe udhëzimet që sigurojnë pajtueshmërinë duke parandaluar, zbuluar dhe zbutur risqet si dhe duke siguruar zgjidhje të shpejtë të çdo çështjeje të identifikuar.

Zhvillimet kryesore në pajtueshmëri gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, ne e kemi forcuar edhe më tej kornizën tonë të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë, duke identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe zbutur në mënyrë proaktive risqet rregullative dhe ato për mbrojtjen e të dhënave. Qasja jonë është fokusuar në thjeshtësimin dhe përmirësimin e menaxhimit të riskut përmes mjeteve dhe teknikave më efektive të mbikëqyrjes, duke e përmirësuar menaxhimin e riskut të pajtueshmërisë në të gjithë ciklin. Nismat kryesore përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

- Rishikimin dhe përditësimin e politikave dhe procedurave tona, për të siguruar që ato mbeten aktuale dhe adresojnë risqet në evolucionin të pajtueshmërisë rregullative;

- Përditësimin e kornizës së kontrollit të brendshëm, duke krijuar një qasje të centralizuar dhe të qëndrueshme për mbikëqyrjen e risqeve të pajtueshmërisë rregullative dhe mbrojtjes së të dhënave;
- Përmirësimin e kapaciteteve dhe ekspertizës së ekipit të Pajtueshmërisë, për të siguruar njohuri teknike rreth mbikëqyrjes së risqeve në zhvillim dhe pajtueshmërisë me kornizat e reja rregullative;
- Fuqizimin e proceseve tona të raportimit në nivel grupi, duke i bërë ato më efikase dhe gjithëpërfshirëse;
- Kujdesin e duhur i shtuar dhe monitorimi i shërbimeve të palëve të treta kyçe, duke e përmirësuar mbikëqyrjen e risqeve në zinxhirin e furnizimit dhe qëndrueshmërinë operacionale;
- Integrimin e vazhdueshëm të një qasjeje që sheh drejt së ardhmes lidhur me risqet e pajtueshmërisë rregullative dhe mbrojtjes së të dhënave, me fokus të madh te teknologjia dhe kontrollet e sigurisë kibernetike;
- Ofrimin e trajnimeve të përshtatura lidhur me risqet e reja të pajtueshmërisë dhe risqet e mbrojtjes së të dhënave.

Këto zhvillime pasqyrojnë përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të pasur pajtueshmëri të plotë, mbrojtje të të dhënave dhe qëndrueshmëri operacionale, duke siguruar që ne vazhdojmë t'i përmbushim detyrimet tona rregullative dhe njëkohësisht të mbrojmë biznesin dhe klientët tanë.

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyra Financiare



**RAPORTI
VJETOR
2024**

Pasqyrat Financiare



**2024
RAPORTI
VJETOR**

PROCREDIT BANK SH.A. KOSOVA

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	66
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	67
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	68
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	69
SHËNIME NË PASQYRAT FINANCIARE	71

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të ProCredit Bank Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ProCredit Bank Sh.a. ("Banka"), që përfshijnë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2024, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmblendje të informacioneve mbi politikat kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Bankës paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2024, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e saj të parasë për vitin që ka përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës për Kontabilistët (Kodi IESBA), si dhe me kërkesat etike përkatëse për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Ky informacioni përfshin të dhënat e përfshira në Raportin Vjetor të Bankës, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-093. Raporti Vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk përfshin informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë përfundimi sigurie lidhur me të. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër kur të na vihet në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse informacioni tjetër është në mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose me njohuritë e marra gjatë auditimit, apo nëse ndryshe duket se përmban anomali materiale. Kur lexojmë Raportin Vjetor të Bankës, nëse konkludojmë se përmban anomali materiale, na kërkohet ta komunikojmë këtë çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të ngarkuarve me qeverisje për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, si dhe për kontrollin e brendshëm që e vlerëson si të nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar si një ndërmarrje në vijimësi, duke shpalosur, siç është e zbatueshme, çështjet në lidhje me shqetësimin e vazhdueshmërisë së bankës dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë, përveç nëse menaxhmenti synon të likuadojë Bankën, të pushojë aktivitetin ose nuk ka ndonjë alternativë realiste tjetër përveç ta bëjë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk përmban garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomalitë materiale kur ato ekzistojnë.

Anomalitë mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit që u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë dëshmi të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku për të mos zbuluar një anomalitë materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa ai që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Marrim njohuri për kontrollet e brendshme lidhur me auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi vijimësinë nga menaxhmentit dhe, bazuar në dëshmitë e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushteve që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që Banka të mos vazhdojë aktivitetin në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, shtrirjen dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Amir Dërmata
Engagement Partner
BDO Kosova L.L.C.
April 15, 2025
Str. Ukshin Hot, C 4/3, Ent. A, Floor II
Pristina, Kosovo

BDO
BDO Kosova L.L.C.
audit, accounting and financial advisory
Pristina, Kosovo

PROCREDIT BANK SH.A.**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024**

Në mijë EUR

	Shënim	2024	2023
Të ardhurat nga interesi	7	52,210	42,175
Shpenzimet e interesit	7	(7,222)	(4,935)
Të ardhurat neto nga interesi		44,988	37,240
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	8	14,983	14,633
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	8	(8,013)	(7,285)
Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet		6,970	7,348
Rezultati nga transaksionet e këmbimit valutor	9	1,674	1,488
Rezultati tjetër operativ neto	10	(1,354)	(1,987)
Të hyrat operative		52,278	44,089
Shpenzimet e personelit	11	(7,641)	(6,830)
Shpenzimet administrative	12	(19,338)	(14,981)
Lejimi për humbjet nga kreditë	13	6,509	2,532
Fitimi para tatimit		31,808	24,810
Tatimi në fitim	14	(2,726)	(2,496)
Fitimi i vitit		29,082	22,314
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
<i>Zërat që më pas mund të ri-klasifikohen në fitim ose humbje:</i>			
Fitimi/(humbja) nga vlera e drejtë në investimet e instrumenteve e borxhit të matura në VDATGJ, neto nga tatimi	14	343	69
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		29,425	22,383

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 71 deri 145.

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Në mijë EUR

	Shënim	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pasuritë			
Paraja dhe gjendja me Bankat Qendrore	15	168,712	192,752
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	16	55,998	23,288
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	17	866,514	729,774
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	18	140,767	124,418
Pasuritë e paprekshme	19	73	52
Prona, impiantet dhe pajisjet	20	18,488	17,057
Pasuritë e tatimit të shtyrë	14	111	166
Pasuritë e tjera	21	7,381	5,790
Gjithsej pasuritë		1,258,044	1,093,297
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	22	381	1,066
Detyrimet ndaj klientëve	23	1,079,998	936,060
Detyrimet tjera	24	10,386	10,686
Tatimi aktual i pagueshëm		291	452
Huamarrjet	25	22,628	19,151
Borxhi i varur	25	11,591	7,538
Gjithsej detyrimet		1,125,275	974,953
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	26	61,346	61,346
Premia në aksione	26	4,204	4,204
Rezerva kontingjente	26	511	511
Rezerva e ri-vlerësimit për investimet në letrat - VDATGJ	26	210	(133)
Fitimet e mbajtura		66,498	52,416
Gjithsej ekuiteti		132,769	118,344
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		1,258,044	1,093,297

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Menaxhues dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 15 prill 2025 nga:

Visar Paçarada
Kryeshef Ekzekutiv

Bejtë Cakaj
Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv

Esad Haxhani
Zyrtar Kryesor Financiar

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 71 deri 145.

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Në mijë EUR

	Kapitali aksionar	Premia në aksione	Rezerva kontingjente	Fitimet e mbajtura	Rezerva e vlerës së drejtë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2023	61,346	4,204	511	30,102	(202)	95,961
Fitimi për vitin	-	-	-	22,314	-	22,314
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	69	69
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	22,314	69	22,383
Dividenda e shpërndarë	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	61,346	4,204	511	52,416	(133)	118,344
Fitimi për vitin	-	-	-	29,082	-	29,082
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	343	343
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	29,082	343	29,425
Dividenda e shpërndarë	-	-	-	(15,000)	-	(15,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	61,346	4,204	511	66,498	210	132,769

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Në mijë EUR

	Shënim	2024	2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		31,808	24,809
Rregullimet për:			
Zhvlerësim	20	2,619	2,083
Amortizim	19	31	21
Fitimi nga shlyerja e pronës dhe pajisjeve		(62)	(37)
Lejimi për humbjet nga kreditë	13	(6,509)	(2,532)
Të ardhurat nga interesi	7	(52,210)	(42,175)
Shpenzimet e interesit	7	7,222	4,935
Paraja e përdorur në aktivitetet operative përpara ndryshimeve në pasuritë operative		(17,101)	(12,896)
Neto (rritja)/zvogëlimi në:			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat		(810)	1,531
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(130,733)	(71,455)
Pasuritë tjera		(2,271)	(2,703)
Gjendja me Bankën Qendrore		(11,202)	(362)
Neto (zvogëlim)/rritja në:			
Detyrimet ndaj bankave		(684)	435
Detyrimet ndaj klientëve		143,939	40,279
Detyrimet tjera		563	1,464
Paraja e (përdorur)/gjeneruar në aktivitetet operative		(18,299)	(43,708)
Interesi i arkëtuar		52,866	40,807
Interesi i paguar		(7,244)	(4,913)
Tatimi në të ardhura i paguar		(2,853)	(1,586)
Paraja neto e (përdorur)/gjeneruar në aktivitetet operative		24,470	(9,400)

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Në mijë EUR

	Shënim	2024	2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e investimeve në letrat me vlerë përmes VDATGJ		(126,930)	(83,543)
Të ardhurat nga shitja/maturimi i investimeve të letrave me vlerë VDATGJ		109,832	24,234
Blerja e pronës dhe pajisjeve		113	(3,273)
Të ardhurat nga shlyerja e pronës dhe pajisjeve		(3,300)	381
Blerja e pasurive të paprekshme		(51)	(35)
Paraja neto e (përdorur)/gjeneruar në aktivitetet investuese		(20,336)	(62,236)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Arkëtimet nga huazimet afatgjata		7,524	(3,738)
Dividenda e paguar	26	(15,000)	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		(7,476)	(3,738)
Ndryshimi neto (zvogëlim)/rritje në para dhe ekuivalentët e parasë		(3,342)	(75,374)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		160,945	236,319
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		157,603	160,945

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

1. Hyrje

ProCredit Bank sh.a. Kosova ("Banka") është themeluar në Republikën e Kosovës më 9 dhjetor 1999 si shoqëri aksionare. Banka filloi veprimtarinë e saj më 12 janar 2000. Banka është anëtare e Grupit ProCredit dhe është në pronësi të plotë të ProCredit Holding AG Frankfurt, Gjermani, e cila shërben si kompania mëmë përfundimtare e grupit.

Aktiviteti kryesor

Banka është licencuar për të vepruar si bankë në të gjitha aktivitetet bankare në Kosovë sipas rregullave të Bankës Qendrore të Kosovës (ish-Autoritetit Bankar Qendror të Kosovës) ("BQK") dhe aktualisht është subjekt i ligjit "Për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo Bankare", Nr. 04/L-093. Gjithashtu, ProCredit Bank ishte banka e parë e licencuar në Kosovë. ProCredit Bank Sh.a. është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit e cila ofron shërbime ndaj klientit për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) dhe për individët privatë. Në operacionet e saj, i përmbahet një numër parimesh kryesore: vlerëson transparencën në komunikimin e saj me klientët; kërkon të minimizojë gjurmët ekologjike; dhe ofron shërbime të cilat janë të bazuara në kuptueshmërinë e situatës së secilit klient si dhe analizës financiare të shëndoshë.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit

Adresa e regjistruar e Bankës është Rr. "Xhorxh Bush", Nr. 26, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Gjatë vitit 2024, përveç ofrimit të shërbimeve online përmes platformës e-Banking dhe shërbimeve në faqen e internetit, Banka ka operuar me degë, qendra shërbimi dhe zonat 24/7 (vetë-shërbim), për t'i ofruar klientëve shërbime gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të arritshme.

Bordi i Drejtorëve:

- Znj. Eriola Bibolli, Kryetare
- Z. Christian Edgardo Dagrosa, Anëtar
- Z. Rainer Ottenstein, Anëtar
- Z. Jordan Damchevski, Anëtar
- Znj. Semra Citaku, Anëtare

2. Infomata mbi politikat kontabël materiale (a) Baza e përgatitjes

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), sipas konventës së kostos historike, të modifikuar sipas rivlerësimit të letrave me vlerë të borxhit të matura sipas Vlerës së Drejtë të të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (VDATGJ). Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vazhdimësisë së veprimtarisë. Politikat kryesore kontabilitetit të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur në vijim.

Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është treguar ndryshe.

Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Raportimi financiar dhe rezultatet financiare të Bankës ndikohen nga supozimet, vlerësimet, dhe gjykimet e menaxhmentit, të cilat janë thelbësore në përgatitjen e pasqyrave financiare. Këto vlerësime dhe supozime përfaqësojnë vlerësimet më të mira të mundshme, të kryera në përputhje me standardet përkatëse. Ato rishikohen në mënyrë të vazhdueshme bazuar në përvojën, informacionin e disponueshëm dhe pritjet për ngjarjet e ardhshme, duke siguruar rëndësinë e tyre për rrethana përkatëse. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive. Detajet mbi fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kyçe në zbatimin e politikave kontabël që ndikojnë në mënyrë materiale shumën e raportuar në pasqyrat financiare jepen në shënimet shoqëruese 4, 5 dhe 6.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

Monedha funksionale dhe prezantimi

Pasqyra financiare janë paraqitur në EUR, që është monedha funksionale e Bankës dhe monedha primare e mjedisit të saj ekonomik. Të gjitha shumat janë të rrumbullaksuar në mijëra më të afërta, përveç kur specifikohet ndryshe.

(b) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Metoda e normës efektive të interesit (NEI) për të hyra dhe shpenzime nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI). Norma efektive e interesit është norma që zbret saktësisht pagesat ose të ardhurat e pritura të fluksit të pasqyrës gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar në vlerën kontabël bruto të mbartur (për pasuritë financiare) ose në koston e amortizuar (për detyrimet financiare).

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit (NEI) për instrumentet financiare, përveç atyre të blera ose të krijuara me dëmtim kredie që në origjinë, Banka vlerëson fluksin e ardhshme monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit, por pa përfshirë Humbjet e Pritshme nga Kredia (HPK).

Megjithatë, për asetet e blera ose të krijuara me dëmtim kredie që në origjinë, përdoret norma efektive e interesit, e cila përfshin fluksin e ardhshme monetare të pritshme, duke përfshirë edhe Humbjet e Pritshme nga Kredia (HPK). Llogaritja e normës efektive të interesit gjithashtu përfshin kostot e transaksionit, tarifat dhe komisionet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aseti apo detyrimi financiar. Kostot e transaksionit i referohen kostove shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt si pjesë e krijimit të instrumentit financiar.

Rishikimi i Normës Efektive të Interesit

Norma efektive e interesit përcaktohet në momentin e njohjes fillestare të një aseti apo detyrimi financiar dhe zakonisht aplikohet në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë jetëgjatësisë së instrumentit. Megjithatë, në disa raste, ajo mund të rishikohet:

- Për instrumentet me normë interesi të ndryshueshme, NEI rillogaritet periodikisht për të pasqyruar ndryshimet në normat e interesit të tregut..
- Për rregullimet e mbrojtjes së vlerës së drejtë, NEI rishikohet kur fillon amortizimi i rregullimit të mbrojtjes.

Trajtimi i Aseteve të Dëmtuara nga Kredia

- Për asetet financiare që bëhen të dëmtuara nga kredia pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën efektive të interesit mbi koston e amortizuar, dhe jo mbi shumën bruto të mbartur.
- Nëse një aset financiar nuk është më i dëmtuar nga kredia, llogaritja e të ardhurave nga interesat kalon në bazën bruto.
- Për asetet financiare që kanë qenë të dëmtuara nga kredia që në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi mbeten të bazuara në normën efektive të interesit të rregulluar për riskun e kredisë, edhe nëse risku i kredisë përmirësohet. Në këto raste, llogaritja nuk rikthehet në bazën bruto.

Kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

‘Kostoja e amortizuar’ e një pasurie financiare ose të një detyrimi financiar është shuma në të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e kryera të principalit, plus ose minus amortizimin kumulativ të ndonjë difference midis shumës fillestare dhe shumës në maturim, duke përdorur metodën e efektive të interesit dhe, për pasuritë financiare, e rregulluar për çdo provizion për humbje të pritshme nga risku i kredisë. ‘Shuma bruto e mbartur e një pasurie financiare’ është kostoja e amortizuar e asaj pasurie financiare, përpara se të bëhet ndonjë rregullim për provizionin për humbje të pritshme nga risku i kredisë.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(c) Tarifatat dhe komisionet

Tarifatat që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë tarifatat fillestare të marra ose të paguara nga banka në lidhje me krijimin ose blerjen e një pasurie financiare ose emetimin e një detyrimi financiar. Këto mund të përfshijnë tarifa për vlerësimin e kreditueshmërisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive apo kolateralit, negocimin e kushteve të instrumentit dhe përpunimin e dokumenteve të transaksionit. Tarifatat e angazhimit të marra nga Banka për krijimin e kredive me normat e interesit të tregut, konsiderohen pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse ka gjasa që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike për kredi dhënie dhe ka qëllim ta shesë kredinë menjëherë pas krijimit të saj. Të gjitha tarifatat e tjera, që janë pjesë përbërëse e llogaritjes së normës efektive të interesit, njihen si të hyra nga interesi.

Të gjitha tarifatat, komisionet dhe zërat e tjerë të të ardhurave dhe shpenzimeve regjistrohen zakonisht sipas parimit të të ardhurave të realizuara, bazuar në përfundimin e transaksionit specifik dhe proporcionin e shërbimeve të kryera. Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifatat dhe komisionet përfshijnë tarifatat për kartelat e kreditit, shërbimet e llogarive, pagesat ndërkombëtare dhe vendore, tarifatat e Bankës Qendrore, SMS-banking, garancitë dhe letrat e kreditit, si dhe tarifa dhe komisione të tjera.

Tarifatat dhe komisionet e tjera njihen kur shërbimet përkatëse ofrohen, ndërsa shpenzimet nga tarifatat dhe komisionet që lidhen me transaksione dhe shërbime, regjistrohen si shpenzime në momentin kur shërbimi merret.

(d) Qiratat

ProCredit Bank si qiramarrës

Në fillim të kontratës, banka vlerëson nëse marrëveshja përbën ose përmban një qira. Kjo ndodh kur marrëveshja i jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aseti të identifikuar për një periudhë të caktuar kohore, në këmbim të një tarife. Banka përdor opsionin për të trajtuar çdo komponent të qirasë dhe komponentët përkatës që nuk janë pjesë e qirasë si një komponent të vetëm qiraje. ProCredit Bank njihet një aset për të drejtën e përdorimit të dhënë, si dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të kontratës.

Aseti i së drejtës së përdorimit njihet me koston e përvetësimit. Këto kosto përfshijnë detyrimin e qirasë, çdo kosto fillestare direkte të kryer para ose në datën e fillimit të kontratës, pagesat e qirasë të bëra para fillimit, si dhe vlerësimin e kostove për çmontim dhe largim të pasurisë, minus çdo stimul të marrë nga qiradhënësi. Më pas, asetit matet me koston minus amortizimin e grumbulluar dhe çdo humbje nga ulja në vlerë.

Detyrimi për qiranë njihet në vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të qirasë që nuk janë bërë ende, të diskontuara me normën inkrementale të interesit për huamarrësin. Më pas, detyrimi për qiranë matet me koston të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Qiratat afatshkurtra (me afat qiraje prej 12 muaj ose më pak) dhe qiratat për asete me vlerë të ulët nuk njihen në bilanc; në vend të kësaj, pagesat për qira njihen si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes gjatë afatit të qirasë. Qiratat njihen si një aset i së drejtës së përdorimit dhe një detyrim përkatës në datën kur asetit i marrë me qira është i disponueshëm për përdorim nga banka. Çdo pagesë e qirasë ndahet midis detyrimit dhe koston financiare. Kostoja financiare njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes gjatë afatit të qirasë, duke siguruar një normë interesi të qëndrueshme periodike mbi detyrimin e mbetur të qirasë. Aseti i së drejtës së përdorimit amortizohet në mënyrë lineare përgjatë afatit më të shkurtër ndërmjet jetëgjatësisë së dobishme të asetit dhe afatit të qirasë. Aseti i së drejtës së përdorimit paraqitet ose veçmas, ose brenda një kategorie të përshtatshme të aseteve, siç është "Prona, Impiantet dhe Pajisje". Asetet dhe detyrimet që dalin nga një qira maten fillimisht sipas të vlerës aktuale. Detyrimet nga qiratat përfshijnë vlerën neto aktuale të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- Pagesat fikse (përfshirë pagesat që në thelb janë fikse), minus çdo shtesë të qirasë që pritët të merret.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(d) Qiratë (vazhdim)

Pagesat e qirasë diskontohen duke përdorur normën inkrementale të huamarrjes së qiramarrësit, që është norma që qiramarrësi do të duhej të paguante për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aset me vlerë të ngjashme në një mjedis ekonomik të ngjashëm, me kushte dhe afate të ngjashme.

Çdo pagesë e qirasë ndahet ndërmjet detyrimit dhe kostos financiare. Detyrimet nga qiratë maten më pas duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Shuma e mbartur e detyrimit rillogaritet nëse ndodh një rivlerësim, modifikim i qirasë, apo rishikim i pagesave që në thelb janë fikse.

Afati i qirasë është periudha që nuk mund të anulohet; periudhat që përfshihen nga opsionet për zgjatje dhe përfundim të qirasë nëse ka siguri të arsyeshme që qiraja do të zgjatet.

Asetet e së drejtës së përdorimit maten fillimisht me kosto, që përfshin si më poshtë:

- Shuma e matjes fillestare të detyrimit nga qiraja.

Më pas, Asetet me të Drejtë të Përdorimit maten me koston fillestare, minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi, të rregulluara për rillogariten e detyrimit të qirasë për shkak të rivlerësimeve apo modifikimeve të qirasë. Asetet e të drejtës së përdorimit amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër midis jetës së dobishme të asetit dhe afatit të qirasë, duke përdorur metodën lineare.

Banka merr me qira hapësira zyrash. Qiratë negocohen individualisht, por në përgjithësi përmbajnë kushte dhe terma të ngjashëm (përfshirë të drejtat përfundim dhe rinovim). Opsionet për zgjatjen dhe përfundim janë të përfshira në kontratat e qirasë. Këto opsione përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operativ në menaxhimin e aseteve që përdoren në aktivitetet e bankës.

Kostot për qiratë me vlerë të ulët njihen si shpenzime drejtpërdrejt në pasqyrën e fitimit ose humbjes në humbjes në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

(e) Transaksionet në valutë të huaj

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare të veçanta maten duke përdorur monedhën me të cilën subjekti operon në mjedisin e tij ekonomik kryesor ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare paraqiten në Euro, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese e bankës.

Asetet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj përkthehen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit të mbylljes, ndërsa zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve përkthehen sipas kursit fiks në momentin e transaksionit.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga shlyerja e këtyre transaksioneve dhe nga përkthimi me kurset e këmbimit në fund të vitit i pasurive dhe detyrimeve monetare të shprehura në valutë të huaj njihen në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes.

Në rastin e ndryshimeve në vlerën e drejtë të aseteve financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse të tjera, të denominuara në valutë të huaj, bëhet një dallim midis diferencave të kursit të këmbimit që rezultojnë nga ndryshimet në koston e amortizuar të titullit dhe ndryshimeve të tjera në vlerën kontabël të titullit. Diferencat nga kursi i këmbimit për asetet financiare (instrumente borxhi) me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse të tjera njihen në Pasqyrën e Veçantë të Fitimit ose Humbjes, ndërsa ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë njihen në të Ardhurat Gjithëpërfshirëse të Tjera (VDATGJ).

Zërat jo-monetarë të huaj, të matur sipas koston e amortizuar, përkthehen me kursin historik të këmbimit në datën e transaksionit.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumata janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(f) Tatimi në fitim

Tatimet mbi të ardhurat janë njohur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin që ishte në fuqi ose thelbësisht në fuqi deri në fund të periudhës raportuese. Shpenzimi për tatimin mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë, dhe njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin, përveç rasteve kur njihet në të ardhurat gjithëpërfshirëse të tjera ose direkt në ekuitet.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma që pritët të paguhet ose të rikuperohet nga autoritetet tatimore, bazuar në fitimet ose humbjet tatimore për periudhat aktuale dhe ato të mëparshme. Kur pasqyrat financiare autorizohen përpara dorëzimit të deklaratave tatimore përkatëse, fitimet ose humbjet tatimore vlerësohen duke përdorur informacionin e disponueshëm.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përlogaritet duke përdorur metodën e detyrimit në bilancin e gjendjes, duke marrë në konsideratë bartjet përpara të humbjeve tatimore dhe ndryshimet e përkohshme midis bazës tatimore të aseteve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar.

Bilancet e tatimit të shtyrë maten me normat tatimore që janë në fuqi ose thelbësisht në fuqi në fund të periudhës raportuese, dhe që pritët të zbatohen kur ndryshimet e përkohshme do të kthehen ose kur do të shfrytëzohen humbjet tatimore të bartura.

Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjitha ndryshimet e përkohshme të tatueshme. Asetet për tatimin e shtyrë që rrjedhin nga ndryshimet e përkohshme të zbritshme dhe nga bartjet përpara të humbjeve tatimore regjistrohen vetëm nëse është e mundur që fitimet tatimore të ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të shfrytëzuar këto zbritje. Shuma kontabël e aseteve për tatimin e shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet nëse nuk është më e mundur që do të ketë fitim tatimor të mjaftueshëm për të lejuar përdorimin e plotë ose të pjesshëm të aseteve për tatimin e shtyrë.

Asetet dhe detyrimet për tatimin e shtyrë netohen kur ekziston një e drejtë ligjore e zbatueshme për të netuar detyrimet dhe asetet tatimore aktuale, dhe kur ato i nënshtrohen të njëjtit autoritet tatimor.

(g) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka njeh fillimisht një aset financiar ose një detyrim financiar në pasqyrën e pozicionit financiar (përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të aseteve financiare) kur, dhe vetëm kur, Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aset financiar ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, duke shtuar ose zbritur, në rastin e një aseti ose detyrimi financiar që nuk matet me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes (VDPFH), kostot e transaksionit që janë drejtpërdrejt të atribueshme për përvetësimin ose emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një aset financiar klasifikohet si i matur në: kosto të amortizuar, vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse të tjera (VDATG)), ose vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH).

Një aset financiar matet me kosto të amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme:

- aseti financiar mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë asetet financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të aseteve financiare krijojnë flukse monetare në data të caktuara që përbëjnë vetëm Pagesa të Principalit dhe të Interesit (SPPI) për shumën e principalit të papaguar.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Asetet financiare (vazhdim)

Një aset financiar matet me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse të tjera (VDATGJ) vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aset financiar mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit arrihet si përmes mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale, ashtu edhe përmes shitjes së aseteve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të aseteve financiare krijojnë në data të caktuara flukse monetare që përfaqësojnë vetëm Pagesa të Principalit dhe të Interesit (SPPI) për shumën e principalit të papaguar.

Të gjitha asetet e tjera financiare klasifikohen si të matur me VDPFH (vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes). Për më tepër, në njohjen fillestare, Banka mund të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një aset financiar – i cili përndryshe do të përmbushte kriteret për t'u matur me kosto të amortizuar ose me VDATGJ (vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse) – si VDPFH, nëse ky caktim eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël që përndryshe do të shfaqej.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka vlerëson qëllimin e një modeli biznesi në nivel portofoli, pasi kjo qasje pasqyron më mirë mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe si i komunikohet informacioni menaxhmentit. Informacioni që merret në konsideratë përfshinë:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe zbatimin praktik të tyre. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave nga interesat kontraktuale, ruajtjen e një profili të caktuar të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që i financojnë ato, ose realizimin e flukseve monetare përmes shitjes së aseteve.
- mënyra se si vlerësohet performanca e portofolit dhe si raportohet kjo performancë tek menaxhmenti i Bankës.
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aseteve financiare që mbahen brenda këtij modeli biznesi) dhe strategjinë përkatëse të zbatuar për menaxhimin e tyre;
- frekuenca, volumi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje dhe pritshmëritë lidhur me aktivitetin e shitjeve në të ardhmen. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk shqyrtohet në mënyrë të izoluar, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm të mënyrës se si realizohet qëllimi i deklaruar i Bankës për menaxhimin e aseteve financiare dhe realizimin e flukseve monetare.

Asetet financiare që mbahen për tregtim ose që menaxhohen brenda një modeli biznesi ku performanca vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë maten me VDPFH (Vlerë të Drejtë Përmes Fitimit ose Humbjes). Ky klasifikim aplikohet sepse këto asete nuk mbahen as vetëm për të mbledhur flukset monetare kontraktuale, as për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur asete financiare. Si rezultat, zërat e bilancit që janë të alokuar në modelin e biznesit “mbajtje për mbledhjen e flukseve monetare” përfshijnë: “Balancat me Bankën Qendrore”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve”, si dhe “Asetet e tjera”. “Letrat me vlerë investuese” i atribuohen modelit të biznesit “mbajtje për të mbledhur dhe për të shitur”.

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit

Për qëllimet e vlerësimit SPPI sipas IFRS 9, “principal” përkufizohet si vlera e drejtë e aktivës financiare në momentin e njohjes fillestare. “Interesi” përkufizohet si shpërblimi për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kreditit që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar, si dhe për rreziqe të tjera themelore të huadhënies dhe kostot përkatëse (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), përfshirë edhe marzhën e fitimit.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale të një aktivi financiar përmbushin kriteret SPPI, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një klauzolë kontraktuale që mund të ndryshojë kohën apo shumën e flukseve monetare kontraktuale në një mënyrë që do të rezultonte në mosplotësimin e kushteve SPPI. Gjatë këtij vlerësimi, Banka merr në konsideratë:

- ngjarje të mundshme që do të ndryshonin shumën dhe kohën e flukseve monetare;
- karakteristika të levës financiare (leverage);
- kushtet e parapagimeve ose zgjatjes së maturimit;
- kushte që kufizojnë të drejtën e Bankës për të përfituar flukse monetare nga asete të caktuara (p.sh. kredi pa regres); dhe
- veçori që modifikojnë përlogaritjen e vlerës kohore të parasë (p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit).

Banka mban një portofol kredish afatgjata me normë interesi fikse, për të cilat ka të drejtë të propozojë rishikimin e normës së interesit në data të caktuara rivendosjeje. Këto të drejta rivendosjeje janë të kufizuara në normën e tregut në momentin e rishikimit. Huamarrësit kanë mundësinë të pranojnë normën e re ose të kërkojnë shlyerje të parakohshme, bazuar në kushtet e kontratës.

Banka ka vlerësuar se flukset monetare kontraktuale të këtyre kredive përmbushin kriterin për Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit (VPPI), pasi kjo mundësi ndryshon normën e interesit në një mënyrë që përfaqëson shpërblim për vlerën kohore të parasë, rrezikun e kreditit, si dhe rreziqe dhe kosto të tjera të zakonshme të huadhënies që lidhen me shumën e principalit të papaguar.

Kreditë pa regres

Në disa raste, kreditë e dhëna nga Banka që janë të siguruara me kolateral nga huamarrësi kufizojnë të drejtën e Bankës për të përfituar flukse monetare vetëm nga kolaterali bazë (kredi pa regres). Banka përdor vlerësimin profesional për të përcaktuar nëse këto kredi pa regres përmbushin kriterin për Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit (VPPI). Gjatë këtij vlerësimi, Banka zakonisht merr parasysh informacionin e mëposhtëm:

- nëse marrëveshja kontraktuale përcakton në mënyrë të qartë shumën dhe datat e pagesave monetare të kredisë;
- vlera e drejtë e kolateralit në raport me shumën e aktivës financiare të siguruar;
- aftësia dhe gatishmëria e huamarrësit për të kryer pagesat kontraktuale, pavarësisht rënies në vlerën e kolateralit;
- nëse huamarrësi është individ, subjekt që operon realisht apo një entitet me qëllim të veçantë (special purpose entity);
- rreziku i humbjes për Bankën në këtë aktiv në krahasim me një kredi me regres të plotë;

- shkalla në të cilën kolaterali përbën të gjitha ose pjesën më të madhe të aseteve të huamarrësit; dhe
- nëse Banka përfiton nga ndonjë rritje e vlerës së aseteve themelore.

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën kur Banka ndryshon modelin e biznesit për menaxhimin e pasurive financiare.

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një aset financiar kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga asetit përfundojnë (shih gjithashtu pika (iv)), ose kur ajo transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin transferohen pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga zotërimi i asetit financiar, ose kur Banka as nuk transferon dhe as nuk mban në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga zotërimi dhe nuk ruan kontrollin mbi asetin financiar.

Me çregjistrimin e një asetit financiar, diferenca midis shumës së mbartur të asetit (ose pjesës së mbartur që i përket pjesës së çregjistruar) dhe shumës së: (i) kundërvlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri të përfituar minus çdo detyrim të ri të marrë përsipër), dhe (ii) çdo fitimi ose humbjeje të akumuluar më parë të njohur në të ardhurat gjithëpërfshirëse të tjera, njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare (vazhdim)

Çdo fitim ose humbje e akumuluar e njohur më parë në të ardhurat gjithëpërfshirëse të tjera për titujt e investimit në kapital, të klasifikuar si VDATGJ, nuk riklasifikohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes pas çregjistrimit. Gjithashtu, çdo interes që krijohet ose ruhet nga Banka në një aset financiar të transferuar që kualifikohet për çregjistrim, njihet si një aset ose detyrim i veçantë.

Banka hyn në transaksione ku transferon asete të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por ruan të gjitha, pothuajse të gjitha, ose një pjesë të rreziqeve dhe përfitimeve që lidhen me asetet e transferuara. Në këto raste, asetet e transferuara nuk çregjistrohen. Shembuj të tillë transaksionesh përfshijnë: huazimin e titujve (securities lending), marrëveshjet e shitjes me rikthim (sale-and-repurchase transactions).

Kur asetet shiten të një palë e tretë së bashku me një marrëveshje të njëkohshme për kthimin e normës totale të fitimit mbi ato asete, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me shitje me rikthim, pasi Banka ruan të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga zotërimi i këtyre aseteve.

Në transaksione në të cilat Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të një aseti financiar, por ruan kontrollin mbi asetin, Banka vazhdon ta njohë asetin në masën e përfshirjes së saj në vazhdimësi, e cila përcaktohet nga ekspozimi i saj ndaj ndryshimeve në vlerën e asetit të transferuar.

Në disa raste, Banka ruan detyrimin për të ofruar shërbimin ndaj asetit financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aseti i transferuar çregjistrohet vetëm nëse përmbush kriteret për çregjistrim. Një aset ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit nëse tarifa e shërbimit është më e madhe se shpenzimet përkatëse (aset) ose më e vogël se shpenzimet (detyrim).

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të saj shlyhen, anulohen ose skadojnë.

(iv) Modifikimet e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare

Pasuritë financiare

Nëse kushtet e një aseti financiar modifikohen, atëherë Banka vlerëson nëse flukset monetare të asetit së modifikuar janë ndjeshëm të ndryshme.

Nëse flukset monetare janë ndjeshëm të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar origjinal konsiderohen të kenë përfunduar.

Në këtë rast, aset i financiar origjinal çregjistrimet (shih pika (iii)) dhe një aset financiar i ri njihet me vlerë të drejtë, plus çdo kosto transaksioni që përmbush kushtet për përfshirje.

Çdo tarifë e marrë si pjesë e modifikimit kontabilizohet si më poshtë:

- tarifat që merren në konsideratë në përcaktimin e vlerës së drejtë të asetit së re dhe tarifat që përfaqësojnë rimbursim të kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në matjen fillestare të asetit; dhe
- tarifat e tjera përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes si pjesë e fitimit ose humbjes nga çnjohja.

Nëse flukset monetare modifikohen kur huamarrësi ndodhet në vështirësi financiare, atëherë qëllimi i modifikimit zakonisht është të maksimizohet rikuperimi i kushteve kontraktuale origjinale, dhe jo krijimi i një aseti të ri me kushte ndjeshëm të ndryshme.

Nëse Banka planifikon të modifikojë një aset financiar në një mënyrë që do të rezultonte në falje të flukseve monetare, ajo fillimisht shqyrton nëse një pjesë e asetit duhet të shkruhet si humbje përpara se të ndodhë modifikimi. Kjo qasje ndikon në rezultatin e vlerësimit sasior dhe do të thotë që kriteret për ndërprerjen e njohjes zakonisht nuk përmbushen në raste të tilla.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Modifikimet e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Pasuritë financiare (vazhdim)

Nëse modifikimi i një aseti financiar të matur me kosto të amortizuar ose me VDATGJ nuk rezulton në ndërprerjen e njohjes së asetit financiar, atëherë Banka fillimisht ri-llogarit shumën bruto të mbartur të asetit duke përdorur normën efektive origjinale të interesit të asetit dhe njeh rregullimin e rezultuar si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Për asetet financiare me normë interesi të ndryshueshme, norma efektive e interesit që përdoret për të llogaritur fitimin ose humbjen nga modifikimi rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në momentin e modifikimit. Çdo kosto ose tarifë e pësuar, si dhe tarifat e marra si pjesë e modifikimit, rregullojnë shumën bruto të mbartur të asetit financiar të modifikuar dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të tij.

Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih pika (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga përkeqësimi i vlerës. Në raste të tjera, ajo paraqitet si të ardhura nga interesa, të llogaritura sipas metodës së normës efektive të interesit.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij modifikohen dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë ndjeshëm të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim financiar i ri, bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerë të drejtë. Diferenca midis shumës së mbartur të detyrimit financiar të çregjistruar dhe kundërvlerës së paguar njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kundërvlera e paguar përfshin asete jo-financiare të transferuara, nëse ka, dhe marrjen përsipër të detyrimeve, përfshirë edhe detyrimin financiar të ri të modifikuar. Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk rezulton në çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke zbritur flukset monetare të modifikuara me normën efektive origjinale të interesit, dhe fitimi ose humbja e rezultuar njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për detyrimet financiare me normë interesi të ndryshueshme, norma efektive origjinale e interesit që përdoret për të llogaritur fitimin ose humbjen nga modifikimi rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në momentin e modifikimit.

Çdo kosto dhe tarifë e pësuar njihet si rregullim i shumës së mbartur të detyrimit dhe amortizohet gjatë periudhës së mbetur të detyrimit financiar të modifikuar, duke rillogaritur normën efektive të interesit të instrumentit.

(v) Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare thehen mes vete dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Banka ka aktualisht një të drejtë ligjore të zbatueshme për të kompensuar shumën dhe ka qëllim ose të shlyejë në bazë neto, ose të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen sipas SNRF, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme siç është aktiviteti tregtar i Bankës.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të merrej për shitjen e një aseti ose do të paguhej për transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos performancës.

Kur është në dispozicion, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si “aktiv” nëse transaksionet për asetin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të ofruar informacion të qëndrueshëm mbi çmimet.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Nëse nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave të pa vëzhgueshme. Teknikat e zgjedhura të vlerësimit përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni. Dëshmia më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – pra vlera e drejtë e kundërvlerës së dhënë ose marrë. Nëse Banka përcakton që vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, dhe kjo vlerë nuk mbështetet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aset apo detyrim identik, e as nga një teknikë vlerësimi ku inputet e pa vëzhgueshme janë të parëndësishme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerë të drejtë, e rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohje dhe çmimit të transaksionit.

Më pas, kjo diferencë njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në mënyrë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlera mbështetet tërësisht në të dhëna të vëzhgueshme të tregut, ose kur transaksioni përmbyllet.

Nëse një aset ose një detyrim i matur me vlerë të drejtë ka çmim të blerjes dhe çmim të shitjes, atëherë Banka mat asetet dhe pozicionet e gjata me çmimin e blerjes, ndërsa detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e shitjes.

Portofolet e aseteve financiare dhe detyrimeve financiare që janë të ekspozuara ndaj rrezikut të tregut dhe rrezikut të kreditit dhe që menaxhohen nga Banka në bazë të ekspozimit neto ndaj secilit prej këtyre rreziqeve, maten në bazë të çmimit që do të merrej për të shitur një pozicion neto të gjatë (ose që do të paguhej për të transferuar një pozicion neto të shkurtër) për atë ekspozim të veçantë ndaj rrezikut. Rregullimet në nivel portofoli – si p.sh. rregullimet bid-ask apo ato për rrezikun e kreditit që pasqyrojnë matjen në bazë të ekspozimit neto – alokohen në mënyrë proporcionale tek asetet dhe detyrimet individuale bazuar në rregullimin përkatës të rrezikut të secilit instrument në portofol.

Vlera e drejtë e një detyrimi financiar që ka karakteristikë kërkese (p.sh. depozitë kërkese) nuk është më e vogël se shuma që duhet paguar sipas kërkesës, e zbritur nga data e parë kur mund të kërkohej pagesa.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Dëmtimi

Banka njeh lejimet për humbjet e pritshme kreditore (HPK) për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk maten në VDPFH:

- Pasuritë financiare që janë instrumente borxhi;
- kontratat e garancisë financiare të emetuara; dhe
- zotimet e huas të emetuara.

Banka matë lejimet e humbjeve në një shumë të barabartë me HPK-të përgjatë jetëgjatësisë, përveç për të mëposhtmet, për të cilën ato maten si HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë riskut të ulët të kredisë në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare (përveç të ardhurave nga qiratë) në të cilat riskut i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Dëmtimi (vazhdim)

Banka e konsideron investimin e borxhit që të ketë riskut të ulët kreditor kur vlerësimi i riskut të saj të kredisë është i barabartë me përkufizimin e njohur botërisht të “klasës së investimeve”. Banka nuk zbaton përjashtimin e riskut të ulët të kredisë për çdo instrument financiar tjetër.

HPK-të 12-mujore janë pjesë e HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të pagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat një HPK 12 mujore është njohur, njihen si Instrumente financiare të Fazës 1.

HPK-të përgjatë gjithë jetës janë HPK që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit të pagesës gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK përgjatë tërë jetës, por që nuk janë të dëmtuara nga aspekti kreditor, referohen si Instrumentet Financiare të Fazës 2.

Matja e HPK-ve

HPK-të janë një vlerësim me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditore. Ato maten si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të dëmtuara në aspektin kreditor në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha mungesave të parasë (p.sh. diferenca midis rrjedhave të parasë që i detyrohen entitetit në përputhje me kontratën dhe rrjedhat e parasë që Banka pret të marrë);
- pasuritë financiare që janë të dëmtuara në aspektin kreditor në datën e raportimit: si diferenca midis shumës bruto të mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme në të ardhmen;
- zotimet për huadhënie të pashfrytëzuara: si vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i takohen Bankës nëse zotimi aktivizohet dhe flukseve monetare që Banka pret të marrë; dhe
- kontratat e garancive financiare: si pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin, minus çdo shumë që Banka pret të rikuperojë.

Pasuritë financiare të ristrukturuara

Nëse kushtet e një pasurie financiare ri-negociohen ose modifikohen ose një pasuri financiare ekzistuese zëvendësohet me një të re për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet vlerësimi nëse pasuritë financiare duhet të ç’regjistrohen dhe HPK-të të maten si më poshtë.

- Nëse ristrukturimi i pritur nuk do të rezultojë në çregjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë rrjedhat e pritshme të parasë që rrjedhin nga pasuria financiare e modifikuar përfshihen në llogaritjen e rënies së parasë nga pasuria ekzistuese.

- Nëse ristrukturimi i pritur do të rezultojë në çregjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë vlera e drejtë e pritur e pasurisë së re trajtohet si rrjedha e fundit e parasë nga pasuria financiare ekzistuese në kohën e ç’regjistrimit të saj. Kjo shumë përfshihet në llogaritjen e mungesave të parasë nga pasuria financiare ekzistuese që skontohej nga data e pritur e çregjistrimit deri në datën e raportimit duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare ekzistuese.

Pasuritë financiare të dëmtuara në aspektin kreditor

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse pasuritë financiare të mbartura me kosto të amortizuar dhe pasuritë financiare të borxhit të mbartura me VDATGJ janë të dëmtuara nga aspektin kreditor (referuar si “Pasuritë financiare të fazës 3”). Një aset financiar konsiderohet si “i dëmtuar nga aspekti kreditor” kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset monetare të pritshme të këtij asemi. Prova që tregon se një aset financiar është i dëmtuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme si:

- Ekspozimet materiale janë me më shumë se 90 ditë vonesë;
- Debitori nuk pritët të përmbushë detyrimet kreditore pa realizuar kolateralin, pavarësisht statusit të vonesës së pagesës.

Ky klasifikim zbatohet për:

- Kreditë, letrat me vlerë të borxhit dhe raste të tjera të mospagimit në librin bankar të përdorur për llogaritje kapitale;
- Zëra jashtë bilancit si angazhime të pashfrytëzuara dhe garanci.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Dëmtimi (vazhdim)

Klasifikimi si "jo-performues" është i pavarur nga klasifikimi rregullator si "moskryerje" (default) ose statusi kontabël si "i dëmtuar". Ekspozimet e klasifikuara si të mos paguara apo të dëmtuara (sipas rregulloreve apo IFRS) konsiderohen si jo-performuese. Ekspozimet kategorizohen në shumën e tyre të plotë, duke mos marrë në konsideratë praninë e kolateralit. Angazhimet klasifikohen si jo-performuese nëse, në rast aktivizimi, ato krijojnë një rrezik të lartë të mospagimit pa pasur mbulim me kolateral. Garancitë klasifikohen si jo-performuese nëse ekziston rreziku që të aktivizohen, ose nëse arkëtueshmëritë që rrjedhin nga to përmbushin kriteret e klasifikimit si jo-performuese pas ekzekutimit të garancisë. Një kredi që është rin negociuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes së huamarrësit zakonisht konsiderohet si e dëmtuar, përveç nëse ka prova që rreziku për të mos marrë flukset monetare kontraktuale është zvogëluar ndjeshëm dhe nuk ka tregues të tjerë të dëmtimit. Për më tepër, çdo kredi me vonesë prej 90 ditësh ose më shumë konsiderohet si e dëmtuar nga aspekti kreditor.

Gjatë vlerësimit nëse një investim në borxh të huaj ka rënie në vlerë, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimi i tregut për besueshmërinë kreditore, i reflektuar në normat e interesit të obligacioneve;
- Vlerësimet e agjencive të renditjes së kreditit për besueshmërinë kreditore;
- Aftësia e vendit për të pasur akses në tregjet e kapitalit për emetim të ri borxhi;
- Probabiliteti i ristrukturimit të borxhit, i cili mund të sjellë humbje për mbajtësit përmes faljes vullnetare apo të detyrueshme të borxhit;

- Mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes për të siguruar mbështetjen e nevojshme si "huadhënës i zgjidhjes së fundit" në atë vend, si dhe qëllimin e pasqyruar në deklaratat publike të qeverive dhe agjencive për përdorimin e këtyre mekanizmave. Kjo përfshin vlerësimin e kapacitetit real të këtyre mekanizmave për të përmbushur kriteret, pavarësisht vullnetit politik.

Paraqitja e lejimit për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet e humbjeve për HPK-të janë të prezantuara në pasqyrat financiare si në vijim:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare: në përgjithësi si provizion;

- në rastet kur një instrument financiar përfshin si komponentin e përdorur (tërhequr), ashtu edhe atë të papërdorur, dhe Banka nuk mund të identifikojë veçmas HPK për komponentin e zotimit nga ato për pjesën e tërhequr: Banka paraqet një lejim të përbashkët për humbje për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si zbritje nga shuma bruto e mbartur e komponentit të tërhequr. Çdo tepricë e lejimit për humbje mbi shumën bruto të komponentit të tërhequr paraqitet si provizion; dhe
- instrumentet e borxhit të matur me VDATGJ: lëvizjet në lejimin për HPK njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, ndërsa vetë lejimi kreditohet në rezervën e VDATGJ.

Shlyerjet

Kur një kredi konsiderohet e pa pagueshme, ajo fshihet nga libri kundrejt lejimit për humbje përkatës, për sa kohë që nuk ekziston një pritshmëri e justifikuar për shlyerje. Kjo ndodh zakonisht kur Banka konstaton se huamarrësi nuk zotëron asete ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë flukse monetare të mjaftueshme për të shlyer shumën që fshihet. Ky vlerësim kryhet në nivelin individual të pasurive.

Rikuperimet e mëvonshme të shumave që janë shlyer njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes nën "Provizionet e humbjeve".

Pasuritë financiare të fshira mund të vazhdojnë të jenë subjekt i veprimeve përmbartimore, në përputhje me procedurat e rikuperimit të Bankës.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Dëmtimi (vazhdim)

Kontratat jo-integrale të garancisë financiare

Banka vlerëson nëse një kontratë e garancionit financiar është një element integral i një pasurie financiare që llogaritet si një komponent i atij instrumentit ose është një kontratë që llogaritet veçmas. Faktorët që Banka i konsideron kur bën këtë vlerësim përfshijnë nëse:

- garancioni është përfshirë në mënyrë të tërthortë në kushtet kontraktuale të instrumentit të borxhit;
- garancioni kërkohet nga ligjet dhe rregulloret që rregullojnë kontratën e borxhit
- garancioni lidhet në të njëjtën kohë dhe në shqyrtimin e instrumentit të borxhit; dhe
- garancioni ofrohet nga kompania mëmë e huamarrësit ose nga një shoqëri tjetër brenda grupit të tij.

Nëse Banka përcakton se garancioni është një element integral i pasurisë financiare, atëherë çdo premi e pagueshme në lidhje me njohjen fillestare të pasurisë financiare trajtohet si një kosto e transaksionit për blerjen e tij. Banka e konsideron efektin e mbrojtjes gjatë matjes së vlerës së drejtë të instrumentit të borxhit dhe kur matet HPK-ja.

Nëse Banka përcakton se garancioni nuk është një element integral i instrumentit të borxhit, atëherë ajo njeh një pasuri që përfaqëson çdo parapagim të primit të garancionit dhe një të drejtë për kompensim nga humbjet kreditore. Një pasuri parapagim i premisë njihet vetëm nëse ekspozimi i garantuar as nuk është i dëmtuar në aspektin kreditor dhe as nuk ka pësuar një rritje të konsiderueshme të riskut të kredisë kur jepet garancioni. Këto pasuri njihen në 'pasuri të tjera'. Banka paraqet fitim ose humbje në të drejtën e kompensimit në fitim ose humbje në zërin 'humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiarë'.

(h) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartëmonedha në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe pasuri financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes. Këto asete kanë risk të ulët të ndryshimit në vlerën e tregut të tyre, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e zotimeve afatshkurtra. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar.

(i) Kreditë dhe paradhëniet

“Kreditë dhe paradhëniet” në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

- huat dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar; ato fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte shtesë të transaksionit dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv;

- huat dhe paradhëniet e matura në mënyrë të detyrueshme në VDPFH ose të përcaktuara si në VDPFH (shih J); këto maten me vlerën e drejtë me ndryshimet e njohura menjëherë në fitim ose humbje; dhe
 - të arkëtueshmet nga qiraja/lizingu financiar
- Kur Banka blen një pasuri financiare dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të rishitur pasurinë (ose një pasuri të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo e kundërt ose huamarrja e aksioneve), marrëveshja llogaritet si një hua ose paradhënie, dhe pasuria bazë nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

(j) Investimet në letra me vlerë

“Investimet në letra me vlerë” në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë: letrat me vlerë të borxhit të matura në VDATGJ. Për titujt e borxhit të matur në VDATGJ, fitimet dhe humbjet njihen në ATGJ përveç për të mëposhtmet, të cilat njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar:

- të ardhurat nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- HPK-të dhe stornimet; dhe
- fitimet dhe humbjet në valutë të huaj.

Kur instrumentet e borxhit të matur në VDATGJ çregjistrohen, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGJ riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(k) Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet janë paraqitur me kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe rënia në vlerë e akumuluar, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së zërave të pronës dhe pajisjeve. Pjesët përbërëse të një pasurie njihen veçmas nëse kanë jetë të dobishme të ndryshme ose kanë modele të ndryshme përdorimi. Kostot e blerjes së pasurive të të drejtave të përdorimit (PDP) përfshijnë shumën e detyrimit të qirasë, plus të gjitha pagesat e qirasë të bëra në ose përpara provizionit, kostot fillestare direkte dhe kostot e vlerësuar të çmontimit dhe heqjes, minus çdo stimulim të marrë.

Kostot e mëvonshme të blerjes ose prodhimit përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri më vete, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e elementit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes gjatë periudhës aktuale financiare.

Vlera kontabël e pronës, impianteve dhe pajisjeve rishikohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ndryshojnë ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla dhe ku vlerat kontabël tejkalojnë shumën e vlerësuar si të rikuperueshme, pasuritë ose njësitë gjeneruese të parasë regjistrohen me shumën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është shuma më e madhe në mes të vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë të vlerësuar zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasuritë.

Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha të pavarura të parasë, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të parasë të cilës i përket pasuria. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i pasurive ngarkohet në bazë të metodës lineare me normat e përcaktuara për shpërndarjen e kostos së pronës, impianteve dhe pajisjeve përgjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara siç paraqitet më poshtë.

Përmirësimet e qirasë amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të kontratës së qirasë ose të përdorimit të pritshëm. Të drejtat e përdorimit amortizohen në mënyrë lineare deri në fund të afatit të qirasë.

Prona, impiantet dhe pajisjet me jetë të dobishme më shumë se një vit që bien nën pragun e materialitetit prej 100 EUR (2023: 100 EUR) dhe gjithashtu që nuk janë materiale në tërësi, regjistrohen si shpenzime në fitim ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e pronave, impianteve dhe pajisjeve përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto përfshihen në të ardhura të tjera ose shpenzime të tjera operative (sipas rastit) në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes.

Përshkrimi

Ndërtesat
Pajisjet e biznesit dhe të zyrës

Jeta e dobishme 2024

40 vite
2-10 vite

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Informata mbi politikat kontabël materiale (vazhdim)

(l) Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet në mënyrë të besueshme. Pasuritë e paprekshme maten fillimisht me kosto. Vlera kontabël e pasurive të paprekshme shqyrtohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga softueri kompjuterik dhe licencat, të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar prej pesë vitesh, nëse nuk ceket ndryshe në kontratën koresponduese.

(m) Kolaterali i marrë në pronësi

Kolaterali i marrë në pronësi përfaqëson pronat e marra nga Banka në zgjidhjen e kredive në vonesë. Këto pasuri njihen fillimisht me vlerën më të ulët në mes të vlerës së drejtë minus kosto e shitjes dhe vlerës kontabël të kredisë në datën e këmbimit. Kolaterali i luajtshëm nuk njihet si një pasuri kur merret në pronësi.

Më pas, Banka matë kolateralin e marrë në pronësi me vlerën më të ulët në mes të vlerës së njohur fillimisht dhe vlerës së drejtë të pronave minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës së drejtë, menaxhmenti përdorë vlerësimin e kryer nga vlerësuesit ekspertë të jashtëm, të licencuar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës. Banka ka aplikuar përqindje zhvlerësimi të përcaktuara nga Banka që pasqyrojnë kufizimet e tregut, shqyrtimin e vlerës kohore të parasë dhe çështjeve ligjore me pronat.

Një pronë e marrë në pronësi kontabilizohet sipas SNRF 5 – Pasuritë Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet Jo të Vijueshme dhe që pritët të shitet brenda një periudhe njëvjeçare, përveç nëse ka një vonesë të shkaktuar nga ngjarje ose rrethana jashtë kontrollit të bankës dhe ka prova të mjaftueshme që banka mbetet e angazhuar në planin e saj për të shitur pasurinë. Çdo humbje që rrjedh nga ri matja e mësipërme regjistrohet në fitim ose humbje. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

(n) Të arkëtueshmet nga bankat tjera

Shumat e arkëtueshme nga bankat e tjera regjistrohen kur Banka u parapaguan bankave të tjera pa pasur si synim tregtimin e të arkëtueshmeve jo-derivative të pakuotuara që rezultojnë në datat fikse ose të përcaktueshme. Shumat e arkëtueshme nga bankat e tjera mbarten me koston e amortizuar.

(o) Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura

Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura janë burimet kryesore të financimit të borxhit të Bankës. Kur Banka shet një pasuri financiare dhe njëkohësisht lidh një marrëveshje për të riblerë pasurinë (ose një pasuri të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshja e shitjes dhe riblerjes), marrëveshja llogaritet si një depozitë dhe pasuria bazë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

2. Material accounting policy information (continued)

(p) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Banka ka një detyrim aktual ose konstruktiv dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Detyrimi duhet të jetë i matshëm në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke zbritur flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Shkalla e zbritjes së interesit njihet si shpenzim interesi me kalimin e kohës.

(q) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet në planin e pensioneve të administruara publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato duhet të paguhen. Banka ka llogaritur dhe ofruar provizion për pushimin e pashfrytëzuar të stafit nga fundi i periudhës raportuese.

(r) Garancionet financiare dhe zotimet e huas

‘Garancitë financiare’ janë kontrata që kërkojnë që Banka të bëjë pagesa të specifikuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që ajo pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk e kryen pagesën kur duhet të jetë në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. ‘Zotimet e huas’ janë zotime të firmës të ofrojnë kredi sipas kushteve të paracaktuara.

Garancitë financiare të lëshuara ose zotimet për të dhënë një kredi me një normë interesi nën nivelin e tregut maten fillimisht me vlerën e drejtë. Më pas, ato maten në shumën më të lartë ndërmjet: lejimit për humbje të përcaktuar në përputhje me IFRS 9; dhe shumës së njohur fillimisht, të zbritur (kur është e aplikueshme) me shumën kumulative të të ardhurave të njohura në përputhje me parimet e IFRS 15. Banka nuk ka emetuar asnjë angazhim për kredi që matet me VDPFH.

Detyrimet që lindin nga garanci jo-financiare përfshihen në kategorinë e provizioneve dhe kontabilizohen si të tilla në përputhje me IAS 37.

(s) Kapitali aksionar

(i) Shpenzimet e emetimit të aksioneve

Kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejtë emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat.

(ii) Premia në aksione

Premia në aksione përfaqëson tejkalimin e kontributit të marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë aprovuar nga aksionarët e Bankës. Dividendët për vitin që janë aprovuar pas datës së raportimit nuk njihen si detyrim në fund të vitit. Dividendët shpalosen në shënime të pasqyrave financiare.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

3. Miratimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet që janë tashmë në fuqi.

Gjatë vitit aktual, Banka ka zbatuar disa ndryshime në Standardet e Kontabilitetit SNRF të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), të cilat janë me zbatim të detyrueshëm për periudha kontabël që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2024.

- Detyrimi nga qiraja në një marrëveshje shitblerjeje me rikthim në qira (Ndryshime në SNRF 16 Qiratë);
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (përfshirë shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi për këtë ndryshim) (Ndryshime në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare);
- Detyrimet afatgjata me kushte (Ndryshime në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare);
- Marrëveshjet e financimit nga furnitorët (Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Zbulimet)

Ndryshimet e listuara më sipër nuk kanë pasur asnjë ndikim në shumën e njohur në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të kenë ndikim material në periudhat aktuale apo të ardhshme.

3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë lëshuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë zbuluar më poshtë. Kompania synon të miratojë këto standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimet e mëposhtme nuk janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2024:

- Mungesa e këmbimshmërisë (Ndryshim në SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor);
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet Financiare);
- Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7);
- SNRF 18 Prezantimi dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare;
- SNRF 19 Degët pa Llogaridhënie Publike: Zbulimet.

Këto standarde, ndryshime ose interpretime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në Kompaninë gjatë periudhave aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e parashikueshme në të ardhmen.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

4. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kyçe të vlerësimit të pasigurisë

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve për periudhën financiare pasuese. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që konsiderohen të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

(a) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Supozimet kryesore dhe pasiguritë në vlerësim, të cilat mund të çojnë në një rregullim material në vitet në vijim, paraqiten më poshtë në lidhje me përkeqësimin e vlerës të instrumenteve financiare.

(i) Ngarkesa për lejimet e humbjeve nga kreditë

Banka kryen një rishikim mujor të portofolit të saj të kredive për të vlerësuar përkeqësimin për të gjitha ekspozimet kreditore brenda dhe jashtë bilancit, pavarësisht nga madhësia e tyre. Për të përcaktuar nëse duhet të regjistrohet një humbje nga përkeqësimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes, Banka bën gjykime mbi ekzistencën e të dhënave të vëzhgueshme që tregojnë për një ulje të matshme në flukset monetare të pritshme nga një portofol kredish, para se kjo ulje të mund të identifikohet me një kredi të veçantë brenda portofolit. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesave të huamarrësve në një grup, ose kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mospagimin e pasurive në Bankë.

Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke u bazuar në përvojën historike të humbjeve për asete me karakteristika të ngjashme rreziku kreditor dhe prova objektive të përkeqësimit. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të minimizuar diferencat ndërmjet humbjeve të vlerësuara dhe atyre reale.

Një rritje ose ulje prej 10% në përvojën aktuale të humbjes në krahasim me vlerësimet e humbura do të rezultojë në një rritje ose zvogëlim në dëmtimin e kredive dhe paradhënieve për EUR 1,046 mijë (2023: EUR 1,505 mijë). Humbjet nga dëmtimi për kredi të mëdha individualisht të dëmtuara (MID) bazohen në vlerësimet e rrjedhave të ardhshme të parasë të skontuara të kredive individuale, duke marrë parasysh ri pagesat dhe realizimin e çdo pasurie të mbajtur si kolateral kundrejt kredive. Rritja ose zvogëlimi i përvojës aktuale të humbjes prej 10% në krahasim me rrjedhat e ardhshme të parasë të skontuara të parashikuara kreditë e mëdha individualisht të dëmtuara (MID), të cilat mund të lindin nga diferencat në shumat dhe kohën e rrjedhave të parasë do të rezultojnë në një rritje ose zvogëlim të dëmtimit të kredive dhe paradhënieve për EUR 107 mijë (2023: EUR 85 mijë), respektivisht.

Rritja ose zvogëlimi i përvojës aktuale të humbjes	+10%		-10%	
	2024	2023	2024	2023
HKP	1,046	1,505	(1,046)	(1,505)
MID	107	85	(107)	(85)

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar

Modeli i biznesit dhe strategjia e biznesit

ProCredit Bank synon të jetë një partner kryesor në ofrimin e një game të plotë shërbimesh financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kanë një rol jetik në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Banka fokusohet gjithashtu në ofrimin e shërbimeve për klientët individualë që vlerësojnë shërbimet moderne bankare, kanë kapacitet për të kursyer dhe preferojnë të përdorin kanale elektronike për kryerjen e veprimeve të tyre bankare. ProCredit Bank vepron në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente, duke u përqendruar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët dhe në ofrimin e zgjidhjeve të personalizuar, profesionale dhe fleksibile, si për bizneset ashtu edhe për individët. Avantazhet konkurruese kryesore të bankës janë qasja individuale ndaj nevojave të klientëve dhe cilësia e lartë e shërbimeve të ofruara.

Përmes ofrimit të produkteve të thjeshta dhe të lehtësisht të aksesueshme për depozitë, banka promovon një kulturë kursimi që kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin financiar të familjeve. Në të njëjtën kohë, ProCredit Bank nuk ofron produkte të ndërlikuara financiare apo shërbime të menaxhimit të aseteve.

Banka i qaset çdo klienti në mënyrë individuale, me synimin për të kuptuar nevojat e tij dhe për të ndërtuar një strategji që i shërben në mënyrë sa më efektive. ProCredit Bank i përmbahet konceptit “Njih klientin tënd”, duke besuar se identifikimi i saktë i klientëve dhe i bizneseve të tyre i mundëson bankës të ofrojë shërbimet më të përshtatshme.

Një fokus i rëndësishëm strategjik në marrëdhënien me klientët është nxitja e investimeve në efikasitetin energjetik, energjinë e rinovueshme dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe financimi i ndërmarrjeve prodhuese dhe i prodhuesve bujqësorë. Modeli i biznesit të bankës është i thjeshtë dhe i qartë: në anën e aseteve mbizotërojnë kreditë e dhëna për klientët, ndërsa detyrimet përbëhen kryesisht nga fondet e klientëve. Strategjia e biznesit mbështetet në zhvillimin e stafit. Banka rekruton dhe trajnon me kujdes punonjësit e saj për të siguruar një qasje profesionale dhe me përgjegjësi ndaj klientëve. ProCredit Bank është një institucion i bazuar në profesionalizëm, komunikim dhe besim, dhe synon të arrijë një nivel të lartë kënaqësie si për stafin, ashtu edhe për klientët. Për këtë qëllim, banka investon ndjeshëm në trajnimin e vazhdueshëm të personelit të saj.

Strategjia e menaxhimit të rrezikut

ProCredit Bank është e ekspozuar ndaj rreziqeve gjatë aktivitetit të saj të biznesit. Një qasje e informuar dhe transparente ndaj menaxhimit të rrezikut përbën një komponent qendror të modelit të saj të biznesit me përgjegjësi sociale. Kjo reflektohet gjithashtu në kulturën e rrezikut dhe në apetitin për rrezik, duke rezultuar në procese vendimmarrjeje të balancuara nga pikëpamja e rrezikut. Duke ndjekur një qasje të qëndrueshme në nivel grupi për menaxhimin e rrezikut, banka synon të sigurojë që likuiditeti dhe adekuatshmëria e kapitalit të jenë gjithmonë të qëndrueshme dhe të përshtatshme, si dhe të arrijë rezultate të qëndrueshme. Parimet e menaxhimit të rrezikut dhe strategjia e rrezikut të bankës nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar.

Në përgjithësi, vitet e fundit janë karakterizuar nga goditje makro-financiare dhe gjeopolitike të pafavorshme. Kjo prirje pritet të vazhdojë dhe pasiguria do të mbetet e lartë. Deri më tani, ndikimi mbi bankën ka qenë i kufizuar. Megjithatë, këta faktorë do të përcaktojnë gjithashtu fokusin e aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut të institucionit në vitin 2025. ProCredit Bank do të vazhdojë të monitorojë nga afër situatën makroekonomike me qëllim vlerësimin e ndikimeve dhe, nëse është e nevojshme, ndërmarrjen e masave në kohën e duhur. Përveç kësaj, kërkesat rregullatore janë në zhvillim të vazhdueshëm. Në përgjithësi, vihet re një ashpërsim i kërkesave dhe pritshmërive.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rreziqeve individuale

Rreziqet materiale për ProCredit Bank përfshijnë: rrezikun e kredisë, rreziqet e tregut (rreziku nga kurset e këmbimit dhe rreziku i normës së interesit), rrezikun e likuiditetit dhe financimit, rrezikun operacional, rreziqet që burojnë nga pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe veprime të tjera të dënueshme me ligj, rrezikun e biznesit si dhe rrezikun nga modelet. Rreziqet ESG janë ngjarje ose kushte mjedisore, sociale ose që lidhen me qeverisjen korporative, të cilat mund të kenë një ndikim negativ aktual ose të mundshëm në pozicionin financiar, performancën financiare si dhe në reputacionin e institucionit. Banka nuk i trajton në mënyrë të veçantë rreziqet ESG, pasi është pothuajse e pamundur t'i izolojë ato. Menaxhimi i rreziqeve ESG është pjesë përbërëse e strategjisë së biznesit. Këto rreziqe mund të kenë një ndikim material mbi të gjitha rreziqet e identifikuar, duke vepruar si faktor që ndikon në materialitetin e tyre. Ndikimi më i madh i rreziqeve ESG është në rrezikun e kredisë që buron nga marrëdhëniet me klientët, përkatësisht ndikimi që këto rreziqe kanë mbi vetë klientët dhe modelet e tyre të biznesit, dhe rrjedhimisht mbi aftësinë e tyre për të mbijetuar.

(a) Risku i tregut

Rreziqet e tregut përfshijnë rrezikun e humbjeve të mundshme që lindin si rezultat i luhatjeve të çmimeve në treg, përfshirë kurset e këmbimit valutor, normat e interesit, ose parametra të tjerë që ndikojnë në çmime. Rreziqet përkatëse të tregut për Bankën janë rreziku valutor dhe rreziku i normës së interesit në librin bankar.

Banka është një institucion që nuk mban libër tregtar, dhe i menaxhon rreziqet e tregut në mënyrë të tillë që ndikimi i tyre të jetë sa më i kufizuar nga një perspektivë e përgjithshme e rrezikut. Në përputhje me strategjinë e saj të rrezikut, rreziku valutor dhe rreziku i normës së interesit nuk lejohen për qëllime spekulative. Derivatet valutore dhe ato të normës së interesit përdoren ekskluzivisht për qëllime mbrojtjeje (hedging) ose për menaxhimin e likuiditetit.

(i) Risku i valutës së huaj

Risku i valutës është risku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Banka synon të mos përfitojë nga ndonjë transaksion spekulativ, ajo përpiqet të mbajë pozicionin e saj të hapur ndaj valutave të huaja në afër zeros gjatë gjithë kohës. Kufijtë e pozicionit të hapur të valutës dhe kapaciteti për marrjen e riskut për Bankën përcaktohen nga politikat përkatëse, të cilat miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe shqyrtohen nga Departamenti i Monitorimit të Riskut. Kufijtë e rregullatorit në çdo kohë respektohen nga Banka.

Njësia e Thesarit vlerëson zhvillimet e kursit të këmbimit në lidhje me të gjitha pozicionet valutore materiale. Ndryshimet e mëdha në strukturën e pasurive dhe detyrimeve të shprehura në valutë të huaj dhe impakti i tyre rishikohen para se të realizohen tregtime nga departamenti i zyrës së përpame të thesarit të bankës.

Njësia e Thesarit gjithashtu vëzhgon tregun financiar dhe informon Departamentin e Monitorimit të Riskut rregullisht dhe në rast të zhvillimeve të rëndësishme që mund të ndikojnë në gjendjen e riskut të valutës së Bankës. Edhe pse Banka synon të mbajë pozicionin e saj të valutës sa të jetë e mundur më afër zeros, mund të ketë raste kur Banka ende ndikohet nga paqëndrueshmëria e paparashikuar e kursit të këmbimit. Prandaj, Departamenti i Monitorimit të Riskut kryen teste të stresit dhe raporton efektet në F&H e Bankës në baza mujore. Normat zyrtare të këmbimit për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit të shprehur në valuta të huaja ishin si më poshtë (në EUR):

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
1 USD	0.9626	0.9050
1 CHF	1.0625	1.0799
1 GBP	1.2060	1.1507

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

Tabelat në vijim përmbledhin pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në valutë të huaj më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, të konvertuara në mijë EUR.

31 dhjetor 2024	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Gjendjet me Bankat Qendrore	166,903	1,445	360	4	168,712
Kreditë dhe paradhëniet për banka	49,606	5,892	166	334	55,998
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	866,514	-	-	-	866,514
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	107,457	33,310	-	-	140,767
Pasuritë tjera financiare	2,697	1,023	-	-	3,720
Gjithsej pasuritë financiare monetare	1,193,177	41,670	526	338	1,235,711
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave tjera	380	1	-	-	381
Detyrimet ndaj klientëve	1,037,898	41,525	244	331	1,079,998
Huamarrjet	22,628	-	-	-	22,628
Borxhi i varur	11,591	-	-	-	11,591
Detyrimet tjera financiare	2,097	-	-	-	2,097
Gjithsej detyrime monetare financiare	1,074,594	41,526	244	331	1,116,695
Pozicioni financiar bilancor neto	118,583	144	282	7	119,016
Zotimet e kredive	107,061	77	-	-	107,138
Zërat jashtë-bilancor – letrat e kreditit	506	241	-	-	747
Zërat jashtë-bilancor – garancionet bankare	56,240	170	-	-	56,410
Gjithsej zotimet kreditore	163,807	488	-	-	164,295

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumata janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

31 dhjetor 2023	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Gjendjet me Bankat Qendrore	191,454	929	364	5	192,752
Kreditë dhe paradhëniet për banka	16,701	6,092	204	291	23,288
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	729,774	-	-	-	729,774
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	101,908	22,510	-	-	124,418
Pasuritë tjera financiare	2,006	907	-	-	2,913
Gjithsej pasuritë financiare monetare	1,041,843	30,438	568	296	1,073,146
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave tjera	1,065	1	-	-	1,066
Detyrimet ndaj klientëve	905,092	30,387	284	297	936,060
Huamarrjet	19,151	-	-	-	19,151
Borxhi i varur	7,538	-	-	-	7,538
Detyrimet tjera financiare	2,273	4	-	-	2,277
Gjithsej detyrime monetare financiare	935,119	30,392	284	297	966,092
Pozicioni financiar bilancor neto	106,724	47	284	(1)	107,054
Zotimet e kredive	85,029	72	-	-	85,101
Zërat jashtë-bilancor – letrat e kreditit	1,535	39	-	-	1,574
Zërat jashtë-bilancor – garancionet bankare	49,988	189	-	-	50,177
Gjithsej zotimet kreditore	136,552	300	-	-	136,852

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

Tabela më poshtë përmbledhë analizën e ndjeshmërisë për riskun e valutës së huaj dhe efektin mbi fitimin ose humbjen dhe kapitalin neto të Bankës, neto nga tatimi:

	Rritja 2024	Rritja 2023	Efekti mbi fitimin ose humbjen dhe ekuitetin neto	
			31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
USD	10%	10%	15	6
Të tjera	10%	10%	27	25

(ii) Risku i normës së interesit

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme me luhatjet në normat e interesit të tregut, të cilat mund të ndikojnë në pozicionin financiar dhe flukset monetare të saj. Banka nuk synon të realizojë fitime përmes transformimeve të tepruara të maturitetit apo formave të tjera spekulative në tregun e normave të interesit. Përkundrazi, Banka synon të sigurojë që struktura e pasurive dhe e detyrimeve të jetë e balancuar përgjatë të gjitha maturimeve.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin ekspozimin e Bankës ndaj riskut të normave të interesit. Në to përfshihen pasuritë dhe detyrimet monetare të Bankës (kryegjëja dhe interesi i ardhshëm) me norma interesi fikse dhe jo fikse. Menaxhimi i riskut të normës së interesit (IRR) nga ana e Bankës ndjek udhëzimet e Bashkimit Evropian dhe rregulloren gjermane MaRisk.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në EUR		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2024										
Pasuritë										
Paraja e gatshme		-	-	-	-	-	-	-	72,875	72,875
Gjendjet me Bankat Qendrore		94,350	-	-	-	-	-	94,350	-	94,350
Llogaritë rrjedhëse me bankat		14,892	-	-	-	-	-	14,892	-	14,892
Bono thesari dhe letra me vlerë	Fikse	8,911	41,986	37,077	5,657	5,321	53	99,005	(568)	98,437
të tregtueshme	Variabile	10,237	16	85	59	-	-	10,397	160	10,557
Depozita me afat në banka		28,739	6,530	-	-	-	-	35,269	-	35,269
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	32,636	106,256	142,459	73,773	36,625	7,562	399,311	-	399,311
	Variabile	261,133	66,581	33,576	79,747	105,174	10,675	556,886	-	556,886
Pasuritë tjera jashtë-bilancore		10,090	42,703	43,814	2,749	7,320	44	106,720	-	106,720
Gjithsej pasuritë		460,988	264,072	257,011	161,985	154,440	18,334	1,316,830	72,467	1,389,297
Detyrimet										
Llogaritë rrjedhëse nga bankat		-	-	-	-	-	-	-	1,069	1,069
Llogaritë rrjedhëse nga klientët		226,663	74,040	73,739	135,729	285,477	-	795,648	2,713	798,361
Depozitat nga klientët		9,459	43,936	86,098	71,935	25,671	481	237,580	-	237,580
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse	-	4,194	6,012	9,469	3,923	-	23,598	-	23,598
	Variabile	161	12,242	445	950	2,274	3,538	19,610	-	19,610
Gjithsej detyrimet		236,283	134,412	166,294	218,083	317,345	4,019	1,076,436	3,782	1,080,218
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj NI - pozicioni i hapur		224,705	129,660	90,717	(56,098)	(162,905)	14,315	240,394	68,685	309,079

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në EUR		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2023										
Pasuritë										
Paraja e gatshme		-	-	-	-	-	-	-	78,361	78,361
Gjendjet me Bankat Qendrore		113,462	-	-	-	-	-	113,462	-	113,462
Llogaritë rrjedhëse me bankat		6,691	-	-	-	-	-	6,691	-	6,691
Bono thesari dhe letra me vlerë	Fikse	38,126	36,035	5,445	1,500	805	-	81,911	(303)	81,608
të tregtueshme	Variabile	10,253	10,063	149	101	31	-	20,597	337	20,934
Depozita me afat në banka		10,188	351	-	-	-	-	10,539	-	10,539
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	28,855	94,202	130,786	35,770	29,369	5,008	323,990	-	323,990
	Variabile	296,564	48,894	51,301	25,434	46,774	7,979	476,946	-	476,946
Pasuritë tjera jashtë-bilancore		10,804	32,214	39,241	378	1,426	485	84,548	-	84,548
Gjithsej pasuritë		514,943	221,759	226,922	63,183	78,405	13,472	1,118,684	78,395	1,197,079
Detyrimet										
Llogaritë rrjedhëse nga bankat		-	-	-	-	-	-	-	1,308	1,308
Llogaritë rrjedhëse nga klientët		10,904	36,552	84,027	43,828	-	-	175,311	565,404	740,715
Depozitat nga klientët		4,875	21,214	84,114	40,892	11,499	525	163,119	-	163,119
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse	2,994	2,408	4,520	4,566	4,566	-	19,054	-	19,054
	Variabile	429	782	7,888	360	1,073	320	10,852	-	10,852
Gjithsej detyrimet		19,202	60,956	180,549	89,646	17,138	845	368,337	566,712	935,049
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj NI - pozicioni i hapur		495,741	160,803	46,373	(26,463)	61,267	12,627	750,347	(488,317)	262,030

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në USD		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2024										
Pasuritë										
Paraja e gatshme		-	-	-	-	-	-	-	1,445	1,445
Gjendjet me Bankat Qendrore		-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat		4,157	-	-	-	-	-	4,157	-	4,157
Bono thesari dhe letra me vlerë	Fikse	5,024	21,400	7,194	204	-	-	33,822	(117)	33,705
të tregtueshme	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat në banka		1,948	974	-	-	-	-	2,922	-	2,922
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pasuritë tjera jashtë-bilancore		77	-	-	-	-	-	77	-	77
Gjithsej pasuritë		11,206	22,374	7,194	204	-	-	40,978	1,328	42,306
Detyrimet										
Llogaritë rrjedhëse nga bankat		-	-	-	-	-	-	-	1	1
Llogaritë rrjedhëse nga klientët		9,794	2,905	2,885	5,567	11,935	-	33,086	3	33,089
Depozitat nga klientët		373	6,938	1,027	-	-	-	8,338	-	8,338
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet		10,167	9,843	3,912	5,567	11,935	-	41,424	4	41,428
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj NI - pozicioni i hapur		1,039	12,531	3,282	(5,363)	(11,935)	-	(446)	1,324	878

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në USD		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2023										
Pasuritë										
Paraja e gatshme		-	-	-	-	-	-	-	929	929
Gjendjet me Bankat Qendrore		-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat		3,013	-	-	-	-	-	3,013	-	3,013
Bono thesari dhe letra me vlerë	Fikse	8,718	12,685	1,360	-	-	-	22,763	(207)	22,556
të tregtueshme	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat në banka		3,984	-	-	-	-	-	3,984	-	3,984
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pasuritë tjera jashtë-bilancore		72	-	-	-	-	-	72	-	72
Gjithsej pasuritë		15,787	12,685	1,360	-	-	-	29,832	722	30,554
Detyrimet										
Llogaritë rrjedhëse nga bankat		-	-	-	-	-	-	-	1	1
Llogaritë rrjedhëse nga klientët		296	992	2,281	1,190	-	-	4,759	23,661	28,420
Depozitat nga klientët		2	826	945	62	42	-	1,877	-	1,877
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Variabile	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet		298	1,818	3,226	1,252	42	-	6,636	23,662	30,298
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj NI - pozicioni i hapur		15,489	10,867	(1,866)	(1,252)	(42)	-	23,196	(22,940)	256

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Analiza dhe llogaritjet janë kryer me qëllim që të kuantifikohet ndikimi i lëvizjeve të normave të interesit në vlerën ekonomike të kapitalit dhe në kapacitetin gjenerues të interesit, për një periudhë të caktuar kohore, si dhe për të zbutur rreziqet që prekin këta parametra. Duke marrë parasysh strukturat e pasurive dhe detyrimeve të shprehura në 31 dhjetor 2024 dhe 2023, dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të kurbës të normës së interesit prej +/-200 pikë bazë për kurbat që pasqyrojnë mjedisin e tregjeve ndërkombëtare dhe për monedhën vendase, EUR dhe USD, si dhe një zhvendosje që pasqyron specifikat lokale të normave të tregut (duke siguruar një goditje minimale prej +/- 200 pikë bazë), profili i riskut të normës së interesit të Bankës paraqitet më poshtë. Shifrat negative në paraqitje përfaqësojnë humbje në fitim ose humbje dhe ulje të ekuikutit neto:

+/- zhvendosja paralele e kurbave të yield-eve	F&H 12 mujore – Efekti (paralel poshtë)		Ndikimi në vlerën ekonomike (paralelisht lart)	
Asetet dhe Detyrimet në	2024	2023	2024	2023
EUR:	(5,094)	(7,522)	(11,748)	(6,265)

(b) Risku i kredisë

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë, i cili përfaqëson riskun që pala tjetër mund të shkaktojë një humbje financiare për Bankën duke mos përmbushur detyrimet e saj. Risku i kredisë është i pranishëm në të gjithë aktivitetin e Bankës, prandaj menaxhmenti e monitoron dhe e menaxhon me kujdes. Ekspozimet ndaj riskut të kredisë lindin kryesisht nga aktivitetet e kreditimit, përfshirë huat dhe paradhëniet ndaj klientëve, si dhe nga aktivitetet investuese që përfshijnë plasmanet dhe letrat me vlerë të borxhit në portofolin e aseteve të Bankës.

Ky risk ekziston gjithashtu edhe në instrumentet financiare jashtë bilancore, si letrat e kreditit, garancitë dhe zotimet për kredi. Menaxhimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për huat dhe paradhëniet realizohet në mënyrë të centralizuar nga Departamenti i Riskut të Kredisë, ndërsa risku ndër bankar që lidhet me vendosjet dhe letrat me vlerë të borxhit mbikëqyret nga Njësia e Thesarit dhe Departamenti i Monitorimit të Riskut. Të gjitha departamentet përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë raportojnë rregullisht te Bordi Menaxhues dhe te Bordi i Drejtorëve.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacion mbi cilësinë e kredisë të pasurive financiare dhe lejimet për rënien në vlerë/ humbje që mban Banka përkundrejt këtyre pasurive.

Tabela përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë në datat 31 dhjetor 2024 dhe 2023, pa marrë parasysh asnjë kolateral të mbajtur apo mjete të tjera për përmirësimin e cilësisë së kredisë. Për pasuritë financiare, ekspozimet e paraqitura më poshtë paraqesin vlerën kontabël neto të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	Vlera kontabël	31 dhjetor 2024 Vlera e zotuar/ garantuar	Vlera kontabël	31 dhjetor 2023 Vlera e zotuar/ garantuar
Gjendjet me Bankat Qendrore	94,392	-	113,462	-
Kreditë dhe paradhëniet për banka	55,998	-	23,288	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	866,514	-	729,774	-
Investime në letrat me vlerë të mëdura në VDATGJ	140,767	-	124,418	-
Pasuritë tjera financiare	3,720	-	2,913	-
Zotimet dhe garancionet e huadhënies	-	164,295	-	136,852
Gjithsej	1,161,391	164,295	993,855	136,852

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Zotimet e kredive	107,138	85,101
Garancionet financiare	41,050	37,523
Garancionet jo-financiare	15,360	12,654
Letrat e kreditit	747	1,574
	164,295	136,852
Provizionet e njohura si detyrime	(560)	(916)
Gjithsej	163,735	135,936

Paraja dhe balancat me bankat qendrore

Paraja dhe llogaria rrjedhëse me bankat nuk janë në vonesë, dhe as me rënie në vlerë dhe nuk janë të kolateralizuara. Cilësia kreditore e parasë së gatshme dhe balancave me bankat qendrore është dhënë më poshtë.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

31 dhjetor 2024

Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

	Balancat e parasë me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës me maturitet më pak se 3 muaj	Gjithsej
- Llogaritë rrjedhëse	32,432	-	32,432
- Rezerva e detyrueshme	61,950	-	61,950
Letrat me vlerë qeveritare	-	1,245	1,245
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë (Deutsche Bundesbank)	10	-	10
Gjithsej	94,392	1,245	95,637

31 dhjetor 2023

Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

	Balancat e parasë me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës me maturitet më pak se 3 muaj	Gjithsej
- Llogaritë rrjedhëse	7,183	-	7,183
- Rezerva e detyrueshme	50,714	-	50,714
Letrat me vlerë qeveritare	-	6,025	6,025
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë (Deutsche Bundesbank)	55,565	-	55,565
Gjithsej	113,462	6,025	119,487

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër në baza ditore nga Departamenti i Monitorimit të Riskut dhe Njësia e Thesarit. Përpara krijimit të një marrëdhënieje afariste me një bankë të caktuar, Departamenti i Monitorimit të Riskut kryejnë një analizë të hollësishme të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të kundërta monitorohet vazhdimisht. Gjithashtu, të gjitha bankat korrespondente dhe emetuesit e bonove ndaj të cilëve Banka ka ekspozime investimi monitorohen në mënyrë të rregullt për vlerësimet e tyre kreditore nga agjencitë ndërkombëtare si: Standard & Poor's (S&P), Fitch dhe Moody's. Departamenti i Monitorimit të Riskut, si një njësi e pavarur nga Thesari, siguron që ekspozimi ndaj të gjitha bankave të mos tejkalojë kufijtë rregullatorë apo ata të brendshëm të caktuar nga menaxhmenti i Bankës.

Në përputhje me rregulloren për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozime të përgjithshme ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalojnë 15% të kapitalit rregullator të klasit të I-rë. Për të reduktuar më tej riskun ndaj palëve të tjera, Komiteti i Pasurive dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komiteti për Menaxhimin e Riskut Financiar dhe të Tregut miratojnë kufij të brendshëm të ekspozimeve me palët e kundërta që qëndrojnë pak më poshtë se kërkesat rregullatore. Këta kufij janë mbajtur në mënyrë të qëndrueshme nga Banka.

Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave jepen pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat të Bankës pranë bankave korrespondente, të kategorizuara sipas vlerësimeve të kredisë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë</i>		
- nga vlerësimi AA+ në AA-	19,619	8,924
- nga vlerësimi A+ në A-	34,241	12,466
- nga vlerësimi BBB+ në B-	2,138	1,898
Gjithsej të arkëtueshmet nga bankat tjera	55,998	23,288

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë

Me 31 dhjetor 2024

	Kredi private	Kredi biznesore	Gjithsej
Faza 1			
Shuma bruto e papaguar	188,289	671,090	859,379
Lejimi për humbjet nga kreditë	(2,616)	(4,560)	(7,176)
Vlera neto e mbetur	185,673	666,530	852,203
Faza 2			
Shuma bruto e papaguar	805	11,013	11,818
Lejimi për humbjet nga kreditë	(45)	(625)	(670)
Vlera neto e mbetur	760	10,388	11,148
Faza 3			
Shuma bruto e papaguar	1,319	8,758	10,077
Lejimi për humbjet nga kreditë	(835)	(6,261)	(7,096)
Vlera neto e mbetur	485	2,497	2,982
POCI			
Shuma bruto e papaguar	19	197	215
Lejimi për humbjet nga kreditë	(2)	(33)	(34)
Vlera neto e mbetur	17	164	181
Gjithsej shuma bruto e papaguar	190,432	691,057	881,490
Gjithsej lejimi për humbjet nga kreditë	(3,497)	(11,478)	(14,976)
Gjithsej vlera neto e mbetur	186,935	679,579	866,514

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë (vazhdim)

Me 31 dhjetor 2023	Kredi private	Kredi biznesore	Gjithsej
Faza 1			
Shuma bruto e papaguar	154,077	567,834	721,911
Lejimi për humbjet nga kreditë	(3,829)	(5,672)	(9,501)
Vlera neto e mbetur	150,248	562,162	712,410
Faza 2			
Shuma bruto e papaguar	4,732	12,143	16,875
Lejimi për humbjet nga kreditë	(166)	(2,357)	(2,523)
Vlera neto e mbetur	4,566	9,786	14,352
Faza 3			
Shuma bruto e papaguar	1,124	7,806	8,930
Lejimi për humbjet nga kreditë	(762)	(5,452)	(6,214)
Vlera neto e mbetur	362	2,354	2,716
POCI			
Shuma bruto e papaguar	20	682	702
Lejimi për humbjet nga kreditë	(20)	(386)	(406)
Vlera neto e mbetur	-	296	296
Gjithsej shuma bruto e papaguar	159,953	588,465	748,418
Gjithsej lejimi për humbjet nga kreditë	(4,777)	(13,867)	(18,644)
Gjithsej vlera neto e mbetur	155,176	574,598	729,774

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë (vazhdim)

Lejimet për rënie në vlerë dhe provizionimi

Lejimi për humbje

Banka përcakton lejimet për humbje në vlerë të barabartë me humbjet e pritura për të gjitha pasuritë financiare të njohura në kosto të amortizuar, për të gjithë instrumentet financiare të njohura në vlerën e drejtë me ndryshimet e raportuara në Vlerë të Drejtë në të Ardhura Tjera Gjithëpërfshirëse (VDATGJ), dhe për detyrimet kontingjente. Modeli me tre faza përdoret për të raportuar lejimet për humbje. Vlerësimet dhe supozimet janë në veçanti të nevojshme për të përcaktuar faktorët makroekonomikë të së ardhmes që duhet të përfshihen. Për më tepër, përcaktimi i probabiliteteve në peshimin e skenarëve kërkon vendime diskrecionale.

Banka ndan mënyrën lejimet për humbje për zërat bilancor “Balancat me Banka Qendore”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve”, “Investimet në letra me vlerë” dhe për pasuritë financiare nën “Pasuritë e tjera”. dhe për transaksione jashtë bilancore.

Në përgjithësi, këto njihen në vlerë neto brenda zërave koresponduese në bilancin e gjendjes. Lejimet për humbje në “Investimet në letra me vlerë” njihen direkt në ekuitetin e aksionarëve nën “Rezervën e rivlerësimit”. Lejimet për humbje për transaksionet jashtë bilancit raportohen në pozicionin e bilancit “Provizione”.

Banka përdor modelin për rënie në vlerë të humbjes së pritur që kërkon njohjen e humbjeve të pritshme të kredisë në kohën e duhur për të siguruar që shuma e humbjeve të pritshme të kredisë të njohura në çdo datë raportimi reflekton ndryshimet në riskun e kredisë të instrumenteve financiare. Në mënyrë të veçantë, modeli adreson kërkesat e SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritura të kredisë bazuar në informacione të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacione historike, aktuale dhe të parashikuara. Ky model përshkruan tri faza bazuar në ndryshimet në riskun e ekspozimit ndaj kredisë që nga data e njohjes fillestare.

•Faza 1:

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen nën “Faza 1” kur njihen për here të parë me përjashtim të atyre të kategorizuara si POCl (Blerje ose Kredi e Origjinuar e Dëmtuar). Banka përcakton lejimet për humbje në vlerë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë një periudhe maksimale prej 12 muajsh prej datës së bilancit të gjendjes, përderisa nuk ka rritje të dukshme në risk kreditor që nga njohja fillestare.

•Faza 2:

Nëse risku kreditor rritet dukshëm, pasuritë financiare klasifikohen nën “Faza 2” dhe lejimet për humbje përcaktohen në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë tërë jetëgjatësisë së mbetur deri në maturitet.

•Faza 3:

Pasuritë financiare që kanë dështuar në pagesa klasifikohen nën “Faza 3” dhe lejimet për humbje përcaktohen në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë tërë jetëgjatësisë së mbetur deri në maturitet. Për ekspozimet me rëndësi, lejimi për humbje njihet në bazë të rrjedhave të rikuperueshme të parasë. Për ekspozimet e vogla, lejimet për humbje njihen në bazë të parametrave të përcaktuar të portfolios. Të hyrat nga interesi njihen në vlera neto kontabël (minus lejimet për humbje).

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë (vazhdim)

Lejimet për rënie në vlerë dhe provizionimi (vazhdim)

Lejimi për humbje (vazhdim)

Pasuritë financiare të cilat tashmë kanë rënie në vlerë në matjen fillestare (POCI) raportohen si pjesë e ekspozimeve të dëmtuara. Këto pasuri financiare njihen fillimisht në vlerën e drejtë, kështu që nuk njihen lejime për humbje. Në periudhat pasuese, çdo ndryshim në humbjet e pritshme përgjatë jetës së mbetur raportohet si shpenzim në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Një modifikim jo thelbësor ekziston nëse një pasuri financiare modifikohet pa çregjistrim. Fitimi ose humbja e modifikimit njihet në “Ndryshim në provizionet për humbje”. Fitimi ose humbja e modifikimit është e barabartë me diferencën ndërmjet vlerës bruto fillestare dhe vlerës aktuale të rrjedhave të parasë, të diskontuar me normën efektive fillestare të interesit sipas kushteve të modifikuara.

Migrimi ndërmjet fazave është i mundur në të dy drejtimet (përveç POCl), me kusht që të mos ekzistojnë më bazat për migrimin e mëparshëm. Në rast se risku i kredisë zvogëlohet, provizionet e humbjeve të regjistruara tashmë reduktohen. Për pozicionin “Pasuritë tjera”, lejimet për humbje përcaktohen duke përdorur metodën e thjeshtuar Si rregull, lejimet për humbje njihen në momentin e njohjes dhe në çdo datë pasuese raportuese në një vlerë të barabartë me humbjet e pritura kreditore gjatë gjithsej periudhës së maturimit. Për këto pasuri që janë në përgjithësi afatshkurtër, gjithsej periudha e maturitetit është përcaktuar të jetë 12 muaj.

Llogaritja e Humbjes së Pritshme nga Kredia (ECL)

Ekspozimi në rast mospagese (EAD)

EAD është shuma e pritshme e ekspozimit në momentin e mospagesës së një huaje; ajo rrjedh nga detyrimi aktual i papaguar nga klienti dhe ndryshimet e mundshme të ardhshme sipas kushteve kontraktuale përkatëse. Kështu, EAD përfshin ekspozimet e pritura (duke përfshirë riskun e kredisë nga aktivitetet jashtë bilancit) në momentin e mospagesës. Për ekspozimet me plane të rregullta pagesash, EAD e modeluar përshtatet për mundësinë e pritur të pagesës së hershme, bazuar në vëzhgime historike dhe në skenarët për zhvillimin e mjedisit ekonomik dhe parashikimet përkatëse për të ardhmen. Për ekspozimet e mundshme që mund të lindin në të ardhmen nga shfrytëzimi i angazhimeve ekzistuese të kredisë, si linjat e kredisë apo mbitërheqjet, faktorët e konvertimit vlerësohen bazuar në analizën empirike të të dhënave historike; për garancitë e pagesës dhe letrat e kreditit, vendoset një faktor konvertimi prej 100% ose 50%, respektivisht, bazuar në gjykim profesional.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë (vazhdim)

Lejimet për rënie në vlerë dhe provizionimi (vazhdim)

Lejimi për humbje (vazhdim)

- Probabiliteti i Mospagesës (PD)

PD përfaqëson probabilitetin e mospagesës së një huaje brenda një periudhe të caktuar kohore dhe rrjedh nga ngjarjet historike të mospagesave, duke marrë parasysh pritjet makroekonomike aktuale. Këto të dhëna përfshijnë kohën, llojin dhe shumën e mospagesës si dhe informacionin mbi karakteristikat e klientit nga sistemi ynë i brendshëm i klasifikimit të riskut.. Parametrat janë të veçantë për çdo vend dhe dallojnë nivelet e rrezikut të ekspozimeve sipas segmenteve të klientëve të përcaktuara në nivel banke. Ne përdorim modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të bërë parashikime për PD e pritur, duke marrë parasysh skenarët për zhvillimin e mjedisit ekonomik (vlerësimi PiT). Gjithashtu, ne vlerësojmë PD për periudhën e mbetur të jetëgjatësisë së një ekspozimi.

- Humbja në rast mospagese (LGD)

LGD pasqyron shkallën e pritshme të humbjes nga një ekspozim kredie në mospagese. Kjo përfshin probabilitetin e rikuperimit nga mospagesa dhe normat e pritshme të rikuperimit për të dy skenarët (rikuperim/jo-rikuperim). Normat e rikuperimit llogariten nga flukset monetare të diskontuara, bazuar në të dhënat historike për fondet e marra nga klientët në mospagese dhe nga realizimi i kolateralit dhe garancive. Probabilitetet dhe normat e rikuperimit të vlerësuara modelohen si parashikime me qasje të orientuar drejt së ardhmes, të cilat marrin parasysh skenarët e supozuar për zhvillimin e mjedisit ekonomik.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Të dhënat hyrëse për vlerësimin e parametrave të riskut të kredisë bazohen në histori të dhëna historike shumëvjeçare për huamarrësit tanë. Ndikimi i karakteristikave të veçanta të rrezikut për klientët dhe faktorëve makroekonomikë mbi parametrat e përzgjedhur përcaktohet përmes një analize regresioni. Procesi shumëfazor i përzgjedhjes së faktorëve makroekonomikë përkatës, të cilët trajtojnë dimensione të ndryshme të mjedisit ekonomik (performanca ekonomike, inflacioni, papunësia, ambienti i normave të interesit, fuqia e monedhës, çmimet e energjisë), bazohet në gjykim profesional, rëndësinë statistikore dhe përkatësinë ekonomike. Ky proces përzgjedhjeje verifikohet çdo vit. Publikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Njësisë së Inteligjencës së revistës The Economist (EIU) dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) përdoren si burime të dhënash për historikun dhe parashikimet e faktorëve makroekonomikë përkatës si: Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), inflacioni, norma e papunësisë, norma e huadhënies, pariteti i fuqisë blerëse (PPP), si dhe indeksi i çmimeve të gazit dhe naftës.

Politika e shlyerjes

Banka shlyen një balancë të kredisë (dhe ndonjë lejim të lidhur për humbjet në vlerë) kur përcaktohet se kreditë nuk janë të arktueshme. Ky përcaktim arrihet pas marrjes në konsideratë të informatave të tilla si ndodhia e ndryshimeve të rëndësishme në pozitën financiare të huamarrësit, në atë masë që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të ri paguar tërë ekspozimin.

Rikuperimet e vlerave që janë shlyer më herët

Kur një kredi nuk është e arkëtueshme, shlyhet kundrejt lejitimit për humbje që është vënë nënmenjë. Të tilla shlyerje ndodhin pasi që janë kompletuar të gjitha procedurat dhe është përcaktuar shuma e humbjes. Arkëtimet pasuese të vlerave të cilat janë shlyer, njihen në pasqyrën e Fitimit ose Humbjes nën “Lejimet për humbje”.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Investimet në letrat me vlerë të matura nëpërmjet VDATGJ

Investimet në letrat me vlerë të borxhit janë me emetues shtetëror, banka qendrore dhe huamarrës të tjerë ndërkombëtarë, të cilët janë të vlerësuar me notë krediti AA- ose më të lartë nga agjencitë Fitch, S&P ose Moody's. Ekspozimi ndaj këtyre letrave me vlerë të borxhit menaxhohet në përputhje me Politikën e Thesarit. Investimet lejohen vetëm në letra me vlerë që janë shumë likuide dhe me vlerësime të larta kredie. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë pasqyrohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në pasqyrën e pozicionit financiar. Tabela e mëposhtme paraqet të gjithë portofolin, përfshirë edhe letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës që nuk janë të vlerësuara. Në prill 2024, Fitch Ratings i dha Republikës së Kosovës vlerësimin e saj të parë sovran për kreditimin, me notën BB- dhe perspektivë të qëndrueshme. Sa i përket Bankës Qendrore të Kosovës, Fitch Ratings zakonisht nuk jep vlerësime të veçanta kreditore për bankat qendrore. Në vend të kësaj, performanca dhe politikat e bankës qendrore janë pjesë përbërëse e vlerësimit të përgjithshëm sovran.

31 dhjetor 2024	Bonot e Qeverisë së Kosovës	Bonot e Qeverive OECD	Gjithsej
Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:			
- vlerësimi AAA	-	91,368	91,368
- vlerësimi AA+	-	37,077	37,077
- Të pavlerësuara (në nivel qeveritar ose shtetëror)	12,322	-	12,322
Gjithsej letrat me vlerë të borxhit të matura në VDATGJ	12,322	128,445	140,767
31 dhjetor 2023	Bonot e Qeverisë së Kosovës	Bonot e Qeverive OECD	Gjithsej
Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:			
- vlerësimi AAA	-	107,992	107,992
- Të pavlerësuara (në nivel qeveritar ose shtetëror)	16,426	-	16,426
Gjithsej letrat me vlerë të borxhit të matura në VDATGJ	16,426	107,992	124,418

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Zotimet e huadhënies dhe garancionet financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka do të ishte përgjegjëse të paguante nëse garancia aktivizohet, e cila mund të tejkalojë ndjeshëm shumën e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal kreditues për zotimet për kredi është shuma e plotë e zotimit.

(ii) Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon përqendrime të riskut të kredisë kudo që ato identifikohen, veçanërisht tek palët e vetme kontraktuese, grupet dhe entitetet e lidhura. Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ndërmerr duke vendosur kufij për shumën e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës të vetëm, një grup huamarrësish, si dhe në segmente të caktuara gjeografike dhe industriale. Këto risqe monitorohen rregullisht dhe janë subjekt i rishikimit vjetor ose më të shpeshtë, nëse kërkohet. Kufijtë sipas produktit, rajonit dhe sektorit industrial miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë menaxhohet gjithashtu përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësve dhe aplikantëve për të përmbushur detyrimet e ri pagimit, si dhe përmes rregullimeve të kufijve të zotimeve për kredi kur është e përshtatshme. Kontrollat dhe masat e tjera për zbutjen e riskut janë të përshkruara më poshtë.

Kolaterali i mbajtur si dhe përmirësimet e tjera të kredisë, dhe efektet e tyre financiare

Banka përdor një sërë politikash dhe praktikash për të zbutur riskun kreditor më e zakonshme prej të cilave është sigurimi i zotimeve për kredi përmes kolateralit. Banka zbaton udhëzime për pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit ose zbutjen e riskut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për huat dhe paradhëniet janë:

- Hipotekat mbi pronat e paluajtshme (banesore, tregtare, industriale, toka të lira etj.)
- Pengu mbi pasuritë e luajtshme, si: makineri, pajisje, automjete etj.; dhe
- Kolateral në para të gatshme dhe ekuivalente monetare.

Në përgjithësi, kreditë ndaj subjekteve të korporatave dhe individëve sigurohen me kolateral në para ose lloje të tjera kolaterali të përcaktuara nga komiteti i kreditit.

Për të minimizuar humbjet nga kreditë, Banka mund të kërkojë kolateral shtesë në rast të identifikimit të treguesve të rënies në vlerë të ekspozimeve përkatëse.

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shpalosur vlerat kolaterale veçmas për:

- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë të barabarta ose tejkalojnë vlerën kontabël të pasurisë (“pasuri të mbikolateralizuara”); dhe
- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë më të vogla se vlera kontabël e pasurisë (“pasuri të nënkolateralizuara”)

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(ii) Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut (vazhdim)

Kolaterali i mbajtur si dhe përmirësimet e tjera të kredisë, dhe efektet e tyre financiare (vazhdim)

	Mbi-kolateralizuara		Nën-kolateralizuara	
	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2024				
Biznese	319,119	713,894	360,460	253,043
Privat	60,299	123,271	126,636	49,285
Gjithsej	379,418	837,165	487,096	302,328

	Mbi-kolateralizuara		Nën-kolateralizuara	
	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2023				
Biznese	269,744	712,373	304,854	214,787
Privat	51,810	111,015	103,366	42,057
Gjithsej	321,554	823,388	408,220	256,844

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga Banka në baza individuale. Vlerat e vlerësuara përgjithësisht përcaktohen duke iu referuar tregut. Të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit gjithashtu merren parasysh në llogaritjen e provizioneve individuale të zhvlerësimit.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(ii) Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut (vazhdim)

Përqendrimi i riskut kreditor

Përqendrimet lindin kur një numër i palëve janë të angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit ose aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, apo kanë karakteristika të ngjashme ekonomike të cilat do të shkaktonin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohej në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike, politike ose të tjera. Përqendrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të performancës së Bankës ndaj këtyre zhvillimeve.

Sektorët gjeografik

Tabela në vijim shpalos ekspozimin kryesor kreditor të Bankës në shumën e tyre neto , sipas kategorive të rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2024 dhe 2023. Banka ka ndarë ekspozimet ndaj rajoneve bazuar në vendin e vendbanimit të palëve të saj.

	2024			2023		
	Shtetet OECD	Kosova	Gjithsej	Shtetet OECD	Kosova	Gjithsej
Pasuritë						
Balancat me Bankat Qendrore	10	94,382	94,392	55,565	57,897	113,462
Kreditë dhe paradhëniet për banka	55,998	-	55,998	23,288	-	23,288
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	7,456	859,058	866,514	4,013	725,761	729,774
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	128,445	12,322	140,767	107,992	16,426	124,418
Pasuritë tjera financiare	80	3,640	3,720	-	2,913	2,913
Gjithsej pasuritë	191,989	969,402	1,161,391	190,858	802,997	993,855

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(ii) Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut (vazhdim)

Lloji i klientëve

Tabela në vijim shpalos ekspozimin kryesor kreditor të Bankës në shumën e tyre neto, sipas llojit të klientëve më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

	Privat	Biznese	2024 Gjithsej	Privat	Biznese	2023 Gjithsej
Pasuritë						
Balancat me Bankat Qendrore	-	94,392	94,392	-	113,462	113,462
Kreditë dhe paradhëniet për banka	-	55,998	55,998	-	23,288	23,288
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	186,935	679,579	866,514	155,176	574,598	729,774
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	-	140,767	140,767	-	124,418	124,418
Pasuritë tjera financiare	-	3,720	3,720	-	2,913	2,913
Gjithsej pasuritë	186,935	974,456	1,161,391	155,176	838,679	993,855

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit dhe financimit

Risku i likuiditetit dhe financimit trajton aftësinë afatshkurtër dhe afatgjatë të Bankës për të përmbushur detyrimet e saj financiare në mënyrë të plotë dhe në kohë, edhe në situata stresi.

Risku i likuiditetit

Banka vlerëson riskun afatshkurtër të likuiditetit mbi bazën e një analize të hendekut të likuiditetit, ndër instrumente të tjera, dhe e monitoron këtë risk duke përdorur tregues të shumtë. Këto përfshijnë një tregues të likuiditetit 30-ditor (Treguesi i Likuiditetit të Mjaftueshëm, SLI), një periudhë mbijetese dhe raporti i mbulimit të likuiditetit të përcaktuar nga CRR (Raporti i Mbulimit të Likuiditetit, LCR) si dhe rregullores nga Rregullatori e zbatuar që nga janari 2023. SLI mat nëse banka ka likuiditet të mjaftueshëm në lidhje me hyrjet dhe daljet e pritshme të fondeve në 30 ditët e ardhshme. Periudha e mbijetësës është periudha kohore gjatë së cilës banka është në gjendje të përmbushë të gjitha detyrimet e pagesës, pavarësisht rrjedhave hyrëse të reduktuara të likuiditetit dhe rritjes së daljeve. Llogaritja aplikon rrjedha dalëse që rrjedhin nga analizat historike të lëvizjeve të depozitave nga banka.

LCR tregon nëse banka ka likuiditet të mjaftueshëm për të mbuluar daljet neto të pritshme në 30 ditët e ardhshme, edhe në rast të një skenari të specifikuar të goditjes së rëndë ekonomike.

Gjithashtu, banka monitoron edhe treguesin e likuiditetit lokal të pasurive likuide mbi detyrimet afatshkurtra siç kërkohet nga Rregullatori.

Testet e stresit në të gjithë tregun, specifike për institucionin (idiosinkratike) dhe të kombinuara kryhen çdo muaj dhe ad hoc. Banka duhet të mbajë fonde të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e saj edhe në kohë të vështira. Për më tepër, banka ka një plan emergjence. Nëse krijohen rrethana të papritura dhe banka provon se nuk ka fonde të mjaftueshme likuide, ProCredit Holding do të ndërhynte si një “huadhënës i mundësisë së fundit”. ProCredit Holding mban në dispozicion një rezervë adekuate likuiditeti për këtë qëllim. Shuma e rezervës së likuiditetit përcaktohet në bazë të stres testeve të grupit dhe monitorohet rregullisht.

Likuiditeti menaxhohet në baza ditore nga Njësia e Thesarit dhe monitorohet nga Njësia e Monitorimit të Riskut dhe ALCO gjithashtu. Reziku afatshkurtër i likuiditetit matet veçanërisht me anë të LCR rregullatore. Më 31 dhjetor 2024, LCR rregullatore ishte 224%, pra mbi kërkesën rregullatore prej 100% dhe pragun e paralajmërimit të hershëm të përcaktuar nga banka. Kjo tregon një situatë të përshtatshme likuiditeti për bankën.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit dhe financimit (vazhdim)

Në përgjithësi, banka ka mbajtur një pozicion të kënaqshëm likuiditeti gjatë gjithë vitit 2024, duke i mundur asaj të përmbushë menjëherë të gjitha detyrimet financiare.

Shifrat e raportuara në tabelën e hendekut të likuiditetit nuk përputhen me pasqyrën e pozicionit financiar, për shkak të faktit se përveç pozicioneve bilancore, Banka ka marrë në konsideratë edhe pozicionet jashtë-bilancore. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare raportohen në bazë të kohës kur detyrimet (duke përfshirë detyrimet kontingjente nga garancionet e Bankës, letrat e kreditit dhe zotimet e tjera të lidhura me kredinë) bëhen të detyrueshme dhe pasuritë mund të përdoren si burim shlyerjeje (duke përfshirë zërat jashtë-bilancor siç janë zotimet e pashfrytëzuara, parevokueshme dhe të pakushtëzuara të kredisë të cilat Banka mund t'i përdorë si burim likuiditeti në çdo kohë pa miratim paraprak).

Në tabelën e hendekut të likuiditetit të paraqitur më poshtë, përkufizimet e mëposhtme konsiderohen relevante:

- Pasuritë 1 - janë pasuri të cilat nuk kanë një maturim kontraktual dhe/ose mund të konvertohen në para te gatshme shumë shpejt;
- Pasuritë 1-S – janë pasuri që kanë një maturim kontraktual dhe shpërndarja në suaza kohore bazohet në maturitetet e mbetura;
- Detyrimet 1 – janë detyrime të cilat janë të pagueshme sipas kërkesës kontraktuale; dhe
- Detyrimet 1-S – janë detyrime që kanë një maturim kontraktual dhe shpërndarja në suaza kohore bazohet në maturitetet e mbetura.

Hendeku i likuiditetit paraqet analizën e likuiditetit të maturiteteve kontraktuale të paskontuara të mbetura në datën e raportimit të grupuar sipas maturimeve të pritshme të pasurive dhe detyrimeve financiare. Shumat e shpalosura në pjesën e parë të tabelës janë rrjedha kontraktuale të parasë të skontuara, ndërsa Banka administron rrezikun e qenësishëm të likuiditetit mbi një bazë të pritshme, bazuar në hyrjet dhe daljet e pritshme të parave të pa diskontuara të raportuara në pjesën e dytë. Në transformimin e detyrimeve nga kontraktuale në ato të pritshme, Banka merr në konsideratë dy grupe supozimesh: supozimet e para që rekomandohen nga ProCredit Holding dhe të cilat bazohen në Rregulloren Gjermane të Likuiditetit; dhe supozimet e dyta rrjedhin nga analiza historike e depozitave të klientëve dhe modeli i tërheqjes së tyre.

Objektivi i Bankës është të ruajë një hendek maturimi kumulativ të pritshëm pozitiv. Nëse ky hendek do të bëhej negativ dhe jo pozitiv, Banka e identifikon këtë si një "pozicion i monitoruar likuiditeti", duke treguar nevojën për një monitorim më të afërt të niveleve të likuiditetit.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit dhe financimit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2024	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	»1 vit	Gjithsej
Pasuritë 1						
Paraja e gatshme	74,320	-	-	-	-	74,320
Rezervat me Bankën Qendrore	61,952	-	-	-	-	61,952
Llogaritë rrjedhëse me Bankat Qendrore	32,442	-	-	-	-	32,442
Llogaritë rrjedhëse me bankat	12,145	570	1,855	2,345	1,973	18,889
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	3,383	35,774	23,683	45,654	32,274	140,767
Pasuritë 1-S						
Depozitat me afat në banka	22,725	15,457	-	-	-	38,182
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	33,493	65,672	112,248	232,081	531,301	974,795
Gjithsej Pasuritë	240,460	117,473	137,786	280,080	565,548	1,341,347
Detyrimet Kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	1,070	-	-	-	-	1,070
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	785,610	-	-	-	-	785,610
Detyrimet kontingjente nga garancionet	57,156	-	-	-	-	57,156
Zotimet kreditore të papërdorura	107,119	-	-	-	-	107,119
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	10,394	15,687	34,439	101,412	140,537	302,470
Huamarrjet dhe borxhi i varur	-	1,475	4,455	9,563	30,115	45,607
Gjithsej Detyrimet Kontraktuale	961,349	17,162	38,894	110,975	170,652	1,299,032
Hendeku Periodik Kontraktual i Likuiditetit	(720,889)	100,311	98,892	169,105	394,896	42,315
Hendeku Kumulativ Kontraktual i Likuiditetit	(720,889)	(620,578)	(521,686)	(352,581)	42,315	-
Detyrimet e Pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	972	49	49	-	-	1,070
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	4,658	-	-	-	-	4,658
Detyrimet kontingjente nga garancionet	2,858	-	-	-	-	2,858
Zotimet kreditore të papërdorura	21,425	2,678	2,678	-	-	26,781
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	71,941	31,657	32,513	64,006	872,564	1,072,681
Huamarrjet dhe borxhi i varur	-	1,393	2,857	3,857	26,072	34,179
Gjithsej Detyrimet e Pritura	101,854	35,777	38,097	67,863	898,636	1,142,227
Hendeku Periodik i Pritshëm i Likuiditetit	138,606	81,696	99,689	212,217	(333,088)	199,120
Hendeku Kumulativ i Pritshëm i Likuiditetit	138,606	220,302	319,991	532,208	199,120	-

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit dhe financimit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	>1 vit	Gjithsej
Pasuritë 1						
Paraja e gatshme	79,290	-	-	-	-	79,290
Rezervat me Bankën Qendrore	50,750	-	-	-	-	50,750
Llogaritë rrjedhëse me Bankat Qendrore	62,748	-	-	-	-	62,748
Llogaritë rrjedhëse me bankat	4,216	240	1,505	2,260	1,487	9,708
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	29,693	37,866	24,447	18,664	13,052	123,722
Pasuritë 1-S						
Depozitat me afat në banka	4,018	10,500	-	-	-	14,518
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	29,823	56,862	97,228	198,897	439,768	822,578
Gjithsej Pasuritë	260,538	105,468	123,180	219,821	454,307	1,163,314
Detyrimet Kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	1,309	-	-	-	-	1,309
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	723,745	-	-	-	-	723,745
Detyrimet kontingjente nga garancionet	51,751	-	-	-	-	51,751
Zotimet kreditore të papërdorura	84,988	-	-	-	-	84,988
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	6,550	7,632	16,319	93,426	91,025	214,953
Huamarrjet dhe borxhi i varur	3,002	444	2,718	4,489	18,951	29,603
Gjithsej Detyrimet Kontraktuale	871,345	8,076	19,037	97,915	109,976	1,106,349
Hendeku Periodik Kontraktual i Likuiditetit	(610,807)	97,392	104,143	121,906	344,331	56,965
Hendeku Kumulativ Kontraktual i Likuiditetit	(610,807)	(513,415)	(409,272)	(287,366)	56,965	-
Detyrimet e Pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	918	-	-	-	-	918
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	8,821	-	-	-	-	8,821
Detyrimet kontingjente nga garancionet	2,588	-	-	-	-	2,588
Zotimet kreditore të papërdorura	22	-	-	-	-	22
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	51,786	26,731	8,910	96,183	739,739	923,349
Huamarrjet dhe borxhi i varur	2,976	393	-	2,143	21,143	26,655
Gjithsej Detyrimet e Pritura	67,111	27,124	8,910	98,326	760,882	962,353
Hendeku Periodik i Pritshëm i Likuiditetit	193,427	78,344	114,270	121,495	(306,575)	200,961
Hendeku Kumulativ i Pritshëm i Likuiditetit	193,427	271,771	386,041	507,536	200,961	-

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit dhe financimit (vazhdim)

Për qëllime likuiditeti, Banka i klasifikon depozitat pa afat dhe depozitat e kursimit si të detyrueshme dhe që maturohen brenda një muaji. Si rezultat, hendeuku kontraktual i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj është rritur. Megjithatë, mundësia që shumat të mëdha të depozitave të klientëve të largohen nga Banka është shumë e ulët. Prandaj, Banka nuk mendon të ketë hendeke të likuiditetit në afat të shkurtër. Fokusohet më tepër në hendeke të pritshëm të maturimit, i cili përfaqëson një skenar më të mundshëm.

Banka mban një portfolio të pasurive financiare shumë të tregtueshme (investime me vlerë të matura në VDATGJ) që lehtë mund të likuidohen si mbrojtje nga çdo ndërprerje e paparashikuar në rrjedhën e parasë. Menaxhmenti i Bankës është duke monitoruar raportet e likuiditetit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullative në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, Menaxhmenti beson se Banka nuk ka hendeke afatshkurtër të likuiditetit. Gjatë vitit 2024, Banka aplikoi testimin e stresit të likuiditetit në baza mujore për të gjitha monedhat operative dhe e diskutoi atë rregullisht në Komitetin e Menaxhimit të Riskut Financiar dhe Tregut dhe Komitetin e Menaxhimit të Pasurive dhe Detyrimeve (ALCO).

Testi i stresit kryhet duke aplikuar katër skenarë të ndryshëm sipas politikës së administrimit të riskut të likuiditetit, duke filluar nga skenarët më pak deri në më shumë konservativ. Në rast se Bordi Menaxhues dhe Funkcioni i Monitorimit të Riskut shohin ndonjë gjë që kërkon vëmendje në këto skenarë, Banka merr masat e nevojshme për të minimizuar çdo risk.

Risku i Financimit

Risku i financimit është risku që fonde shtesë nuk mund të merren, ose mund të merren vetëm me kosto më të larta. Ky risk zbutet nga fakti se banka financon operacionet e saj kredituese kryesisht nëpërmjet depozitave; operacionet e saj të marrjes së depozitave fokusohen në grupin e saj të synuar të klientëve të biznesit dhe klientëve/kursimtarëve privatë. Këto plotësohen me kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFN). Financimi i bankës është treguar i qëndrueshëm. Në fund të dhjetorit 2024, burimi më i madh i financimit ishin depozitat me 95% të totalit.

Banka menaxhon, mat dhe kufizon riskun e financimit nëpërmjet planifikimit të biznesit, analizës së hendekut të maturimit dhe disa treguesve. Kjo përfshin raportin strukturor të likuiditetit (raporti i financimit të qëndrueshëm neto, NSFR). Më 31 dhjetor 2024, NSFR rregullatore ishte 150% (hyri në fuqi që nga janari 2023).

Nevojat për financim të bankave, të identifikuara në procesin e planifikimit të biznesit, monitorohen dhe rishikohen rregullisht në nivel bankë dhe grupi. Një tregues kyç për kufizimin e rrezikut të financimit është treguesi i përqendrimit të depozitave. Gjithashtu, financimi nëpërmjet tregut ndërbankar kufizohet nga dy tregues (përqindja e detyrimeve ndërbankare dhe detyrimet njëditore në totalin e detyrimeve).

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(d) Menaxhimi i kapitalit

Menaxhimi i kapitalit brenda bankës udhëhiqet nga parimi themelor që banka nuk duhet të marrë përsipër rreziqe përtej kapacitetit të saj për të menaxhuar. Në këtë kuadër, banka është e orientuar drejt arritjes së objektivave të mëposhtëm:

- Pajtueshmëria me kërkesat e kapitalit rregullator (perspektiva normative)
- Sigurimi i kapitalizimit adekuat në perspektivën ekonomike
- Pajtueshmëria me kërkesat për kapital të përcaktuara brenda dhe krijimi i një rezerve të mjaftueshme kapitali për të siguruar që banka është në gjendje të veprojë
- Zbatimi i planeve për rritje të qëndrueshme

Parimi i mjaftueshmërisë së kapitalit monitorohet duke përdorur tregues të ndryshëm për të cilët janë vendosur tregues dhe kufij të paralajmërimit të hershëm.

Kapitalizimi në perspektiven normative

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen në baza mujore nga menaxhmenti i Bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e BQK-së. Informacioni i kërkuar i ofrohet BQK-së në baza të rregullta mujore. Pasuritë e peshuara sipas rrezikut (PPRr) klasifikohen sipas kategorive të klasave të cilave u caktohen pasuritë. Kategoria e klasave në vetvete pasqyron natyrën dhe vlerësimin e riskut të kredisë, të tregut dhe risqeve të tjera që lidhen me çdo pasuri dhe ekspozim jashtë bilancit, me disa rregullime për të pasqyruar natyrën e kushtëzuar të disa humbjeve të mundshme. Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit përfaqëson përqindjen e kapitalit rregullator ndaj aseteve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjera, i shprehur në përqindje. Raportet minimale të kërkuara të Mjaftueshmërisë së Kapitalit janë: Kapitali bazë i klasës 1 (CET1) në 4.9% të aseteve të peshuara me rrezik, Kapitali i klasës 1 në 9% të aseteve të peshuara me rrezik, dhe gjithsej kapitali (Klasa 1 plus Klasa 2) në 12% të aseteve të peshuara me rrezik. Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023, banka ishte në përputhje me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës të matura në përputhje me rregullat e BQK-së janë si më poshtë:

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(d) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

	2024	2023
Kapitali i klasit të I-rë		
Kapitali aksionar dhe premia në aksioneve	65,550	65,550
Rezervat	7,092	6,749
Fitimet e mbajtura	60,127	46,045
minus: Pasuritë e paprekshme	(73)	(52)
minus: Kreditë për personat e lidhur me bankën	(5,005)	(4,720)
minus: Pasuritë tatimore të shtyra	(111)	(166)
Gjithsej kapitali i klasit të I-rë i kualifikuar	127,581	113,406
Kapitali i klasit të II-të		
Borxhi i varur	11,500	7,500
Provizionet për humbje të kredive (kufizuar Në 1.25% të PPRr)	8,423	9,177
Gjithsej kapitali i klasit të II-të i kualifikuar	19,923	16,677
Total kapitali rregullator	147,504	130,083
Pasuritë e peshuara sipas rrezikut:		
Zërat bilancor	813,626	693,112
Zërat jashtë bilancor	43,053	41,053
Pasuritë me risk për riskun operacional	44,141	40,678
Total pasuritë e peshuara sipas rrezikut	900,819	774,843
Raporti i mjaftueshmërisë së Kapitali të Klasës I-rë	14.16%	14.64%
Raporti i mjaftueshmërisë së gjithsej kapitalit	16.37%	16.79%

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(d) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

Kapitalizimi në perspektiven ekonomike

Përveç raporteve të kapitalit rregullator, Banka vlerëson mjaftueshmërin e saj të kapitalit duke përdorur konceptin e kapitalit ekonomik, për të pasqyruar profilin specifik të riskut të Bankës, përkatësisht duke krahasuar humbjet e mundshme që rrjedhin nga operimi i saj me kapacitetin e Bankës për të përballuar humbje të tilla. Risqet materiale të përfshira dhe kufijtë e vendosur për secilin risk pasqyrojnë profilin specifik të riskut të bankës dhe bazohen në inventarin vjetor të riskut të kryer. Konceptet e mëposhtme janë përdorur për të llogaritur humbjet e mundshme në kategoritë e ndryshme të riskut:

- Risku i kredisë (klientët): Bazuar në një analizë migrimi të përditësuar rregullisht në portfolion e kredisë, llogaritet shkalla historike e humbjeve dhe shpërndarja e tyre statistikore. Normat historike të humbjeve në kategori të ndryshme të ditë vonesave (me një nivel besueshmërie prej 99%) aplikohen në portfolion e kredisë për të llogaritur humbjet e mundshme të kredisë.
- Risku i palës tjetër: Llogaritja e humbjeve të mundshme për shkak të riskut të palës tjetër bazohet në probabilitetin e dështimit që rrjedhë nga vlerësimi përkatës ndërkombëtar i palës ose vendit përkatës të veprimtarisë (pas rregullimit).

- Risku i tregut: Ndërsa luhatjet historike të monedhës analizohen statistikisht dhe variancat më të larta (niveli i besimit 99%) aplikohen në pozicionet aktuale të monedhës, risku i normës së interesit llogaritet duke përcaktuar ndikimin e vlerës ekonomike të një goditjeje standarde të normës së interesit prej 200 pikë bazë lartë dhe poshtë për kurbat e yield-eve që pasqyrojnë mjedisin e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare dhe për monedhën vendase, si dhe për EUR dhe USD, përcaktohet një paralele lart e poshtë që pasqyron specifikat lokale të normave të tregut, duke siguruar një goditje minimale. aplikohet prej $\pm$ 200 pikë bazë.
- Risku operacional: Për të llogaritur vlerën përkatëse përdoret çasja standarde e Basel II.

Banka tregoi një nivel modest të përdorimit të Burimeve të saj në Dispozicion për të Mbuluar Riskun (RAtCR) më 31 dhjetor 2024. Përdorimi i kufirit të riskut të palëve tjera dhe të tregut është përsëri i ulët, duke reflektuar qasjen e menaxhimit kundërshtues ndaj riskut që udhëzon operacionet e thesarit të Bankës. Kapitali ekonomik i kërkuar për të mbuluar riskun operacional llogaritet sipas çasjes standarde të Basel II. Të dhënat e grumbulluara gjatë vitit 2024 në Data-bazën e Ngjarjeve së Riskut (RED), që kap të dhënat e ngjarjeve të riskut në një shkallë bankare të gjerë në grup, tregojnë një nivel të ulët të riskut operacional. Të gjitha rreziqet e kombinuara, të kuantifikuara sipas metodave të përcaktuara nga politikat e Bankës, janë nën kufirin prej 80% të totalit të kapacitetit mbajtës të riskut të Bankës.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregjet aktive bazohen në çmimet e kuotuara të tregut ose në kuotat e çmimeve të tregtarëve. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme të gjykitimit në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik.

a) Modelet e vlerësimit

Banka matë vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura në kryerjen e matjeve.

Inputet e Nivelit 1:

Çmimet e kuotuara (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime identike që entiteti mund të ketë qasjen datën e matjes. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuara janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksione të tregut aktual dhe rregullisht që ndodhin në bazë të vullnetshme.

Inputet e Nivelit 2:

Përveç çmimeve të kuotuara të tregut të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Teknikat e vlerësimit të aplikuara i referohen vlerës aktuale të drejtë të instrumenteve të ngjashme dhe teknikave të vlerësimit duke përdorur parametra të vëzhgueshëm të tregut.

Inputet e Nivelit 3:

Të dhëna të pa vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin që mbështeten nga pak ose aspak aktivitet tregu dhe që janë të rëndësishme për vlerën e drejtë të asetëve ose detyrimeve të lidhura. Pasuritë dhe detyrimet e nivelit 3 përfshijnë ato vlera e të cilave përcaktohet duke përdorur teknikat standarde të vlerësimit të tregut. Kur inputet e vëzhgueshme nuk janë të disponueshme, teknikat standarde të tregut për përcaktimin e vlerës së drejtë të vlerësuar të letrave me vlerë të caktuara që tregtohen rrallë, dhe për këtë arsye kanë pak transparencë, mbështeten në inpute që janë të rëndësishme për vlerën e drejtë të vlerësuar dhe që nuk janë të vëzhgueshme në treg ose nuk mund të rrjedhin kryesisht nga ose të vërtetohen nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut. Këto të dhëna të pa vëzhgueshme mund të bazohen në gjykimin ose vlerësimin e menaxhmentit dhe nuk mund të mbështeten duke iu referuar aktivitetit të tregut.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

a) Modelet e vlerësimit (vazhdim)

Inputet e Nivelit 3 (vazhdim)

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e fluksit monetar të skontuar, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe modele të tjera vlerësimi.

Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa rrezik dhe standarde, diferencat e kreditore dhe premitë e tjera të përdorura në përlllogaritjen e normave të skontimit, çmimet e obligacioneve dhe aksioneve, kurset e këmbimit të valutës së huaj, çmimet e indeksit të aksioneve dhe aksioneve dhe luhatshmëritë dhe korrelacionet e pritshme të çmimeve.

Objekti i teknikave të vlerësimit është të arrihet në një matje të vlerës së drejtë që pasqyron çmimin që do të merrej për të shitur pasurinë ose do të paguhej për të transferuar detyrimin në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të zakonshme dhe më të thjeshta. Çmimet e vëzhgueshme ose inputet e modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për letrat me vlerë të borxhit dhe aksioneve të listuara. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve të modelit redukton nevojën për gjykim dhe vlerësim të menaxhmentit dhe gjithashtu zvogëlon pasigurinë e lidhur me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve dhe inputeve të vëzhgueshme të tregut ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarje specifike dhe kushte të përgjithshme në tregjet financiare.

Vlerësimet e vlerës së drejtë të marra nga modelet janë përshtatur për çdo faktor tjetër, të tillë si risku i likuiditetit ose pasiguritë e modelit, deri në masën që Banka beson se një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do t'i merrte parasysh në çmimin e një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton riskun e kredisë të instrumentit dhe përfshin rregullime për të marrë parasysh riskun e kredisë të njësisë ekonomike të Bankës dhe të palës tjetër aty ku është e përshtatshme. Inputet dhe vlerat e modeleve kalibrohen kundrejt të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara si dhe, aty ku është e mundur, kundër transaksioneve të vëzhgueshme aktuale ose të fundit në instrumente të ndryshme dhe kundër kuotave të ndërmjetësit. Ky proces i kalibrimit është në thelb subjektiv dhe jep rangimet e inputeve të mundshme dhe vlerësimeve të vlerës së drejtë, si dhe gjykimi i menaxhmentit është i nevojshëm për të zgjedhur pikën më të përshtatshme në rang.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

b) Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë

Tabela në vijim analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet matja e vlerës së drejtë. Këto vlera njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Letrat me vlerë të investimit të matura në VDATGJ	Gjithsej vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
31 dhjetor 2024	140,767	128,445	12,322	-
Obligacionet	140,767	128,445	12,322	-
31 dhjetor 2023	124,418	107,992	16,426	-
Obligacionet	124,418	107,992	16,426	-

c) Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë për të cilat është shpalosur vlera e drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë.

Më 31 dhjetor 2024	Kategoria	Vlera kontabël	Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare						
Paraja e gatshme dhe balancat me Bankën Qendrore	KA	168,712	168,712	-	168,712	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	KA	55,998	53,868	-	53,868	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	KA	866,514	858,755	-	-	858,755
Letrat me vlerë të investimit	VDATGJ	140,767	140,767	128,445	12,322	-
Asete të tjera (aksione)	VDATGJ	53	53	-	53	-
Pasuritë tjera financiare	KA	3,720	3,720	-	3,720	-
Gjithsej		1,179,822	1,225,875	128,445	238,675	858,755
Detyrimet financiare						
Detyrimet ndaj bankave	KA	381	381	-	381	-
Depozitat e klientëve	KA	1,079,313	1,074,998	-	831,454	243,544
Huamarrjet	KA	22,628	22,158	-	193	21,965
Borxhi i varur	KA	11,591	11,591	-	-	11,591
Detyrime tjera financiare	KA	2,097	2,097	-	2,097	-
Gjithsej		1,116,010	1,111,225	-	834,125	277,100

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)

c) Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë për të cilat është shpalosur vlera e drejtë (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2023	Kategoria	Vlera kontabël	Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare						
Paraja e gatshme dhe balancat me Bankën Qendrore	KA	192,752	192,752	-	192,752	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	KA	23,288	22,535	-	4,171	18,364
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	KA	729,774	724,047	-	-	724,047
Letrat me vlerë të investimit	VDATGJ	124,418	124,418	107,992	16,426	-
Asete të tjera (aksione)	VDATGJ	52	52	-	52	-
Pasuritë tjera financiare	KA	2,913	2,913	-	2,913	-
Gjithsej		1,073,197	1,066,717	107,992	216,314	742,411
Detyrimet financiare						
Detyrimet ndaj bankave	KA	1,066	1,066	-	1,066	-
Depozitat e klientëve	KA	935,816	933,531	-	769,134	164,397
Huamarrjet	KA	19,151	18,423	-	-	18,423
Borxhi i varur	KA	7,538	7,538	-	-	7,538
Detyrime tjera financiare	KA	2,277	2,277	-	2,277	-
Gjithsej		965,848	962,835	-	772,477	190,358

* Kategoritë: KA - Kosto e amortizuar; VDATGJ - vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhëniet bazohet në transaksione të vëzhgueshme të tregut. Aty ku transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion atëherë, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modelin e vet të vlerës së drejtë, siç është teknika e skontimit të rrjedhave të parasë. Inputi në teknikën e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme kreditore përgjatë jetëgjatësisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për kreditë e dëmtuara të mbështetura me kolateral, vlera e drejtë matet në bazë të vlerës së kolateralit bazë. Për kreditë private dhe kreditë komerciale më të vogla, kreditë homogjene janë grupuar në portfolio me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët është vlerësuar duke përdorur teknikat e skontuara të rrjedhave të parasë, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturitete dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Vlera e drejtë e huamarrjeve dhe borxhit të varur bazohet në rrjedhat kontraktuale të parasë të skontuara, duke marrë në konsideratë normat e interesit të tregut, të cilat do të ishin të pagueshme nga Banka në nevojë për të zëvendësuar burimet e vjetra me ato të reja me maturim të njëjtë të mbetur.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

7. Të ardhurat neto nga interesi

	2024	2023
Të ardhurat nga interesi nga		
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	46,209	38,207
Kreditë dhe paradhëniet për banka	1,482	873
Letrat me vlerë të investimit të matura në VDATGJ	4,489	3,076
Të tjera	30	19
Gjithsej të ardhurat nga interesi	52,210	42,175
Shpenzimet e interesit		
Detyrimet ndaj klientëve	5,779	3,777
Fondet e huazuara	1,136	946
Të tjera	307	212
Gjithsej shpenzimet e interesit	7,222	4,935
Të ardhurat neto nga interesi	44,988	37,240

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe raportohen mbi bazën akruale. Të ardhurat neto nga interesi llogariten mbi vlerën bruto kontabël të një pasurie financiare; për pasuritë financiare në Fazën 3, të ardhurat neto nga interesi llogariten mbi vlerën neto kontabël të një pasurie financiar. Pagesat e marra në lidhje me kreditë e fshira nuk njihen si të ardhurat neto nga interesi, por nën "Lejimet për humbjet nga kreditë".

8. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	2024	2023
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet prej		
Shërbimet e pagesave	5,232	4,832
Kartelat e debitit dhe kreditit	4,363	4,256
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	3,938	4,159
Letrat e kreditit dhe garancionet	1,004	997
Të tjera	446	389
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	14,983	14,633
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve në		
Tarifa e shërbimit për kartelat Debiti/Krediti	4,530	3,716
Transaksionet që lidhen me qendrën e procesimit dhe shërbime të tjera financiare	1,918	1,784
Tarifa të tjera për bankat	1,252	1,328
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	48	45
Tarifa të tjera	265	412
Gjithsej shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	8,013	7,285
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	6,970	7,348

*Shifrat e vitit të kaluar janë përshtatur me strukturën aktuale të raportimit

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet njihen sipas shumës së dakordësuar. Ato zakonisht njihen në një moment të caktuar.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

9. Rezultati nga transaksionet në valutë të huaj

	2024	2023
Këmbimet në valutë të huaj	1,655	1,491
Fitimet dhe humbjet neto nga rivlerësimi i valutës	19	(3)
Rezultati nga këmbimi valutor	1,674	1,488

10. Rezultati tjetër operativ neto

	2024	2023
Të ardhura të tjera operative nga:		
Kthimi i provizioneve	338	221
Rimbursimi i shpenzimeve	3	32
Shitja e objekteve, impianteve dhe pajisjeve	113	37
Të tjera	585	482
Të ardhura të tjera operative	1,039	772
Shpenzime të tjera operative për:		
Sigurimi i depozitave	760	730
Asgjësimi i objekteve, impianteve dhe pajisjeve	50	364
Shërbimet e Rikuperimit të Kredive	263	395
Të tjera	1,320	1,270
Shpenzime të tjera operative	2,393	2,759
Rezultati tjetër operativ neto	(1,354)	(1,987)

11. Shpenzimet e personelit

	2024	2023
Shpenzimet e pagave	6,942	6,056
Kontributi pensional	353	307
Sigurimi shëndetësor	138	126
Shpenzimet e tjera të punonjësve	208	341
Gjithsej	7,641	6,830

Më 31 dhjetor 2024, Banka kishte 400 punonjës (2023: 347 punonjës).

12. Shpenzimet administrative

	2024	2023
Mirëmbajtja dhe riparimet	5,989	4,513
Zhvlerësimi dhe amortizimi	2,649	2,103
Tarifat e konsulencës, ligjore dhe tarifa tjera	2,549	1,936
Shpenzimet e reklamës dhe promovimit	1,698	729
Shpenzimet për ProCredit Holding	1,467	1,160
Shërbimet e sigurimit	1,152	1,140
Shpenzimet e trajnimit	760	611
Të drejtat në softuer	427	373
Transporti (karburant, mirëmbajtje)	350	361
Komunikimi (telefon, lidhje online)	340	329
Komunalit	359	307
Furnizimet me material për zyre	201	191
Shpenzimet e qirasë	54	40
Shpenzime të tjera	1,343	1,188
Gjithsej	19,338	14,981

Shpenzimet e qirasë përfshijnë kryesisht qiratë afatshkurtra për të cilat zbatohen përjashtimet e përcaktuara në SNRF 16.

13. Lejimet për humbjet nga kreditë

	2024	2023
Ndryshimi në Lejimet për humbjet nga kreditë	3,048	(982)
Rikuperimi i kredive të shlyera	3,461	3,514
Gjithsej	6,509	2,532

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

14. Tatimi në fitim

Shumat e njohura në fitim ose humbje

	2024	2023
Shpenzimet aktuale të tatimit	2,709	2,548
Tatimi i shtyrë (të ardhurat)/shpenzimet	17	(49)
Shpenzimet tatimore të viteve të mëparshme	-	(3)
Shpenzimet e tatimit në fitim	2,726	2,496

Tatimi mbi fitimin aktual llogaritet në bazë të rregullave të tatimit në fitim të aplikueshme në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Norma e tatimit në fitimin e korporatave është 10% (2023: 10%)

	2024			2023		
	Para tatimit	Ngarkesa tatimore	Neto nga tatimi	Para tatimit	Ngarkesa tatimore	Neto nga tatimi
Shumat e njohura në të Ardhurat Tjera Gjithëpërfshirëse (ATGJ)						
Investimi në letra me vlerë të matura në VDATGJ	(381)	38	(343)	(78)	9	(69)
Gjithsej	(381)	38	(343)	(78)	9	(69)

Rikonsilimi i normës efektive të tatimit

Më poshtë është një barazim i tatimit në fitim i llogaritur me normën e aplikueshme tatimore prej 10% (2023: 10%) ndaj shpenzimeve aktuale të tatimit në fitim:

	2024	2023
Fitimi para tatimit	31,808	24,809
Tatimi duke përdorur normën e tatimit të korporatave	3,181	2,481
Të ardhurat e përjashtuara	(182)	(134)
Shpenzimet jo të zbritshme	396	318
Zbritjet për kontributet e sponsorizimit	(686)	(120)
Tatimi i shtyrë (të ardhurat)/shpenzimet	17	(49)
Shpenzimet e tatimit në fitim	2,726	2,496

Detyrimet aktuale të tatimit mbi të ardhurat më 31 dhjetor 2024 janë 291 mijë EUR (31 dhjetor 2023: 452 mijë EUR).

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

14. Tatimi në fitim (vazhdim)

Lëvizja në balancat tatimore të shtyra

Tatimi i shtyrë llogaritet në bazë të normës së tatimit të miratuar prej 10% (2023: 10%).

	31 dhjetor 2024	Fitimi ose humbja	ATGJ	31 dhjetor 2023
Pasuritë tatimore të shtyra				
Interesi i përllogaritur nga depozitat	121	18	-	103
Zhvlerësimi i pronës dhe pajisjeve	(10)	(45)	-	35
	111	(27)	-	138
Detyrimet e shtyra tatimore				
Investimi në letra me vlerë të matura në VDATGJ	(22)	-	(38)	16
Pasuritë me të drejtë të përdorimit	22	10	-	12
	-	10	(38)	28
Pasuritë/(detyrimet) neto tatimore të shtyra	111	(17)	(38)	166

15. Paraaja dhe gjendjet me Bankat Qendrore

	2024	2023
Paraaja e gatshme	74,320	79,290
Shumat e mbajtura në BQK		
Llogaritë rrjedhëse	32,432	7,183
Rezerva statusore	61,952	50,750
Gjendja me Bankën Qendrore të Republikës së Gjermanisë	10	55,565
Lejimi i humbjes	(2)	(36)
	168,712	192,752

Lëvizja e rënies në vlerë për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	2024	2023
Lejimi për humbje me 1 janar	36	36
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	(34)	-
Gjendja mbyllëse	2	36

Në përputhje me rregulloren e BQK-së për kërkesën minimale të rezervës, banka duhet të mbajë një raport minimal të rezervës së detyrueshme prej 10 për qind të detyrimeve në vijim me afat maturimi deri në një vit: depozitat, huazimet dhe letrat me vlerë. Pasuritë me të cilat banka mund t'i plotësojë kërkesat për rezervë janë depozitat e saj me BQK-në dhe pesëdhjetë për qind (50%) të parasë në kasafortat e saj. Megjithatë, depozitat në BQK nuk mund të jenë më pak se gjysma e rezervës minimale të kërkuar.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

15. Paraja dhe gjendjet me Bankat Qendrore (vazhdim)

Paratë dhe ekuivalentët e parave më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë në pasqyrën e rrjedhës të parasë:

	2024	2023
Paraja e gatshme dhe balancat me Bankat Qendrore	168,712	192,752
Rezerva statusore	(61,952)	(50,750)
Kreditë dhe paradhëniet për banka me maturim fillestar prej 3 muaj ose më pak	50,843	18,943
Gjithsej	157,603	160,945

16. Kreditë dhe paradhëniet për bankat

	2024	2023
Llogaritë rrjedhëse	17,879	8,800
Depozitat me afat me bankat	38,120	14,488
Lejimi i humbjes	(1)	(0)
Gjithsej	55,998	23,288

Lëvizja e rënies në vlerë për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, ngarkuar në fitim ose humbje është si më poshtë:

	2024	2023
Lejimi për humbje me 1 janar	-	1
Pasuritë e reja financiare të krijuara	1	-
Lirimi për shkak të shlyerjes	-	(1)
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	-	-
Gjendja mbyllëse	1	-

Normat vjetore të interesit për depozitat me afat në banka në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- Depozitat në EUR: prej 1.50% në vit deri 3.86% në vit (2023: prej: 1.10% deri 3.90% në vit); dhe
- Depozitat në USD: prej 1.50% në vit deri 5.26% në vit (2023: prej 3.00% deri 5.10% në vit).

17. Kreditë dhe paradhëniet për klientët

	2024	2023
Kredi për klientët	829,320	701,194
Mbitërheqjet	51,997	47,120
Kartat e kreditit të arkëtueshme	173	104
	881,490	748,418
Lejimi i humbjes	(14,976)	(18,644)
	866,514	729,774

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

17. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Lëvizja në kreditë ndaj klientëve dhe provizionin për humbje nga kreditë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, bazuar në kërkesat e SNRF 9, është si më poshtë:

Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Vlera bartëse bruto me 1 janar	721,911	16,875	8,930	702	748,418
Pasuritë e reja financiare të krijuara	411,911	-	-	-	411,911
Modifikimi i flukseve monetare kontraktuale të pasurive financiare	-	-	(29)	-	(29)
Mosnjohjet	(99,658)	(6,074)	(1,042)	-	(106,774)
Shlyerjet	-	-	(1,163)	-	(1,163)
Ndryshimet në akruale të interesit	34	32	121	(2)	185
Ndryshimet në shumën e principalit dhe të tarifës së disbursimit	(162,888)	(8,645)	953	(485)	(171,065)
Transferimet në Fazën 1	13,399	(13,117)	(282)	-	-
Transferimet në Fazën 2	(24,931)	25,118	(187)	-	-
Transferimet në Fazën 3	(399)	(2,371)	2,770	-	-
Këmbimi valutor dhe lëvizjet tjera	-	-	7	-	7
Shuma e mbetur bruto më 31 dhjetor 2024	859,379	11,818	10,078	215	881,490

Lejimi i humbjes për kreditë për klientët	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Gjendja më 1 janar	(9,501)	(2,523)	(6,214)	(406)	(18,644)
Pasuritë e reja financiare të krijuara	(4,981)	-	-	-	(4,981)
Lirimi për shkak të mosnjohjes	577	1,011	798	-	2,386
Transferimet në Fazën 1	(225)	217	8	-	-
Transferimet në Fazën 2	401	(416)	15	-	-
Transferimet në Fazën 3	5	109	(114)	-	-
Rritja në PD/LGD/EaD	(2,890)	(1,802)	(4,920)	-	(9,612)
Zvogëlimi in PD/LGD/EaD	9,438	2,735	2,166	372	14,711
Përdorimi i lejimeve	-	-	1,163	-	1,163
Këmbimi valutor dhe lëvizjet tjera	-	-	2	-	2
Lejimi i humbjes me 31 dhjetor 2024	(7,176)	(670)	(7,096)	(34)	(14,976)

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

17. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Vlera bartëse bruto me 1 janar	646,170	14,915	13,102	668	674,855
Pasuritë e reja financiare të krijuara	316,799	-	-	-	316,799
Modifikimi i flukseve monetare kontraktuale të pasurive financiare	17	(1)	(29)	-	(13)
Mosnjohjet	(80,502)	(3,914)	(1,958)	-	(86,374)
Shlyerjet	-	-	(1,569)	(9)	(1,578)
Ndryshimet në akruale të interesit	157	(3)	152	24	330
Ndryshimet në shumën e principalit dhe të tarifës së disbursimit	(146,805)	(6,550)	(2,294)	19	(155,630)
Transferimet në Fazën 1	10,142	(9,797)	(345)	-	-
Transferimet në Fazën 2	(23,907)	24,595	(688)	-	-
Transferimet në Fazën 3	(108)	(2,400)	2,508	-	-
Këmbimi valutor dhe lëvizjet tjera	(52)	30	51	-	29
Shuma e mbetur bruto më 31 dhjetor 2023	721,911	16,875	8,930	702	748,418

Lejimi i humbjes për kreditë për klientët	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Gjendja më 1 janar	(8,920)	(1,553)	(8,050)	(361)	(18,884)
Pasuritë e reja financiare të krijuara	(4,701)	-	-	-	(4,701)
Lirimi për shkak të mosnjohjes	631	173	1,221	-	2,025
Transferimet në Fazën 1	(164)	151	13	-	-
Transferimet në Fazën 2	973	(1,169)	196	-	-
Transferimet në Fazën 3	4	225	(229)	-	-
Rritja në PD/LGD/EaD	(4,264)	(2,447)	(4,737)	(92)	(11,540)
Zvogëlimi in PD/LGD/EaD	6,940	2,101	3,806	38	12,885
Përdorimi i lejimeve	-	-	1,569	9	1,578
Këmbimi valutor dhe lëvizjet tjera	-	(4)	(3)	-	(7)
Lejimi i humbjes me 31 dhjetor 2023	(9,501)	(2,523)	(6,214)	(406)	(18,644)

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

17. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Lëvizja në provizionin për humbjet nga dështimi i kredive ndaj klientëve për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 është si më poshtë:

	2024		2023	
Më 1 janar	18,644		18,884	
Ngarkesa / (lirim) për vitin	(2,505)		1,338	
Shlyerjet	(1,163)		(1,578)	
Gjithsej	14,976		18,644	

	2024			2023		
	Shuma bruto	Lejimi për rënie në vlerë	Shuma neto	Shuma bruto	Lejimi për rënie në vlerë	Shuma neto
Kredi biznesi:						
Kredi	640,679	(11,133)	629,546	543,098	(13,438)	529,661
Mbitërheqje	50,378	(345)	50,033	45,367	(429)	44,937
Kredi private:						
Përmirësimet për shtëpi	151,485	(2,152)	149,333	120,855	(2,852)	118,003
Investive	37,174	(1,259)	35,915	37,240	(1,774)	35,466
Konsumuese	1,773	(86)	1,687	1,858	(151)	1,707
Gjithsej	881,490	(14,976)	866,514	748,418	(18,644)	729,774

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

17. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Një analizë e kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve (kreditë për biznese), sipas shumës së shpërndarë në industri, paraqitet më poshtë:

	2024	%	2023	%
Tregti	328,218	47.5%	280,593	47.7%
Prodhim	158,174	22.9%	138,215	23.5%
Ndërtim	73,021	10.6%	61,680	10.5%
Hotele dhe restorante	24,986	3.6%	22,366	3.8%
Transport, informacion dhe komunikim	42,605	6.2%	37,451	6.4%
Arsim, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	25,720	3.7%	13,537	2.3%
Energji elektrike, gaz, ujë dhe nxjerrje minerale	18,180	2.6%	14,722	2.5%
Aktivitete financiare, sigurime, shëndetësi dhe punë sociale	13,171	1.9%	14,830	2.5%
Bujqësi	3,658	0.5%	2,742	0.5%
Aktivitete të tjera shërbimi	3,324	0.5%	2,331	0.4%
Totali i kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve	691,057	100%	588,465	100%

Lëvizja në rënien në vlerë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, i ngarkuar në fitim ose humbje është si vijon:

	2024	2023
Lejimi për humbje me 1 janar	7	15
Pasuritë e reja financiare të krijuara	8	1
Lirimi për shkak të shlyerjes	(5)	(2)
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	-	(7)
Gjendja mbyllëse	10	7

18. Investime në letrat me vlerë të matura në VDATGJ

	2024	2023
Investime në letrat me vlerë të matura në VDATGJ	140,767	124,418
Lejimi i humbjes	(10)	(7)
Gjithsej	140,757	124,411

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

19. Pasuritë e paprekshme

	Softuerët
Kosto	
Më 1 janar 2024	7,346
Shtesat	51
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2024	7,397
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2024	7,293
Ngarkesa për vitin	31
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2024	7,324
Vlera kontabël neto	73
Kosto	
Më 1 janar 2023	7,311
Shtesat	35
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2023	7,346
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2023	7,272
Ngarkesa për vitin	22
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2023	7,294
Vlera kontabël neto	52

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

20. Prona, impiantet dhe pajisjet	Toka dhe ndërtesa	Pajisjet e biznesit dhe të zyrës	Tokë dhe ndërtesa (PDP)	Gjithsej
Kostot totale të blerjes më 1 janar 2024	11,404	9,800	5,594	26,798
Shtesat	1,601	1,699	847	4,147
Shlyerjet	(206)	(1,049)	(223)	(1,478)
Kostot totale të blerjes më 31 dhjetor 2024	12,799	10,450	6,217	29,466
Zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2024	(1,857)	(7,134)	(750)	(9,741)
Zhvlerësimi	(511)	(1,366)	(742)	(2,619)
Shlyerjet	158	1,043	181	1,382
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2024	(2,210)	(7,457)	(1,311)	(10,978)
Vlera neto kontabël	10,589	2,993	4,906	18,488
Kostot totale të blerjes më 1 janar 2023	10,114	9,500	2,783	22,397
Shtesat	1,918	1,355	3,203	6,476
Shlyerjet	(628)	(1,055)	(392)	(2,075)
Kostot totale të blerjes më 31 dhjetor 2023	11,404	9,800	5,594	26,798
Zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2023	(1,818)	(6,964)	(570)	(9,352)
Zhvlerësimi	(309)	(1,213)	(561)	(2,083)
Shlyerjet	270	1,043	381	1,694
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2023	(1,857)	(7,134)	(750)	(9,741)
Vlera neto kontabël	9,547	2,666	4,844	17,057

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

21. Pasuritë tjera

	2024	2023
Shpenzimet e parapaguara	2,535	653
Të arkëtueshmet nga institucionet financiare	1,723	1,391
Depozitat per siguri	1,173	907
Inventarët dhe paradhëniet	1,140	464
Tarifat e përlogaritura të mirëmbajtjes së llogarisë	171	183
Të arkëtueshmet nga klientët (jo lidhur me huadhënien)	130	97
Llogaritë e kliringut në fund të vitit	2	1,660
Pasuritë tjera	525	466
Lejimi i humbjes	(18)	(31)
Gjithsej	7,381	5,790

*Shifrat e vitit të kaluar janë përshtatur me strukturën aktuale të raportimit

Lëvizja në lejimin për humbje për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, i ngarkuar në fitim ose humbje është si vijon:

	2024	2023
Lejimi për humbje me 1 janar	31	33
Rritja/(zvogëlimi) i riskut të kredisë	(13)	(2)
Gjendja mbyllëse	18	31

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

22. Detyrimet ndaj bankave

	2024	2023
Llogaritë rrjedhëse	381	1,066
Gjithsej	381	1,066

23. Detyrimet ndaj klientëve

	2024	2023
Llogaritë rrjedhëse	628,543	581,131
Llogaritë e kursimeve	200,880	180,071
Depozitat me afat	245,918	164,994
Llogari të tjera të klientëve	4,657	9,864
Gjithsej	1,079,998	936,060

Normat vjetore të interesit të publikuara më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	Klientë Privat		Klientë Biznesi	
	2024	2023	2024	2023
Llogaritë e kursimeve	0.15%	0.15%	0.15%	0.15%
Depozitat me afat:				
- Një vit	0.15%	0.15%	n/a	n/a
- Dy vite	0.30%	0.30%	n/a	n/a
- Tri vite	0.50%	0.50%	n/a	n/a
- Katër vite	n/a	n/a	n/a	n/a
- Pesë vite	n/a	n/a	n/a	n/a

Llogaritë rrjedhëse në përgjithësi nuk mbartin interes.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

24. Detyrimet tjera

	2024	2023
Detyrimet e qirasë	5,125	4,966
Provizionet për rastet gjyqësore	1,123	901
Detyrimet për mallra dhe shërbime	1,121	1,222
Detyrimet tjera tatimore	688	260
Provizionet për zërat financiarë jashtë bilancor	560	773
Provizionet për pushimet e pashfrytëzuara	246	231
Detyrimet ndaj palëve të lidhura	200	720
Kontributi pensional i pagueshëm në Fondin Pensional të Kosovës	88	72
Provizionet për zërat jo-financiarë jashtë bilancor	-	143
Të tjera	1,235	1,398
Gjithsej	10,386	10,686

*Shifrat e vitit të kaluar janë përshtatur me strukturën aktuale të raportimit

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

25. Huamarrjet dhe borxhi i varur

	2024	2023
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)	22,628	19,151
Gjithsej	22,628	19,151

Shuma e papaguar përfshin interesin e përlogaritur (EUR 136 mijë aktuale, EUR 158 mijë 2023).

	2024	2023
Borxhi i varur nga ProCredit Holding AG	11,591	7,538
Gjithsej	11,591	7,538

Shuma e papaguar përfshin interesin e përlogaritur (EUR 91 mijë euro aktuale, EUR 38 mijë 2023)

Në kuadër të aktivitetit të saj të kreditimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), ProCredit Bank zhvillon bashkëpunim të ngushtë me institucione kyçe evropiane, përfshirë Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), Fondin Evropian të Investimeve (FEI), si dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ndër marrëveshjet më të rëndësishme mund të përmendet partneriteti me FEI-në në kuadër të programit të garancisë InnovFin, si dhe Korniza e Pashoqëruar e Ndarjes së Rrezikut me BERZH-in.

Gjatë vitit 2024, banka e forcoi më tej bashkëpunimin e saj afatgjatë me BERZH-in, duke zgjeruar angazhimin në kuadër të Programit për Rimëkëmbjen e Qëndrueshme të NVM-ve – Faza II. Në muajin shtator, ProCredit Bank nënshkroi një marrëveshje shtesë financimi në vlerë prej 8 milionë euro. Kjo marrëveshje mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes investimeve në teknologji eficientë në energji, miqësore me mjedisin dhe konkurrese, duke kontribuar kështu në rritjen e kapaciteteve të tyre për qëndrueshmëri dhe produktivitet.

Për më tepër, banka ka thelluar angazhimin e saj në kuadër të programit për financimin e ekonomisë së gjelbër – Green Economy Financing Facility – RE power Residential III (GEFF III), duke u zotuar për një shumë shtesë prej 5 milionë eurosh, e cila do të shfrytëzohet për financimin e investimeve në sektorin rezidencial që kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së gjelbër.

Në nëntor të vitit 2024, ProCredit Bank ka lidhur një marrëveshje të re për borxh të varur me ProCredit Holding AG. Ky instrument financiar përmbush kriteret rregullatore për kapital të klasës së dytë (Tier II capital) dhe është miratuar si i tillë nga autoriteti mbikëqyrës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

26. Ekuiteti i aksionarëve dhe rezervat

Kapitali aksionar Më 31 dhjetor 2024 kapitali aksionar i autorizuar përbëhej nga 12,269,242 aksione të zakonshme (2023: 12,269,242), me një vlerë nominale prej 5 EUR secili, ndërsa struktura aksionare ishte si më poshtë:

	Numri i aksioneve	në EUR	%
ProCredit Holding AG	12,269,242	61,346,210	100
Gjithsej	12,269,242	61,346,210	100

Të gjitha aksionet e emetuara paguhen plotësisht. Nuk ka kufizime, kushte ose preferenca të lidhura me aksionet e zakonshme.

Premia në aksione: Premia në aksione prej 4,204 mijë EUR (2023: 4,204 mijë EUR) përfaqëson tejkalimin e kontributit të marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

Rezerva kontingjente: Rezerva kontingjente prej 511 mijë EUR është krijuar në vitin 2000, nëpërmjet ndarjes së fitimeve të mbajtura. Rezerva përfaqëson një provizion kundrejt riskut politik dhe nuk mund të shpërndahet si dividend pa miratimin paraprak nga BQK-ja.

Pas miratimit fillestar të SNRF 9 nga Banka Qendrore e Kosovës, që nga 1 Janari 2020, vlera prej 6,371 mijë EUR është paraqitur për qëllime rregullatore si Rezervë Tjetër. Kjo rezervë përfaqëson ndryshimin midis shifrave të raportuara të SNRF-së dhe shifrave të raportuara të BQK-së që nga 1 janari 2020, prandaj është një transferim nga fitimet e mbajtura në bilancin e rezervës tjetër dhe nuk shpërndahet për qëllime të dividendës.

Rezerva e vlerës së drejtë: Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin neto kumulativ në vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë të matura nëpërmjet VDATGJ, derisa investimi nuk çregjistrohet ose të njihet për rënie në vlerë. Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

26. Ekuiteti i aksionarëve dhe rezervat (vazhdim)

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	(133)	(202)
Rezerva e humbjeve të rivlerësimit për investimet në VDATGJ	647	99
Rezerva e fitimit të rivlerësimit për investimet në VDATGJ	(272)	(13)
Tatimet e shtyra në rezervën e vlerës së drejtë në VDATGJ	(38)	(9)
Lejimi i humbjes	3	(8)
Rezerva e rivlerësimit të vlerës së drejtë në VDATGJ	2	-
Tatimet e shtyra në rezervën e vlerës së drejtë në VDATGJ	1	-
Gjendja më 31 dhjetor	210	(133)

Dividendët e paguar: Dividendë në shumën totale prej 15,000 mijë EUR, ose 1.22 EUR për aksion, u miratuan në Mars 2024 dhe u shpërndanë aksionarit të vetëm, ProCredit Holding AG, në Maj 2024 (2023: Nuk u shpërndanë dividendë).

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

27. Transaksionet me palët e lidhura

ProCredit Group (“Grupi”) përbëhet nga banka komerciale të orientuara nga zhvillimi që veprojnë në Evropën Juglindore dhe Lindore dhe në Amerikën e Jugut, si dhe një bankë në Gjermani. Kompania mëmë e Grupit është ProCredit Holding AG, një entitet me bazë në Frankfurt, e cila udhëheq Grupin. Në një nivel të konsoliduar, Grupi mbikëqyret nga Autoritetet Mbikëqyrëse Financiare Gjermane (BaFin) dhe Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë. Grupi ProCredit synon të kombinojë ndikimin e lartë të zhvillimit me suksesin komercial për aksionarët e saj.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj bankare, Banka ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura. Këto transaksione janë kryer sipas kushteve standarde tregtare dhe me çmime tregu. Banka kryen analizën e Çmimit të Transferimit përmes një ofruesi të pavarur të jashtëm, duke konfirmuar se këto kushte janë të justifikuara. Balancat me aksionarët dhe palët e lidhura me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si në vijim:

	2024		2023	
	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Pasqyra e Pozicionit Financiar				
Pasuritë	-	3,818	-	2,040
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	3,818	-	2,040
Detyrimet	11,595	1,070	7,578	1,209
Detyrimet ndaj bankave	-	188	-	282
Detyrimet ndaj klientëve	-	685	-	244
Detyrimet tjera	4	197	40	683
Borxhi i varur	11,591	-	7,538	-

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

27. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe ATGJ

Të ardhurat	-	220	-	205
Të ardhurat nga interesi	-	25	-	12
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	-	1	-	4
Të ardhurat tjera	-	194	-	189
Shpenzimet	1,834	8,160	1,561	6,294
Shpenzimet e interesit	408	-	343	1
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	13	1,905	58	1,726
Shpenzimet administrative	1,413	6,255	1,160	4,567

Me efekt nga data 31 Mars 2024, Banka dhe ProCredit Holding AG ranë dakord, në mënyrë të ndërsjellë, për të ndërprerë marrëveshjen për linjën rezervë të financimit, e cila kishte një vlerë prej 15,000 mijë EUR (2023: 15,000 mijë EUR).

Kompensimi i menaxhmentit kyç dhe atyre që janë ngarkuar me menaxhim

Personeli Kyç i Menaxhimit është kompensuar kryesisht në formë pagash. Gjatë vitit 2024, kompensimi total bruto i paguar për Personelin Kyç të Menaxhimit ishte në shumën prej 289 mijë EUR (2023: 370 mijë EUR).

Kompensimi total bruto i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për vitin 2024 ishte 58 mijë EUR (2023: 60 mijë EUR).

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

28. Zotimet dhe kontingjencat

Garancionet, letrat e kreditit dhe zotimet e kredisë	2024	2023
Zotimet e kredisë (shih detajet më poshtë)	107,138	85,101
Garancionet ndërkombëtare	33,769	32,290
Garancionet lokale	22,641	17,887
Letrat e kreditit	747	1,574
Zbritur: Provizionet e njohura si detyrime	(560)	(916)
Gjithsej	163,735	135,936
Zotimet e kredisë		
Mjetet e pashfrytëzuara të kredit kartelave	3,601	2,902
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjes	50,809	42,884
Këstet e pa disbursuar të kredive	11,873	5,010
Pjesa e pashfrytëzuar e linjave kreditore	40,855	34,305
Gjithsej	107,138	85,101

PROCREDIT BANK SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

28. Zotimet dhe kontingjencat (vazhdim)

Garancionet dhe letrat e kreditit të lëshuara në favor të klientëve sigurohen nga kolaterali në para të gatshme, pasuritë e paluajtshme dhe kundër garancionet e marra nga institucionet e tjera financiare.

Zotimet për të zgjeruar kredinë paraqesin zotime kontraktuale për dhënien e kredive dhe kredive qarkulluese. Zotimet në përgjithësi kanë datat fikse të skadimit ose klauzola tjera të ndërprerjes. Meqenëse zotimet mund të skadojnë pa u tërhequr, shumat totale nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht kërkesat për para.

Rastet ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit, Bankës i paraqiten kërkesa ligjore dhe kontestuese; menaxhmenti i Bankës është i mendimit se nuk do të lindin humbje materiale në lidhje me pretendimet ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2024, përveç atyre të parashikuara (Shënimi 24).

29. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje tjera materiale që kanë ndodhur pas datës së raportimit e që kërkojnë shpalosje në pasqyra financiare.